



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 11 regjistër (JR)
Datë 10.03.2023

Nr. 65 i vendimit
Datë 01.08.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

| | |
|-----------------------|------------------|
| Natasha Mulaj | Kryesuese |
| Sokol Çomo | Relator |
| Ina Rama | Anëtare |
| Albana Shtylla | Anëtare |
| Mimoza Tasi | Anëtare |

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 01.08.2025, ditën e premte, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në Tiranë, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Laureta Mehmetaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 11/2023 (JR), datë 10.03.2023, që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Florian Ballhysa

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 607, datë 22.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Kledian Llaho, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi Drejtuesin e Prokurorisë së

Posaçme, z. Altin Dumani, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 607, datë 22.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, dëgjoi subjektin e rivlerësimit Kledian Llaho, i cili përfundimisht kërkoi lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi për konfirmimin e tij në detyrë, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Kledian Llaho (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*, bazuar në parashikimet e nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara për subjektin e rivlerësimit nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”).

2.1. ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se: (i) deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin; (ii) ka mungesë të dokumentacionit ligjor për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) janë përfiturar të ardhura në kushtet e konfliktit të interesave.

2.2. DSIK-ja, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komision raportin me nr. {***}, datë 30.10.2017, në të cilin ka konstatuar përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës.

2.3. KLP-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale nëpërmjet rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, duke dërguar pranë Komisionit një raport të hollësishëm, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, me vendimin nr. 607, datë 22.12.2022, me shumicë votash, vendosi: *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Kledian Llaho, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Sarandë.*
4. Ky vendim është marrë bazuar në nenin 58, pika 1, shkronja “a” dhe nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme, për secilin prej tri kritereve të rivlerësimit.

4.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë: Në përfundim të procesit të rivlerësimit, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të kreut IV të ligjit nr.84/2016, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit Kledian Llaho ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, pasi përmbush kriteret e nenit 33 të këtij ligji, për shkak se: (i) ka kryer deklarime të sakta në përputhje me ligjin (germa “a” e pikës 5); (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet gjatë gjithë periudhës së rivlerësimit (germa “b” e pikës 5); (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë (germa “c” e pikës 5); si dhe (iv) nuk është gjendur në kushtet e konfliktit të interesit në dukje (germa “d” e pikës 5).

4.2. Për kriterin e kontrollit të figurës: Në procesin e vlerësimit përfundimtar të kriterit të figurës, Komisioni nuk evidentoi prova, fakte dhe rrethana që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit për shkak të veprimtarisë korruptive apo kontakteve me persona të përfshirë në krimin e organizuar, të cilat do të ndryshonin konstatimin e grupit të punës të DSIK-së, duke çmuar se subjekti i rivlerësimit Kledian Llaho është i përshtatshëm për vijimin e ushtrimit të detyrës, për shkak se ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

4.3. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale: Në përfundim, për subjektin është vlerësuar se: (i) ka treguar aftësi të mira profesionale sipas nenit 73 të ligjit nr. 96/2016; (ii) ka treguar aftësi të mira organizative sipas nenit 74 të ligjit nr. 96/2016; (iii) ka treguar etikë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale sipas nenit 75 të ligjit nr. 96/2016; si dhe (iv) ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional sipas nenit 76 të ligjit nr. 96/2016. Për rrjedhojë, sipas germës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit

5. Komisioneri Publik Florian Ballhysa (në vijim “Komisioneri Publik”), në datën 17.02.2023 ka paraqitur ankim kundër vendimit nr. 607, datë 22.12.2022, të Komisionit, për subjektin e rivlerësimit Kledian Llaho.
6. Komisioneri Publik, mbështetur në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, ka konstatuar se nga shqyrtimi i vendimit nr. 607/2022 të Komisionit dhe akteve shoqëruese të tij, duke analizuar konstatimet për secilin nga kriteret e rivlerësimit, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2014, paraqiten gjetje dhe rrethana të tilla ligjore e fakti, të cilat e bëjnë këtë vendim të cenueshëm në tërësinë e tij dhe përmbajnë shkaqe të mjaftueshme ligjore për t’u paraqitur për shqyrtim nëpërmjet ankimit, duke iu nënshtuar juridiksionit kontrollues të Kolegjit. Këtë ankim Komisioneri Publik e ka ushtruar për të të tria kriteret, në vlerësimin tërësor të procedurave¹, duke kërkuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit (në vijim “Kolegji”), që pasi të marrë në shqyrtim

¹ Referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit sipas vendimit (JR) nr. 11/2022, prg. 43-44.

shkaqet e ankimit, në zbatim të nenit 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të gjykimit të çështjes në seancë publike, të vendosë:

o *Ndryshimin e vendimit nr. 607, datë 22.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjekti të rivlerësimit, z. Kledian Llaho.*

➤ *Shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë*

7. Komisioneri Publik ka kundërshtuar përfundimin e arritur nga Komisioni në lidhje me vlerësimin e kriterit të pasurisë, duke çmuar se subjekti i rivlerësimit nuk rezulton i besueshëm, pasi ndodhet në kushtet e deklaramit kontradiktor, të pasaktë dhe të pamjaftueshëm dhe çon institucionet e rivlerësimit në pamundësi për të verifikuar se cilat ndër deklaramet e subjektit pasqyrojnë situatën e vërtetë faktike lidhur me burimin e krijimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, ankuesi ka vlerësuar se rrethanat e evidentuara nga hetimi administrativ për këtë kriter, duhet të shqyrtohen dhe të vlerësohen në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.
8. Komisioneri Publik e ka mbështetur këtë shkak ankimi në analizën e ligjshmërisë së burimit të krijimit të pasurisë “depozitë bankare” në shumën 5.000.000 lekë, të deklaruar në deklaratën *vetting*. Në këtë kuadër, ai ka analizuar disa prej burimeve financiare të përdorura për krijimin e pasurisë apartament me sipërfaqe 105 m², të ndodhur në qytetin e Durrësit, shitja e së cilës ka shërbyer më pas si burim për krijimin e depozitës bankare në shumën 5.000.000 lekë, duke parashtruar sa vijon.

8.1. *Lidhur me burimin “kontribut i nënës”, në shumën 600.000 lekë, Komisioneri Publik ka konstatuar se ky burim krijimi nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën vetting dhe as në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2014 dhe nëna e subjektit të rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për t’i dhënë subjektit shumën 600.000 lekë.*

8.2. *Lidhur me burimin “ndihmesë e vëllait nga punësimi në Itali”, në shumën 7.000 euro, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi ndihmesë nga vëllai i punësuar në Itali, pa specifikuar vlerën e kësaj ndihme, ndërsa në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2014, subjekti nuk e ka deklaruar këtë burim krijimi. Referuar analizës financiare të kryer nga Komisioni, për të vlerësuar mundësinë e personit tjetër të lidhur për të krijuar me burime financiare të ligjshme shumën 7.000 euro të dhënë subjektit, ka rezultuar një pamjaftueshmëri në vlerën (-) 1.668 euro. Në ndryshim nga Komisioni, Komisioneri Publik ka çmuar se shpenzimet e jetesës për familjen e z. A. Ll., në këtë analizë nuk janë llogaritur në përputhje me përbërjen familjare dhe me të dhënat e Eurostat-it, çka do të çonte në një pamjaftueshmëri, në një vlerë më të madhe se ajo e konstatuar nga Komisioni.*

8.3. *Lidhur me burimin “ndihmesë e prindërve të bashkëshortes” në shumën 1.500.000 lekë për blerje apartamenti dhe 7.000 euro për arredim, Komisioneri Publik ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën vetting dhe në deklaratën për herë të parë në vitin 2014, si burim krijimi për apartamentin me sipërfaqe 105 m², ndihmesë nga prindërit e bashkëshortes, por në asnjërën prej këtyre deklaratave nuk ka deklaruar se sa është shuma e dhënë prej tyre. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka qenë kontradiktor dhe i pasaktë në deklaramet e tij lidhur me shumat, kohën e dhënies së tyre nga prindërit e bashkëshortes, si dhe burimin e të ardhurave*

që kanë shërbyer për dhënien e shumës 1.500.000 lekë dhe 7.000 euro. Sipas ankuesit, investimi që prindërit e bashkëshortes së subjektit kanë bërë pas shitjes së apartamentit në vitin 1997, për ndërtimin e një objekti tregtar hotel/restorant në qytetin e Sarandës, marrja e disa kredive bankare në funksion të aktivitetit të tyre tregtar, si dhe sasia e të ardhurave të realizuara nga ky aktivitet deri në vitin 2013, nuk mundësojnë mbulimin e shpenzimeve për jetesë, kredi dhe për t'i dhënë subjektit dhe personit të lidhur (bashkëshortes) shumat 1.500.000 lekë dhe 7.000 euro.

8.4. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit as në deklaratën *vetting* dhe as në deklaratën para fillimit të detyrës, nuk ka deklaruar dhe/ose specifikuar vlerat e shumave të dhëna si kontribut nga nëna, vëllai dhe prindërit e bashkëshortes, si dhe ka kryer deklarime kontradiktore lidhur me burimin e krijimit dhe kohën e marrjes së ndihmës nga prindërit e bashkëshortes, pamundësohet dhe kontrolli i burimit të deklaruar “kursime familjare”, me kontribut të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes.

➤ *Shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e kontrollit të figurës*

9. Sipas Komisionerit Publik, nga analiza e shkeljeve të konstatuara dhe informacioneve të përcjella nga agjencitë ligjzbatuese, lidhur me tri nga katër procedimet penale të trajtuara nga Komisioni në kriterin e aftësive profesionale, përftohen *indicie* dhe perceptime të rëndësishme se integriteti i subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit 75, pika 3 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (në vijim “ligji nr. 96/2016”), dhe do të duhej të konsiderohej me mangësi, duke dhënë vlerësimin e tij për secilin prej tyre si vijon.

9.1. *Lidhur me procedimin penal nr. {***/2019 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë*, Komisioneri Publik ka vlerësuar se mangësitë e vërejtura, bien ndesh me nënindiktorët e parashikuar në nenin 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, dhe duhen të merren në konsideratë nga Kolegji në vlerësimin tërësor të çështjes së subjektit të rivlerësimit, pasi shkeljet e konstatuara në dosjet penale të trajtuara në këtë kriter, marrin kuptim dhe peshë domethënëse, në konsideratë edhe të informacioneve që rezultojnë nga agjencitë ligjzbatuese.

9.2. *Lidhur me procedimin penal nr. {***/2018 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë*, Komisioneri Publik ka vlerësuar se gjetjet mbi këtë procedim penal, nisur dhe nga informacionet ndonëse të pakonfirmuara të përcjella nga agjencitë ligjzbatuese, duhen vlerësuar në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit 61/5 të këtij ligji, pasi përftohen perceptime të rëndësishme mbi integritetin e subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit 75, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar.

9.3. *Lidhur me procedimin penal nr. {***/2021 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë*, në lidhje me shtetasin R. H., Komisioneri Publik ka vlerësuar se, në referencë të nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, në të tilla rrethana fakti dhe ligji, sa kohë procesi i rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, në rastin konkret, do të përfundojë me marrjen e vendimit përfundimtar nga ana e Kolegjit, ndryshe nga sa ka vendosur Komisioni, duhet që kjo çështje të përfshihet në rrethin e vendimeve objekt vlerësimi në procesin e rivlerësimit të subjektit, duke u administruar eventualisht vendimi që do të merret në vijim nga Gjykata për rastin konkret. Rrethanat e mësipërme të dala nga hetimi administrativ, duhen

vlerësuar në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit 61, pika 5 e këtij ligji, pasi përftohen perceptime të rëndësishme mbi integritetin e subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit 75, pika 3 e ligjit nr. 96/2016.

➤ *Shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale*

10. Lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, Komisioneri Publik çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse që të provojnë të kundërtën e barrës së provës, mbi gjetjet e rezultuara nga aktet e administruara, të cilat duhet të merren në shqyrtim nga Kolegji për sa vijon.

10.1. Në lidhje me denoncimin e shtetasit V. R. për procedimin penal nr. {***/2019 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, Komisioneri Publik, në kundërshtim me konkluzionin e Komisionit, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës. Duke iu referuar jurisprudencës së Kolegjit dhe vlerësimit në tërësi të çështjes, ai evidenton se gabimet që përsëriten në mënyrë të vazhdueshme në praktika të ndryshme të subjektit të rivlerësimit, nuk mund të konsiderohen si raste që justifikojnë konfirmimin në detyrë, por duhet të marrin vlerësim negativ. Për rrjedhojë, në përputhje me orientimet e Kolegjit, këto gjetje duhet të vlerësohen në kuptim të nenit 4, pika 2, në lidhje me nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

10.2. Lidhur me denoncimin e shtetasit E. Y. dhe të tjerëve për procedimin penal nr. {***/2015 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, Komisioneri Publik, ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të përmbysë barrën e provës. Sipas tij, qëndrojnë pretendimet e denoncuesve lidhur me mosngritjen e akuzës ndaj shtetasit M. M., si dhe me zgjatjen e pajustificuar të afatit të hetimit. Në këto rrethana, Komisioneri Publik çmon se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në drejtim të efikasitetit hetimor, si për sa i përket ndërmarrjes së veprimeve hetimore në përputhje me kërkesat ligjore dhe mbledhjes së provave të nevojshme, ashtu edhe në administrimin e ngarkesës së punës. Për rrjedhojë, ai vlerëson se këto rrethana duhet të analizohen në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të vlerësimit të nënindikatorëve të përcaktuar në nenin 73, pika 2, dhe nenin 74, pika 1 e ligjit nr. 96/2016.

10.3. Lidhur me etikën dhe profesionalizmin, referuar nenit 75, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, Komisioneri Publik vlerëson se qëndrimi i Komisionit në lidhje me përdorimin pa kundërshpërblim nga subjekti i rivlerësimit të një apartamenti në qytetin e Vlorës, për një periudhë prej një viti, nuk gjen mbështetje në aktet e administruara në dosje, si dhe nuk përputhet me jurisprudencën dhe qëndrimet e Kolegjit në trajtimin e rasteve të ngjashme. Sipas Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit nuk ka treguar kujdesin dhe dilijencën e kërkuar për identifikimin dhe trajtimin e situatës së konfliktit të interesit, e cila, në rastin konkret, paraqitet e ndërthurur si në aspektin e interesit pasuror, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, ashtu edhe në drejtim të zbatimit të dispozitave procedurale të nenit 17 të Kodit të Procedurës Penale. Në këto kushte, Komisioneri Publik çmon se rasti duhet të vlerësohet nga Kolegji në funksion të nënindikatorëve të përcaktuar në nenin 75, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, në lidhje me kujdesin e

treguar nga subjekti i rivlerësimit për shmangien dhe administrimin e situatave të konfliktit të interesit.

10.4. Në përmbledhje të sa më sipër, Komisioneri Publik, mbi bazën e problematikave të konstatuara dhe pas një vlerësimi tërësor të tri kritereve të rivlerësimit, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, sipas nenit 61, pika 5 e po këtij ligji.

VI. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

11. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve të rivlerësimit, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, duke pasur për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit Kledian Llaho, duke e konfirmuar atë në detyrë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

12. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit nr. 607, datë 22.12.2022, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

13. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, çështja objekt gjykimi u mor në shqyrtim nga trupi gjykues në seanca gjyqësore publike, të zhvilluara në datat 30.06.2025, 04.07.2025, 11.07.2025, 23.07.2025, 30.07.2025 dhe 01.08.2025.
14. Në seancën gjyqësore të datës 30.06.2025, për shkak të mbarimit të mandatit kushtetues të Institucionit të Komisionerëve Publikë, në zbatim të nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës dhe nenit 199, paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Civile, trupi gjykues vendosi kalimin procedural nga Komisioneri Publik te Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.
15. Në seancën gjyqësore publike të datës 11.07.2025, subjekti i rivlerësimit paraqiti dy kërkesa paraprake për pezullimin e shqyrtimit në Kolegji të çështjes së juridiksionit të rivlerësimit (JR) nr. 11/2023, datë 10.03.2023, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga Kolegji lidhur

me dy çështjet e Juridiksionit Disiplinor (JD)², të regjistruara po në Kolegj, me kërkues magjistratin Kledian Llaho dhe me objekt kundërshtimin e dy vendimeve të KLP-së për dhënien e masave disiplinore ndaj tij, si dhe deri në zgjidhjen me vendim gjyqësor të formës së prerë të procedimit penal të filluar ndaj tij nga Prokuroria e Posaçme.

16. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi shqyrtoi kërkesat për pezullimin e procesit, administroi aktet shkresore bashkëlidhur³ dhe, pasi dëgjoi përfaqësuesin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, si dhe sqarimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me objektin e këtyre kërkesave, vendosi rrëzimin e tyre dhe vijimin e shqyrtimit gjyqësor në seancë publike.
17. Në vendimet e ndërmjetme, trupi gjykues vlerësoi se në rastin konkret nuk gjente zbatim neni 297, shkronja "a" e Kodit të Procedurës Civile. Procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve është një proces i pavarur me natyrë të posaçme, i cili nuk mbivendoset dhe as konkurren me procese të juridiksioneve të tjera.
18. Në këtë kuadër, autonomia e procesit të rivlerësimit evidentohet edhe në raport me juridiksionin disiplinor të zakonshëm dhe procedimet penale të zhvilluara nga organet kompetente, të cilat, për shkak të natyrës dhe qëllimit të ndryshëm, nuk mund të paragjykojnë rezultatin e procesit të rivlerësimit dhe as të kushtëzojnë zhvillimin e tij. Procesi i rivlerësimit kalimtar mbetet një procedurë administrative me natyrë disiplinore, pasojat e së cilës shtrihen vetëm mbi vazhdimësinë e ushtrimit të funksionit nga subjekti i rivlerësimit. Në këtë kuptim, ligjvënësi ka parashikuar edhe një regjim të posaçëm lidhur me barrën e provës, e cila në këtë proces u takon subjekteve të rivlerësimit.
19. Po ashtu, trupi gjykues çmoi se, në rrethanat konkrete, nuk ekzistonte marrëdhënie kushtëzimi midis procesit të rivlerësimit dhe çështjeve të juridiksionit disiplinor në shqyrtim nga Kolegji apo procedimit penal të regjistruar nga Prokuroria e Posaçme. Kjo, edhe për faktin se vendimi objekt shqyrtimi nuk ishte bazuar në rezultatin e vendimeve të KLP-së për dhënien e masave disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit dhe as në rezultatin e procedimit penal të regjistruar ndaj tij në vitin 2025.
20. Për këto arsye, trupi gjykues vendosi të mos pranonte kërkesat e subjektit të rivlerësimit për pezullimin e gjykimit të çështjes dhe ftoi palët të vijonin me parashtrimet përkatëse.

² Çështja e juridiksionit disiplinor (JD) nr. 1, datë 21.05.2025 dhe (JD) nr. 2, datë 02.06.2025.

³ Aktet, listuar sipas procesverbalit të seancës gjyqësore publike të datës 11.07.2025: urdhër për regjistrimin e procedimit penal, datë 22.04.2024, të Prokurorisë së Posaçme; vendim nr. {***}, datë 14.01.2025, i Gjykatës kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit "Për caktimin e masës së sigurisë pezullim nga detyra për prokurorin Kledian Llaho"; shkurtim vendimi nr. {***}, datë 14.04.2025, të po kësaj gjykate për përsëritjen e masës së sigurisë; vendim për zgjatjen e afateve të hetimeve të Prokurorisë së Posaçme, datë 04.07.2025; shkrim nga faqja Reporter.al, datë 04.07.2025; dokumentacion i përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë me shkresën nr. {***} prot., datë 22.04.2025; vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë nr. {***}, datë 26.07.2024; vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë nr. {***}, datë 22.07.2022; vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë nr. {***}, datë 21.09.2022; "Konkluzione" për çështjen penale nr. {***}/2022, datë 31.01.2024, konceptuar nga subjekti i rivlerësimit Kledian Llaho.

21. Në seancën gjyqësore publike të datës 23.07.2025, trupi gjykues, pasi dëgjoji parashtrimet dhe kërkimet e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme dhe të subjektit të rivlerësimit, me vendim të ndërmjetëm vendosi çeljen e hetimit gjyqësor të çështjes dhe administrimin e akteve shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e provave⁴.
22. Po ashtu, trupi gjykues pranoi kërkesën e të dyja palëve për administrimin e vendimit gjyqësor të procedimit penal nr. {***}/2021 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, duke vendosur që, pas administrimit të tij pranë Kolegjit, ky akt t'u përcillej palëve.
23. Lidhur me denoncimet nga publiku të paraqitura pas vendimit të Komisionit, trupi gjykues, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016 dhe duke marrë në konsideratë edhe qëndrimin e mbajtur në lidhje me to nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, vendosi të mos i hetonte ato.
24. Gjithashtu, trupi gjykues vendosi të njihje në mënyrë të drejtpërdrejtë informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, me të cilin ishte njohur edhe Komisioni në kuadër të hetimit administrativ të çështjes, pranë institucionit ligjzbatues që e administron atë⁵.
25. Në zbatim të kësaj vendimmarrjeje, më datë 30.07.2025, trupi gjykues, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar të çështjes, shqyrtoi pranë Shërbimit Informativ Shtetëror informacionin me të cilin ishte njohur edhe Komisioni gjatë hetimit administrativ.
26. Në seancën gjyqësore publike të datës 30.07.2025, trupi gjykues dëgjoji qëndrimet e palëve lidhur me aktet e përcjella nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë⁶, të cilat u ishin vënë më parë në dispozicion dhe për të cilat palët konfirmuan se ishin njohur me përmbajtjen e tyre.

⁴ Me parashtrimet e datës 23.07.2025 (19 faqe), subjekti paraqiti edhe aktet si vijojnë: (i) kërkesë për informacion drejtuar KLP-së, datë 18.07.2025; (ii) shkresë nr. {***}, datë 20.07.2023, nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit për subjektin e rivlerësimit; (iii) shkresë nr. {***} prot., datë 19.07.2023, nga Drejtoria Vendore e Policisë për Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë; (iv) informacion mbi referimin e veprës penale, datë 18.07.2023, i Oficerit të Policisë Gjyqësore pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë; (v) printim e-mail-i, datë 21.07.2025, nga subjekti i rivlerësimit drejtuar znj. S. B. ; (vi) printim e-mail-i, datë 22.07.2025, nga subjekti i rivlerësimit drejtuar znj. S. B.. Gjithashtu, me konstatimet mbi parashtrimet e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, subjekti depozitoi shkresën nr. {***} prot., datë 12.04.2024, të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë; shkresë nr. {***} prot., datë 20.06.2024, e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë; komunikim me e-mail nga info@ild.al, datë 20.11.2024, dërguar Kledian Llaho; kërkesë e datës 26.06.2025 drejtuar drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme nga subjekti i rivlerësimit Kledian Llaho.

⁵ Në kuadër të kësaj vendimmarrjeje, me vendim të ndërmjetëm, trupi gjykues vendosi të shtyjë seancën gjyqësore për në datën 30 korrik 2025, ora 11:00, duke ftuar njëkohësisht palët për paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare.

⁶ Në vijim të shkresës nr. {***} prot, datë 23.07.2025, “Kërkesë për dokumentacion”, të Kolegjit drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, në zbatim të vendimit të ndërmjetëm të trupit gjykues të datës 23.07.2025, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 24.07.2025, ka përcjellë: (i) vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë nr. {***}, datë 23.06.2021, 17 fletë; (ii) vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë nr. {***}, datë 21.06.2021, 24 fletë; (iii) vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë nr. {***}, datë 16.08.2022, 6 fletë; (iv) vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë nr. {***} regj. them., datë vendimi 05.07.2023, 20 fletë; (v) vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, nr. {***} regj. them., datë

27. Lidhur me këtë dokumentacion, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme deklaroi se ai duhej të administrohej në tërësi dhe t'i nënshtrohej shqyrtimit gjyqësor të çështjes. Sa i përket vlerës së tij provuese, ai rezervoi të drejtën për të paraqitur qëndrimin përkatës gjatë konkluzioneve përfundimtare.
28. Nga ana tjetër, subjekti i rivlerësimit deklaroi se, në referim të shkaqeve të ankimit, objekt shqyrtimi duhej të bëheshin vetëm vendimmarrjet që përfshinin periudhën kohore nga data 23.10.2024 deri më datë 25.11.2024, pasi pjesa tjetër e dokumentacionit nuk kishte lidhje me çështjen dhe nuk paraqiste interes për zgjidhjen e saj.
29. Pasi dëgjoi palët, trupi gjykues, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 45 e 49 të ligjit nr. 84/2016, me vendim të ndërmjetëm vendosi të administronte në cilësinë e provës të gjitha aktet e përcjella me shkresën nr. {***} prot., datë 24.07.2025, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.
30. Më tej, në kuadër të hetimit gjyqësor dhe lidhur me informacionin e klasifikuar me të cilin ishte njohur trupi gjykues, subjekti i rivlerësimit parashitri një pyetje në lidhje me nivelin e klasifikimit të këtij informacioni, si dhe paraqiti një kërkesë, nëpërmjet së cilës i kërkoi Kolegjit t'i drejtohej Shërbimit Informativ të Shtetit për të verifikuar objektivitetin dhe vërtetësinë e tij⁷.
31. Në lidhje me pyetjen e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues sqaroi se, bazuar në parashikimet e ligjit nr. 84/2016, anëtarët e organeve të rivlerësimit kanë akses në dokumente të klasifikuara “sekret shtetëror” dhe mund t'i verifikojnë e studiojnë ato, në përputhje me kuadrin ligjor që rregullon veprimtarinë e organeve ligjzbatuese që i zotërojnë, pa ekspozuar burimin e informacionit dhe pa përdorur përmbajtjen e tyre në aktet publike⁸.

*vendimi 23.10.2024, 17 fletë; (vi) vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë nr. {***}, datë 25.11.2024, 31 fletë; (vi) vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë nr. {***}, datë 25.12.2024, 5 fletë; (vii) kopje të procesverbaleve të seancave gjyqësore për gjykimin e çështjes penale me nr. {***} regjistri, datë regjistrimi 20.09.2022, për të cilën gjykata është shprehur me vendim përfundimtar me nr. {***}, datë 25.11.2024, 51 fletë.*

⁷ *Subjekti kërkoi gjatë seancës që Kolegji të verifikojë dhe kërkojë informacion pranë Drejtorisë Rajonale të SHISH-it mbi punësimin dhe detyrat që ka kryer shtetasi E. C. për periudhën kohore qershor 2019 - janar 2022, si dhe pas verifikimit të këtij informacioni të çmojë vërtetësinë e informacionit të klasifikuar duke i vlerësuar ato të ndërthurura me situatën e krijuar nga ky shtetas pas vendimit të subjektit të rivlerësimit për mosfillimin e procedimit penal, datë 20.06.2019, për materialin kallëzues nr. {***}, datë 10.06.2019, paraqitur nga shtetasi E. C..*

⁸ *Ligji nr. 8457/1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, në nenin 2, të titulluar “Përkufizime”, parashikon: “Sekret shtetëror” do të thotë informacion i klasifikuar sipas këtij ligji, ekspozimi i paautorizuar i të cilit mund të rrezikojë sigurimin kombëtar. “Informacion” do të thotë çdo njohuri që mund të komunikohet apo të dokumentohet, pavarësisht nga forma dhe që është nën kontrollin e shtetit. “Institucion” do të thotë një institucion shtetëror apo çdo zyrë tjetër brenda këtyre institucioneve, që vihet në zotërim të një informacioni të klasifikuar. “Kontroll” do të thotë e drejta e autoritetit nga buron informacioni i klasifikuar apo zotëruesit e tij, për ta mbrojtur nga çdo e drejtë njohjeje e paautorizuar”; dhe në nenin 4, të titulluar “Autoriteti i klasifikues”, parashikon: “Informacioni që përbën sekret shtetëror klasifikohet nga një autoritet i klasifikimit origjinal. Ai zotërohet e prodhohet për interesa të shtetit dhe është nën kontrollin e tij”.*

32. Trupi gjykues mban në konsideratë se në çështjen *Regner kundër Republikës Çeke*, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka vlerësuar se e drejta e palës për t'u njohur me dhe për të kërkuar zbulimin e provave përkatëse nuk ka karakter absolut. Gjykata ka theksuar se, në rastet kur kufizimi i aksesit në prova justifikohet nga arsye që lidhen me interesin publik, gjykata kombëtare duhet të shqyrtojë procedurën në tërësinë e saj, me qëllim që të verifikojë nëse kufizimi i vendosur është balancuar nga garanci procedurale të mjaftueshme. Në këtë kuadër, duhet të sigurohet që, për aq sa është e mundur në rrethanat konkrete të çështjes, të jenë respektuar kërkesat që burojnë nga parimi i kontradiktoritetit dhe ai i barazisë së armëve, si dhe t'i jenë ofruar personit të prekur garanci të përshtatshme procedurale për mbrojtjen efektive të interesave të tij [...]. Për rrjedhojë, mungesa e aksesit të plotë në prova të caktuara nuk përbën, në vetvete, cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, për sa kohë që kufizimi kompensohet nga garanci procedurale të mjaftueshme dhe gjykata ushtron kontroll efektiv mbi nevojën dhe proporcionalitetin e tij.
33. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit, në përputhje me jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit dhe duke marrë në konsideratë edhe qëndrimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në çështjen *Thanza kundër Shqipërisë*⁹, në funksion të garantimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, aksesoi dhe verifikoi drejtpërdrejt informacionin e klasifikuar në përputhje me legjislacionin në fuqi.
34. Në përfundim të këtij verifikimi, trupi gjykues arriti në konkluzionin se klasifikimi i informacionit ishte i justifikuar dhe se ekspozimi i tij do të rrezikonte burimin e tij.
35. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se mosnjohja e subjektit të rivlerësimit me informacionet e klasifikuara, të shqyrtuara nga Komisioni dhe Kolegji, përbën një kufizim proporcional të së drejtës së tij për t'u njohur me këtë informacion, i cili është në përputhje me garancitë e një procesi të rregullt ligjor, në dritën e standardeve të përcaktuara nga KEDNj-ja. Subjekti i rivlerësimit ka arritur të kuptojë thelbin/problematikën e këtij informacioni, i cili lidhet me veprimtarinë e tij si prokuror në disa çështje penale dhe ka pasur mundësi të japë shpjegime dhe të paraqesë prova, siç do të trajtohet në mënyrë të detajuar në vijim lidhur me secilin procedim. Për pasojë, trupi gjykues vlerësoi peshën e informacionit të klasifikuar në drejtim të vlerësimit të integritetit të subjektit të rivlerësimit, në raport me problematikat e konstatuara në procedimet respektive, për të cilat subjekti ishte ftuar të jepte shpjegime dhe të përmbyste barrën e provës së kaluar nëpërmjet ankimit të Komisionerit Publik. Trupi gjykues thekson se informacionet e marra nga dokumentacioni i klasifikuar, do të humbisnin peshën e tyre, nëse subjekti do të ishte bindës dhe shterues në shpjegimet për problemet e konstatuara në hetimin e çështjeve penale të shqyrtuara, në të cilat ai ka kryer funksionet e prokurorit.
36. Për rrjedhojë, trupi gjykues çmon se pretendimet e subjektit të rivlerësimit, në lidhje me cenimin e së drejtës së mbrojtjes për shkak të mosnjohjes me të, janë të pabazuara.

⁹ Shih: <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-225653>, vendimi i GjEDNj-së, çështja *Thanza kundër Shqipërisë*, paragrafët 113-123.

37. Lidhur me kërkesën e subjektit të rivlerësimit për verifikimin e objektivitetit dhe vërtetësisë së informacionit të klasifikuar, trupi gjykues, pasi dëgjoji edhe qëndrimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, vendosi rrëzimin e saj si të pabazuar në prova dhe ligj.
38. Më tej, pasi palët deklaruan se nuk kishin kërkesa të tjera procedurale, trupi gjykues vendosi mbylljen e hetimit gjyqësor dhe i ftoi ato të paraqisnin konkluzionet përfundimtare të çështjes.
39. Në konkluzionet përfundimtare, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, duke iu qëndruar shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik, kërkoi nga Kolegji ndryshimin e vendimit nr. 607, datë 22.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Kledian Llaho.
40. Subjekti i rivlerësimit parashtroi se ankimi i Komisionerit Publik, i mbështetur edhe nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, është i pabazuar në ligj dhe në prova, pasi mbështetet në perceptime subjektive dhe bie në kundërshtim me parimet e objektivitetit dhe proporcionalitetit.
41. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se provat e administruara në dosje dëshmojnë se ai ka arritur një nivel të besueshëm në secilin prej tri kriterëve të rivlerësimit – pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale, duke kërkuar përfundimisht, lënien në fuqi të vendimit nr. 607, datë 22.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit¹⁰.
42. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, trupi gjykues, pasi shqyrtoi shkaqet e ankimit të paraqitura nga Komisioneri Publik, qëndrimet e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme në parashtrime dhe në konkluzionet përfundimtare, parashtrimet¹¹ dhe konkluzionet përfundimtare të subjektit të rivlerësimit, si dhe pasi analizoi dhe vlerësoi provat e administruara gjatë hetimit administrativ në Komision dhe ato të administruara gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në Kolegj, të cilat iu nënshtruan debatit gjyqësor ndërmjet palëve, vëren dhe vlerëson si vijon.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

43. Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar: *Depozitë bankare në Credins Bank¹², çelur më datë 08.07.2015, me afat dyvjeçar dhe interes 3,5%, si rezultat i shitjes së apartamentit me sipërfaqe 105 m², kontratë shitjeje nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., para noter F. H., datë 24.04.2015. Apartament i ndodhur në lagjen nr. {***}, Durrës, blerë në muajin mars 2014 me të ardhurat: pjesërisht nga kursimet familjare, nga kredia në Raiffeisen Bank, ndihmesë nga*

¹⁰ Pasi dëgjoji konkluzionet përfundimtare të palëve, trupi gjykues vendosi të tërhiqet në dhomë këshillimi për marrjen e vendimit përfundimtar, i cili u shpall më datë 01.08.2025.

¹¹ Paraqitur më datë 23.06.2025 dhe më datë 23.07.2025.

¹² Credins Bank¹², nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 12.07.2021, në fashikullin e Komisionit ka konfirmuar se në llogari të Kledian Llaho, në datën 08.07.2015 është transferuar shuma 5.000.000 lekë, me përshkrimin transfertë me/nga banka të tjera, kalim fondi në llogarinë personale në Credins Bank, të ardhura nga shitja e apartamentit. Subjekti nuk e ka deklaruar këtë depozitë në rubrikën “Përshkrimi i pasurisë” në DIPP-2015, sikurse e kërkon ligji, por e ka deklaruar depozitën me afat në rubrikën “Përshkrimi i detyrimeve”, nga të ardhurat e shitjes së apartamentit.

vëllai i punësuar në Itali dhe pjesërisht ndihmesë nga prindërit e bashkëshortes. Vlera 5.000.000 (pesë milionë) lekë, pjesa takuese 100%.

44. Komisioneri Publik, nga kontrolli që i ka bërë saktësisë së deklaramit dhe burimeve financiare të krijimit të pasurisë “apartament banimi” të ndodhur në qytetin e Durrësit, të ardhurat e realizuara nga shitja e së cilës subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar si burim financiar për krijimin e pasurisë “depozitë bankare”, ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram kontradiktor, të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, duke i vendosur institucionet e rivlerësimit në pamundësi për të verifikuar se cilat prej deklarameve të tij pasqyrojnë situatën e vërtetë faktike lidhur me burimin e krijimit të pasurisë. Për rrjedhojë, Komisioneri Publik vlerëson se rrethanat e dala nga hetimi administrativ në lidhje me këtë kriter, duhet të analizohen në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.
45. Këtë shkak ankimi, Komisioneri Publik e ka bazuar në pretendime që lidhen me disa prej burimeve financiare të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit për pasurinë “apartament banimi”, të cilat analizohen më poshtë.
46. Komisioneri Publik ka pretenduar në ankim se të ardhurat e deklaruara si “kontribut i nënës”, në shumën 600.000 lekë, nuk janë deklaruar as në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2014 dhe as në deklaratën *vetting* dhe se subjekti i rivlerësimit, ndryshe nga sa ka arritur në përfundim Komisioni, nuk ka provuar mundësinë financiare të nënës së tij për t'i dhënë këtë shumë.
47. Subjekti i rivlerësimit e kundërshtoi pretendimin e ankuesit me argumentin se ai ka deklaruar qartë se burimi i krijimit të pasurisë “depozitë bankare” ka qenë shitja e apartamentit në vitin 2015, duke përmbushur detyrimin ligjor të parashikuar nga neni 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe çdo interpretim i ndryshëm bie në kundërshtim me këtë dispozitë.
48. Sa i takon mosdeklaramit të ndihmës së dhënë nga nëna në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2014, subjekti pretendoi se, duke qenë se bëhej fjalë për deklaramin e parë, kur kishte pasqyruar burimin e krijimit të apartamentit “pjesërisht si kursime familjare”, kishte pasur parasysh edhe kontributin financiar të nënës dhe të vëllait të tij. Sipas tij, pavarësisht se nëna dhe vëllai figuronin në certifikata familjare të veçanta, ata përbënin në fakt bërthamën e tij familjare dhe kishin funksionuar në një marrëdhënie të ngushtë mbështetjeje reciproke.
49. Në lidhje me mosdeklaramin e këtij burimi në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit pretendoi se ai ishte pasojë e një pakujdesie, duke theksuar se burimet e krijimit të pasurisë i kishte deklaruar në mënyrë specifike në procesverbalin e datës 10.02.2016 pranë ILDKPKI-së, dhe se mospasqyrimi i saktë i këtij burimi në deklaratën *vetting* nuk kishte qenë i qëllimshëm.
50. Nga analiza e akteve të administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, trupi gjykues vëren se:
 - Me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.03.2014, subjekti ka blerë nga shoqëria “{***}” ShPK pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 105,26 m², të ndodhur në qytetin e Durrësi, kundrejt çmimit 50.000 euro.

- Në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2014, subjekti ka deklaruar: *Apartament me sip. 105 m², i ndodhur në lagjen nr. {***}, rr. "{***}", Durrës, blerë në muajin mars 2014. Si burim krijimi, ai ka deklaruar: Pjesërisht nga kursimet familjare, nga kredia në Raiffeisen Bank dhe pjesërisht ndihmesë nga prindërit e bashkëshortes. Vlera 50.000 euro¹³, pjesa takuese 50%.*
 - I pyetur pranë ILDKPKI-së në lidhje me burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë “apartament banimi”, subjekti, në procesverbalin e datës 10.02.2016, ka deklaruar se burimet kanë qenë:
 - kredi në Raiffeisen Bank, në vlerën 2.500.000 lekë;
 - kursime në vlerën 1.400.000 lekë nga paga e tij dhe e bashkëshortes, duke sqaruar se ai ka qenë në marrëdhënie pune që nga data 01.02.2000, ndërsa bashkëshortja që nga data 01.03.2009;
 - ndihmë nga prindërit e bashkëshortes në shumën 1.500.000 lekë, të cilët ushtronin aktivitet privat që prej vitit 1996 si bar-restorant dhe, nga vitet 1999-2000, si bar-restorant-hotel në Sarandë, ndërsa një pjesë prej 7.000 eurosh ishte transferuar në llogarinë bankare të djalit të tyre, B. Ll.;
 - ndihmë nga vëllai A. Ll., në shumën 7.000 euro, të derdhura drejtpërdrejt në llogarinë e shoqërisë ndërtuese, sipas mandatit të BKT-së, datë 08.08.2011;
 - shumën 600.000 lekë të dhënë nga nëna e tij, e cila, së bashku me tri motrat e saj, kishte shitur në vitin 2004 një pasuri me sipërfaqe 4.860 m², të ndodhur në fshatin {***}, Shijak, duke paraqitur në mbështetje certifikatën e pronësisë.
51. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni i ka kërkuar subjektit të jepte shpjegime në lidhje me mospërputhjen midis deklarimeve të bëra në deklaratën *vetting* dhe deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2014, pasi në këtë të fundit ai nuk kishte deklaruar si burim ndihmën nga vëllai i tij, ndërsa në asnjërin prej tyre nuk ishte deklaruar shuma e dhënë nga nëna.
52. Lidhur me arsyet e mosdeklarimit të këtij burimi, subjekti ka sqaruar se me termin “kursime familjare” kishte përfshirë: (i) shumën 10.000 euro të paguar prej tij më datë 16.07.2010, sipas mandatpagesës pranë Alpha Bank Durrës; (ii) kontributin e nënës së tij në shumën 600.000 lekë, të përdorur për pagesën e këstit prej 10.000 eurosh më datë 29.04.2011, të plotësuar me shumën 5.500 euro të dhënë nga prindërit e bashkëshortes.

¹³ Për likuidimin e shumës 50.000 euro për blerjen e këtij apartamenti, rezulton se janë kryer veprimet bankare si vijojnë: depozitë në arkë në datën 16.7.2010, në llogarinë e shoqërisë “{***}” ShPK, në “Alpha Bank”, Durrës, shuma 10.000 euro, me përshkrimin “Kledian Llaho likuidim pjesor apartament”; depozitë në arkë, datë 22.12.2010, në llogarinë e shoqërisë “{***}” ShPK, në shumën 20.000 euro, me përshkrimin “Derdhje nga Kledian Llaho, likuidim pjesor blerje apartamenti”; dokument nxjerrje llogarie në emër të shtetases E. Ll. (nëna e subjektit) nga ProCredit Bank sipas të cilit është paguar prej saj në datën 29.4.2011, shuma 10.000 euro; mandatpagesë e shtetasit A. Ll. (vëllai i subjektit) në BKT, dega Durrës, sipas së cilës në datën 8.8.2011, është paguar shuma 7.000 euro, pa përcaktuar për cilin apartament është kryer kjo pagesë¹³; depozitim cash në valutë në BKT, datë 4.01.2012, në shumën 2.000 euro, në llogarinë e shoqërisë “{***}” ShPK, me përshkrimin “Kledian Llaho derdhje këst apartamenti”.

53. Sa u takon të ardhurave të nënës që kanë shërbyer për krijimin e shumës 600.000 lekë, subjekti deklaroi se ato buronin nga: (i) shitja e një pasurie tokë arë në fshatin {***}, Shijak, në shumën 400.000 lekë¹⁴; dhe (ii) pensioni i përfituar prej saj ndër vite¹⁵.
54. Komisioni i ka kërkuar subjektit të jepte shpjegime në lidhje me përbërjen faktike të familjes, vendbanimin dhe mënyrën e përballimit të shpenzimeve të jetesës, duke i mbështetur ato me dokumentacion përkatës. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti shpjegoi në mënyrë të përmbledhur se:
- (i) në periudhën 01.02.2000 – 31.12.2003¹⁶, ka jetuar i vetëm në Sarandë, me të ardhurat nga paga si OPGJ, duke paguar qira në shumën 3.000 lekë në muaj deri në fund të vitit 2002 dhe më pas 5.000 lekë në muaj, në kuadër të marrëdhënieve të paformalizuara me kontratë;
- (ii) në periudhën 01.01.2004 – mars 2007, ka jetuar në Durrës¹⁷, së bashku me nënën, bashkëshorten e vëllait dhe fëmijët e tyre, me të ardhura nga paga e tij si OPGJ në Tiranë, paga e bashkëshortes së vëllait si rrobaqepëse deri në korrik 2004 dhe ndihma financiare nga vëllai në emigracion;
- (iii) në periudhën mars 2007 - shtator 2007, ka jetuar me nënën e tij, ndërsa pas shtatorit 2007 ka filluar bashkëjetesën me bashkëshorten dhe më pas me fëmijët e tyre, të lindur më datat 27.08.2010 dhe 01.06.2013.
55. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për të ardhurat e përfituara nga nëna e tij nga shitja e një sipërfaqeje toke, referuar kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.10.2004, si dhe deklaratës noteriale nr. {***} rep., datë 22.10.2004, trupi gjykues konstaton se pjesa takuese e nënës së subjektit në këto pasuri ka qenë 1/4. Për rrjedhojë, ai e gjen të drejtë pretendimin e Komisionerit Publik se të ardhurat e përfituara nga nëna e subjektit nga shitja e dy pasurive, për pjesën e saj takuese, arrijnë në vlerën totale prej 100.000 lekësh dhe jo 200.000 lekë, sikurse ka përlllogaritur Komisioni në analizën financiare.

¹⁴ Për të provuar të ardhurat nga shitja e tokës arë nga nëna e tij, subjekti ka dorëzuar deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.07.2020, në të cilën deklaruesit deklarojnë se me shitjen e pasurive të trashëguara nga babai i tyre, tokë arë me sip. 4.680 m² dhe tokë arë me sip. 1.500 m² të ndodhura në fshatin {***}, sipas kontratës së shitjes të datës 17.10.2004, nr. {***} rep., nr. {***} kol., si dhe deklaratës noteriale nr. {***} rep., datë 22.10.2004, e gjithë vlera e shitjes është përfituar nga motra e tyre e madhe E. Ll.; kontratë shitblerjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.10.2004, ku pasuria tokë arë me sip. 4.680 m² shitet nga 4 pjesëtarë (njëra prej tyre është nëna e subjektit) kundrejt vlerës 200.000 lekë; deklaratë noteriale nr. {***} rep., datë 22.10.2004, ku deklarohet nga 4 deklaruesit (njëra prej tyre nëna e subjektit) shitja e tokës arë me sip. 1.500 m², ndodhur në fshatin {***}, në vlerën 200.000 lekë.

¹⁵ Të ardhurat nga pensioni i nënës së subjektit si dhe pensioni familjar u përlllogaritën referuar shkresave të ISSH-së me nr. {***} prot., datë 09.06.2022 dhe nr. {***} prot., datë 09.06.2022.

¹⁶ Subjekti sqaroi se shpenzimet e jetesës së bashkëshortes së vëllait dhe fëmijëve të saj, gjatë periudhës kohore kur ai ka jetuar dhe punuar në Sarandë, janë përballuar kryesisht nga të ardhurat e emigracionit të vëllait dhe paga e b/shortes së tij në Shqipëri.

¹⁷ Subjekti ka shpjeguar se deri në muajin maj 2006, kanë banuar në apartamentin që kanë pasur në b/pronësi me nënën dhe vëllain me b/shorten, të cilin e kanë shitur në gusht 2005, dhe pronari i ri qe jetonte në Greqi ua ka lënë në posedim deri në prill 2006, kur kanë blerë realisht apartamentin e ri në pronësi të nënës, por të realizuar me kontratë në shitje në korrik 2007. Me shkresën nr. {***}, {***} prot., datë 25.08.2021, të ASHK Drejtoria Vendore Durrës, është konfirmuar se subjekti, nëna dhe vëllai me b/shorten kanë pasur në pronësi apartamentin me nr. pas. {***} të blerë më datë 10.08.2000, të cilin e kanë shitur më datë 25.08.2005 dhe, më datë 27.07.2007, nëna e subjektit ka blerë apartamentin me nr. {***}.

56. Pavarësisht se nëpërmjet deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.07.2020, motrat e nënës së subjektit të rivlerësimit kanë deklaruar se të ardhurat nga shitja e pasurive të trashëguara nga babai i tyre, konkretisht tokë arë me sipërfaqe 4.680 m² dhe tokë arë me sipërfaqe 1.500 m², të ndodhura në fshatin {***}, sipas kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.10.2004 dhe deklaratës noteriale nr. {***} rep., datë 22.10.2004¹⁸, janë përfituar tërësisht nga motra e tyre e madhe E. Ll., trupi gjykues çmon se një fakt i tillë ka mbetur i aprovuar.
57. Deklarata noteriale e motrave të nënës së subjektit, e përpiluar gjatë procesit të rivlerësimit, nuk vlerësohet bindëse, për sa kohë që nuk mbështetet nga ndonjë dokument i kohës kur ka ndodhur shitja.
58. Referuar sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se të ardhurat e përfituara nga nëna e subjektit nga shitja e tokës duhet të konsiderohen në shumën 100.000 lekë, dhe jo në shumën 400.000 lekë, siç ka pretenduar subjekti i rivlerësimit, apo në shumën 200.000 lekë, siç i ka përlllogaritur Komisioni. Gjithashtu, trupi gjykues konstaton se, nëse analiza financiare e nënës së subjektit për periudhën 2000–2010 do të kryhej mbi bazën e të ardhurave dhe shpenzimeve të saj individuale, në ndryshim nga metodologjia e ndjekur nga Komisioni, i cili e ka kryer analizën në mënyrë kumulative, duke përfshirë të gjitha të ardhurat, shpenzimet dhe pasuritë e krijuara nga subjekti i rivlerësimit, bashkëshortja dhe nëna e tij, të trajtuar si një njësi e vetme familjare, do të rezultonte se nëna e subjektit nuk ka pasur burime të ligjshme financiare të mjaftueshme për t'i dhënë subjektit shumën prej 600.000 lekësh.
59. Lidhur me burimin “ndihmesë e vëllait nga punësimi në Itali”, në shumën 7.000 euro, Komisioneri Publik ka pretenduar në ankim se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi ndihmesë nga vëllai i punësuar në Itali, pa specifikuar vlerën e kësaj ndihme, ndërsa në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2014, subjekti nuk e ka deklaruar këtë burim krijimi. Referuar analizës financiare të kryer nga Komisioni, për të vlerësuar mundësinë e personit tjetër të lidhur për të krijuar me burime financiare të ligjshme shumën 7.000 euro, dhënë subjektit, ka rezultuar një pamjaftueshmëri në vlerën (-) 1.668 euro. Në ndryshim nga Komisioni, Komisioneri Publik ka çmuar se shpenzimet e jetesës për familjen e z. A. Ll., në këtë analizë nuk janë llogaritur në përputhje me përbërjen familjare dhe me të dhënat e Eurostat-it, çka do të çonte në një pamjaftueshmëri në një vlerë më të madhe se ajo e konstatuar nga Komisioni.
60. Për sa më sipër, trupi gjykues konstaton si vijon.
61. Rezulton se Komisioni, për të verifikuar mundësinë financiare të vëllait të subjektit të rivlerësimit për të krijuar me burime të ligjshme shumën 7.000 euro të dhënë subjektit, ka kryer

¹⁸ Në kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.10.2004, ku pasuria tokë arë me sip. 4.680 m² rezulton të jetë shitur nga 4 bashkëpronarët (njëra prej tyre është nëna e subjektit) kundrejt vlerës 200.000 lekë; në deklaratën noteriale nr. {***} rep., datë 22.10.2004, ku deklarohet nga 4 deklaruesit (njëra prej tyre nëna e subjektit), shitja e tokës arë me sip. 1.500 m², ndodhur në fshatin {***}, në vlerën 200.000 lekë.

analizën financiare për periudhën nga data 02.03.2011 deri më datë 08.08.2011¹⁹, datë kjo që përkon me kryerjen e pagesës nga vëllai i subjektit.

62. Nga kjo analizë, ka rezultuar një balancë negative në shumën prej (-) 1.668 eurosh.
63. Megjithatë, Komisioni, duke zbatuar parimin e proporcionalitetit, e ka konsideruar shumën 7.000 euro si burim të ligjshëm në analizën financiare përfundimtare të subjektit të rivlerësimit.
64. Sipas ankuesit, shpenzimet e jetesës duhej të llogariteshin nga Komisioni në përputhje me përbërjen e njësisë familjare të vëllait dhe mbi bazën e të dhënave të Eurostat-it, të cilat, për një familje me katër anëtarë dhe për një periudhë gjashtëmujore, rezultojnë në shumën rreth 10.000 euro.
65. Gjatë shqyrtimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioneri Publik dhe, më pas, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme nuk kanë argumentuar në aspektin juridik periudhën kohore që duhej marrë në konsideratë për kryerjen e analizës financiare të vëllait të tij në funksion të verifikimit të mundësisë së kursimit.
66. Sipas subjektit të rivlerësimit, analiza financiare për verifikimin e mundësisë së krijimit të shumës 7.000 euro, të dhënë prej vëllait të tij, duhej të shtrihej në të gjithë periudhën e punësimit të këtij të fundit në Itali.
67. Në vlerësim të sa më sipër, trupi gjykues konstaton se, referuar deklaratës *vetting* dhe deklaratës para fillimit të detyrës në vitin 2014, burimi “ndihmë nga vëllai” nuk është deklaruar në këtë të fundit, ndërsa në deklaratën *vetting* është pasqyruar pa u specifikuar vlera e ndihmës së përfituar.
68. Trupi gjykues, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, kontrolloi analizën financiare të kryer nga Komisioni në lidhje me mundësinë financiare të vëllait të subjektit të rivlerësimit për të krijuar shumën 7.000 euro.
69. Nga ky kontroll rezultoi se, ndonëse në tabelën e analizës financiare të pasqyruar në faqen 18 të vendimit Komisioni ka përshkruar zërin “Shpenzime jetese për 4 persona”, në vlerën 6.079 euro, përllogaritja konkrete nuk korrespondon me shpenzimet e jetesës për një njësi familjare me katër anëtarë sipas Eurostat-it²⁰. Për rrjedhojë, trupi gjykues e gjen të drejtë pretendimin e Komisionerit Publik se shpenzimet e jetesës së vëllait të subjektit nuk janë përllogaritur në përputhje me përbërjen e njësisë së tij familjare.
70. Nëse analiza financiare do të kryhej për periudhën prill 2004 – 08.08.2011, rezulton se vëllai i subjektit të rivlerësimit do të kishte mundësi financiare për të kursyer shumën 7.000 euro, pasi

¹⁹ Komisioni ka kryer hetim të thelluar në lidhje me mundësinë e z. A. Ll. për dhënien e shumës 7.000 euro subjektit të rivlerësimit më datë 08.08.2011 dhe, duke iu referuar faktit se ai deri në datën 2.3.2011, ka paguar dy këste për blerjen e një apartamenti në emër të tij, me vlerë 50.000 euro, mundësia e tij për t'i dhënë subjektit shumën 7.000 euro është përllogaritur duke kryer analizën financiare nga data 2.3.2011 deri më 8.8.2011.

²⁰ Shpenzimet e jetesës për vitin 2011, për një familje me dy të rritur dhe dy fëmijë, janë në vlerën 20.123 euro (20.123 euro / 2 = 10.062 euro për 6 muaj) – Statistics | Eurostat.

të ardhurat e provuara nga punësimi²¹ për këtë periudhë, arrijnë në shumën 139.008 euro, ndërsa shpenzimet e jetesës²² përllorësit në shumën 113.726 euro, duke rezultuar kursime të mundshme në vlerën 25.282 euro.

71. Sipas jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit, analiza financiare e personit tjetër të lidhur duhet të kufizohet në verifikimin e burimeve të ligjshme të nevojshme për krijimin e shumës së dhënë subjektit të rivlerësimit, pa përfshirë në këtë analizë pasuritë dhe shpenzimet e tjera të personit të lidhur. Për rrjedhojë, trupi gjykues e vlerësoi të drejtë pretendimin e subjektit të rivlerësimit se vëllai i tij kishte mundësi financiare me të ardhura të ligjshme, për krijimin e shumës së dhënë subjektit të rivlerësimit. Për këtë burim financiar, ngelet vetëm problematika e identifikuar më sipër lidhur me deklarin e paplotë dhe të pasaktë të tij.
72. Lidhur me burimin “ndihmesë e prindërve të bashkëshortes” në shumën 1.500.000 lekë për blerje apartamenti dhe 7.000 euro për arredim, Komisioneri Publik ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *vetting* dhe në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2014, si burim krijimi për apartamentin me sipërfaqe 105 m², *ndihmesë nga prindërit e bashkëshortes*, por në asnjërën prej këtyre deklaratave nuk ka deklaruar se sa është shuma e dhënë prej tyre. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka qenë kontradiktor dhe i pasaktë në deklarin e tij lidhur me shumën, kohën e dhënies së tyre nga prindërit e bashkëshortes, si dhe burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për dhënien e shumës 1.500.000 lekë dhe 7.000 euro. Sipas ankuesit, investimi që prindërit e bashkëshortes së subjektit kanë bërë pas shitjes së apartamentit në vitin 1997 për ndërtimin e një objekti tregtar hotel/restorant në qytetin e Sarandës, marrja e disa kredive bankare në funksion të aktivitetit të tyre tregtar, si dhe sasia e të ardhurave të realizuara nga ky aktivitet deri në vitin 2013, nuk mundësojnë mbulimin e shpenzimeve për jetesë, kredi dhe për t’i dhënë subjektit dhe personit të lidhur (bashkëshortes) shumën 1.500.000 lekë dhe 7.000 euro.
73. Komisioni ka vlerësuar si të provuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit lidhur me ndihmën e dhënë nga prindërit e bashkëshortes, duke konsideruar shumën prej 11.000 eurosh/1.500.000 lekësh si burim të ligjshëm për blerjen e apartamentit të banimit.
74. Ndërsa, sa i takon shumën prej 7.000 eurosh, të transferuar në llogarinë bankare të djalit të subjektit më datë 08.04.2013, Komisioni ka konkluduar se prindërit e bashkëshortes së subjektit nuk kanë pasur mundësi financiare, në shumën (-) 573.421 lekë, për të justifikuar këtë transfertë. Për rrjedhojë, ai nuk e ka përfshirë këtë shumë si të ardhur të ligjshme në analizën financiare të subjektit për vitin 2013.
75. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, pretendoi se Komisioneri Publik anashkalon faktin se ndihma e prindërve të bashkëshortes është detajuar në mënyrë të hollësishme në procesverbalin e ILDKPKI-së të vitit 2016 dhe se, edhe në këtë rast, bëhet fjalë për një

²¹ Të ardhurat nga paga janë të ardhurat mbi të cilat janë përllorësit kontributet e sigurimeve dhe jo të ardhurat neto.

²² Shpenzimet e jetesës janë përllorësit për 1 person nga muaji prill 2004 deri në shkurt 2007 dhe më pas janë përllorësit për 4 persona, referuar deklaratës noteriale, datë 11.06.2022, ku vëllai i subjektit, z. A. Ll., deklaroi se nga muaji mars 2007 bashkëshortja dhe fëmijët e tij kanë shkuar për të jetuar në Itali.

pasaktësi minimale në deklaratën *vetting*, e cila nuk mund të ngrihet në nivelin e një shkaku shkarkimi. Sipas subjektit, deklarimet e tij nuk cenojnë thelbin e burimit të pasurisë dhe nuk kanë ardhur si pasojë e qëllimit për të fshehur apo deklaruar në mënyrë të pasaktë këtë pasuri. Sipas subjektit, Komisioneri Publik nuk ka paraqitur asnjë argument konkret se ku konsiston deklarimi kontradiktor, duke konfunduar nocionin e “pasaktësisë” me atë të “kontradiktës” dhe duke mos marrë në konsideratë rrethanat konkrete të faktit.

76. Lidhur me pretendimin e ankuesit se subjekti ka qenë kontradiktor dhe i pasaktë edhe për sa i përket burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e shumës 1.500.000 lekë, subjekti i rivlerësimit prapësoi duke pretenduar se ai është i pabazuar, pasi janë keqinterpretuar sqarimet e dhëna prej tij pranë ILDKPKI-së. Ai argumentoi se në procesverbalin e datës 10.02.2016, është deklaruar ndihma e dhënë nga prindërit e bashkëshortes si një ndër burimet e krijimit të pasurisë “apartament banimi”, por jo burimi konkret i shumës 1.500.000 lekë. Po ashtu, subjekti pretendoi se në procesverbalin e deklarimit, ai ka përshkruar vetëm veprimtarinë ekonomike të ushtruar nga prindërit e bashkëshortes, pa deklaruar se shuma prej 1.500.000 lekësh kishte rrjedhur pikërisht nga ky aktivitet. Sipas tij, qëllimi ka qenë të evidentonte llojin e aktivitetit të tyre ekonomik dhe potencialin financiar që ata kishin për të ndihmuar vajzën e tyre në përballimin e një shpenzimi të rëndësishëm, siç ishte blerja e një apartamenti.
77. Subjekti pretendoi se, nga interpretimi logjik dhe gramatikor i deklarimeve të tij në procesverbal, rezulton se ndihma nga prindërit e bashkëshortes ka qenë reale, e vërtetë dhe e ligjshme, duke qenë se ata ushtronin prej shumë vitesh një aktivitet fitimprurës. Sipas tij, burimi specifik i shumës prej 1.500.000 lekësh nuk është deklaruar asnjëherë përpara përgjigjeve të pyetësorit nr. 3, ku është sqaruar se kjo shumë kishte si burim të ardhurat nga shitja e apartamentit të prindërve të bashkëshortes në vitin 1997, sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.01.1997.
78. Në vijim, subjekti iu referua jurisprudencës së Kolegjit, duke pretenduar se ekzistojnë raste të ngjashme në të cilat pasaktësitë në deklarime nuk janë konsideruar shkak për penalizimin e subjekteve të rivlerësimit, në mungesë të veprimeve të qëllimshme për të rritur artificialisht të ardhurat e deklaruara. Po ashtu, ai argumentoi se Komisioneri Publik nuk ka marrë në konsideratë faktin se as ai dhe as prindërit e bashkëshortes nuk kanë qenë subjekte të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar. Në kushtet kur aktiviteti ekonomik, kreditë dhe pasuritë e prindërve të bashkëshortes janë krijuar përpara lidhjes së martesës, subjekti pretendoi se, në përputhje me jurisprudencën e Kolegjit, ai nuk mund të ngarkohet me barrën e provës për të gjitha pasuritë e personave të lidhur, përveç rasteve të pasurive objekt dhurimi ose huaje, pa u shtrirë ky detyrim mbi të gjitha pasuritë e tyre të krijuara përpara lidhjes së martesës²³.
79. Nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të Komisionit, trupi gjykues, lidhur me shumën 1.500.000 lekë dhe 7.000 euro, konstaton si vijon.

²³ Subjekti i rivlerësimit i referohet vendimit nr. 20, datë 03.05.2023, të Kolegjit që lidhet me subjektin e rivlerësimit B. M., si dhe vendimit nr. 26, datë 03.07.2023, të Kolegjit për subjektin e rivlerësimit, znj. G. Xh..

80. Në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2014 dhe në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar si burim krijimi për apartamentin e banimit, ndihmën nga prindërit e bashkëshortes, pa specifikuar vlerën e kësaj ndihme.
81. Në procesverbalin e ILDKPKI-së të datës 10.02.2016, i pyetur në lidhje me secilin prej burimeve që kanë shërbyer për krijimin e apartamentit me sipërfaqe 105 m² dhe mundësinë financiare të prindërve të bashkëshortes, subjekti ka deklaruar se kishte përfituar ndihmë nga prindërit e bashkëshortes, të cilët ushtronin aktivitet privat që prej vitit 1996, me objekt bar-restorant dhe, që nga vitet 1999–2000, me objekt bar-restorant-hotel²⁴. Subjekti ka sqaruar se vlera e dhënë prej tyre ishte 1.500.000 lekë dhe se një pjesë e kësaj shume, në vlerën 7.000 euro, ishte derdhur nga vjehri ose vjehra në llogarinë e djalit të tij, B. Ll., për shkak se ky i fundit dispononte llogari në euro.
82. Gjatë hetimit administrativ në Komision, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se kontributi i prindërve të bashkëshortes, në shumën 1.500.000 lekë (11.000 euro), është dhënë përgjatë vitit 2010 dhe gjatë vitit 2011²⁵. Ai ka sqaruar se deklarimi i bërë pranë ILDKPKI-së në vitin 2016, sipas të cilit shuma prej 7.000 eurosh e transferuar në llogarinë e djalit të tij më datë 08.04.2013, përbënte pjesë të ndihmës për apartamentin, ka qenë një pasaktësi lidhur me kohën dhe qëllimin e transferimit të kësaj shume, duke krijuar konfuzion në lidhje me shumën totale të kontributit të prindërve të bashkëshortes. Sipas subjektit, në të vërtetë kjo shumë ka përbërë ndihmë për arredimin e apartamentit. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti ka paraqitur edhe kontratën e kredisë bankare të marrë nga prindërit e bashkëshortes.
83. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar se burimi i shumës prej 1.500.000 lekësh (rreth 11.000 euro, sipas kursit të kohës), të dhënë nga prindërit e bashkëshortes, kanë qenë të ardhurat nga shitja e apartamentit të tyre në vitin 1997, sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.01.1997, në vlerën 1.600.000 lekë. Sipas subjektit, pas shitjes së këtij apartamenti, vjehri i tij, në muajin janar 1997, i ka dhënë hua mikut të tij, z. I. S., shumën 1.500.000 lekë, pa dokumentacion shkresor të kohës, dhe ky i fundit ia ka kthyer atë në muajin nëntor 2010²⁶. Kjo shumë i është dhënë bashkëshortes së subjektit dhe është përdorur për pagesën e pjeshme të kësteve për blerjen e apartamentit.

²⁴ Nga dokumentacioni i administruar nga ILDKPKI-ja, rezulton se për aktivitetin tregtar bar-restorant-hotel, në Sarandë, të prindërve të bashkëshortes, subjekti ka paraqitur ekstrakt historik QKB, V. Gj. (babi i b/shortes); ekstrakt historik QKB, L. Gj. (nëna e b/shortes); foto të objektit katërkatësh, kontratë qiraje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.03.2015, për dhënie me qira nga z. V. Gj. shoqërisë “{***}” ShPK dhe shoqërisë “{***}” ShPK, të ambienteve për zyra dhe qëndrim për një periudhë 24-mujore.

²⁵ Subjekti ka sqaruar se vlera 2.500 euro është përdorur më 22.12.2010 për plotësimin e kështit prej 20.000 eurosh, paguar në këtë datë, për shkak se vlera e kredisë prej 2.427.000 lekësh konvertohej në 17.500 euro dhe ishte e pamjaftueshme; ii) vlera 5.500 euro është përdorur në datën 29.4.2011 së bashku me vlerën 600.000 lekë/4.500 euro të kontributit të nënës së tij, duke formuar kështu shumën prej 10.000 eurosh, shlyer sipas mandatpagesës së kësaj date; iii) shuma prej 2.000 eurosh është përdorur në datën 4.1.2012, kur është kryer pagesa në BKT, sipas mandatpagesës së kësaj date; iv) nuk ka deklarime për periudhën e dhënies së shumës 1.000 euro.

²⁶ Për të provuar këtë pretendim, subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.08.2022, me deklarues z. V. Gj. dhe z. I. S., ku deklarohet se z. V. Gj., në janar të vitit 1997, pasi kishte shitur apartamentin e tij të banimit, i ka dhënë z. I. S. borxh shumën prej 1.500.000 lekësh (në dorë) për qëllime të zhvillimit të biznesit, shumë e cila i është kthyer në nëntor 2010.

84. Nga sa më lart, rezulton se në procesverbalin e ILDKPKI-së, datë 10.02.2016, subjekti ka deklaruar fillimisht si burim të ardhurat e prindërve të bashkëshortes nga aktiviteti i tyre privat ushtruar që prej vitit 1996, ndërkohë gjatë hetimit administrativ, ai e ka ndryshuar këtë deklaram, duke pretenduar se burimi i shumës prej 1.500.000 lekësh kanë qenë të ardhurat nga shitja e apartamentit të prindërve të bashkëshortes në vitin 1997.
85. Lidhur me pretendimin e subjektit se shuma prej 1.500.000 lekësh ka pasur si burim shitjen e një apartamenti në vitin 1997 nga kontrata e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.01.1997, nga e cila rezulton se prindërit e bashkëshortes kanë përfutuar shumën prej 1.600.000 lekësh, trupi gjykues konstaton se pretendimi tjetër i subjektit se kjo shumë i ishte dhënë fillimisht hua shtetasit I. S. për periudhën 1997-2010, para se t'i jepej bashkëshortes së tij në vitet 2010, 2011, nuk mbështetet në ndonjë dokument ligjor të kohës. Si të vetmen provë, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.08.2022, të shtetasit I. S., të cilën trupi gjykues, në ndryshim nga Komisioni, e konsideron të pamjaftueshme për të provuar këtë fakt juridik.
86. Lidhur me të ardhurat e përfuturara nga prindërit e bashkëshortes nga aktiviteti tregtar, referuar dokumentacionit të administruar në dosjen e ILDKPKI-së, si dhe dokumentacionit të depozituar nga subjekti gjatë hetimit administrativ, rezulton se z. V. Gj. ka ushtruar aktivitet si person fizik që prej datës 01.01.2003, me fushë veprimtarie “Restorant”, deri në çregjistrimin e tij më datë 15.03.2016. Ndërkohë, znj. L. Gj. ka filluar aktivitetin si person fizik më datë 25.11.2015, me fushë veprimtarie “Hotel-Restorant”, me status aktual “Pezulluar”.
87. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ndihma nga prindërit e bashkëshortes i është dhënë gjatë viteve 2010 - 2011. Nga të dhënat e përcjella me shkresën nr. {***} prot., datë 08.08.2017, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë, rezulton se fitimi i realizuar nga z. V. Gj. për vitet 2009 - 2011 ka qenë në shumën 1.880.085 lekë²⁷. Kolegjit i rezulton se shpenzimet e jetesës për prindërit e bashkëshortes për të njëjtën periudhë, janë në shumën 819.720 lekë dhe, si rrjedhojë, mundësia e kursimit të tyre ka qenë në shumën 1.060.365 lekë, e cila është dukshëm e pamjaftueshme për dhënien e shumës 1.500.000 lekë subjektit të rivlerësimit.
88. Sa i përket aktivitetit të znj. L. Gj., rezulton se fitimi i realizuar për vitet 2015–2016, ka qenë në shumën 113.535 lekë, të ardhura të cilat janë përfutuar pas periudhës kur pretendohet të jetë dhënë kontributi për blerjen e apartamentit në favor të vajzës së tyre.
89. Sa i takon shumës prej 7.000 eurosh, të transferuar në llogarinë e djalit të tij në muajin prill 2013, subjekti fillimisht ka deklaruar në procesverbalin e ILDKPKI-së, datë 10.02.2016, se vlera e ndihmës së dhënë nga prindërit e bashkëshortes ka qenë 1.500.000 lekë dhe se pjesë e kësaj ndihme ka qenë edhe shuma prej 7.000 eurosh, e transferuar në llogarinë bankare të djalit të tij në vitin 2013. Ndërkohë, gjatë hetimit administrativ, subjekti e ka ndryshuar këtë deklaram, duke pretenduar se shuma prej 1.500.000 lekësh i është dhënë gjatë viteve 2010-

²⁷ Fitimi për vitin 2009 në shumën 867.308 lekë, në vitin 2010 në shumën 583.687 lekë dhe në vitin 2011 në shumën 429.090 lekë.

2011, ndërsa shuma prej 7.000 eurosh nuk ka qenë pjesë e kësaj ndihme, por është dhënë më vete, në vitin 2013, për një qëllim tjetër.

90. Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti ka deklaruar se burimi shumës 7.000 euro kanë qenë të ardhurat e përfituara nga vjehri si rezultat i dhënies në përdorim të vendparkimeve poshtë hotelit të tij gjatë viteve 2010-2013, kundrejt një shpërblimi prej 3.500 eurosh në vit. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti ka depozituar një aktmarrëveshje të thjeshtë, datë 29.09.2010, ndërmjet vjehrit të tij, z. V. Gj., dhe administratorit të shoqërisë “{***}” ShPK, z. V. K., sipas së cilës palët kanë rënë dakord që shtatë garazhet në pronësi të vjehrit të subjektit të përdoren për parkimin e mjeteve të shoqërisë “{***}” ShPK për periudhën tetor-mars të çdo viti, për një afat total trevjeçar (2010-2013). Pagesa është përcaktuar në shumën 3.500 euro për çdo periudhë gjashtëmujore dhe detyrimet ndaj organeve tatimore do të përmbusheshin nga shoqëria “{***}” ShPK. Bashkë me përgjigjet e pyetësorit nr. 3, subjekti ka paraqitur edhe dosjen e kredive bankare²⁸, të marra nga vjehri i tij në vitet 2004 dhe 2010 për kryerjen e investimeve dhe zgjerimin e Hotel Gj. në Sarandë.
91. Subjekti ka depozituar në Komision deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.12.2022, në të cilën V. Gj. deklaron se ka marrë nga V. K. shumën prej 10.500 eurosh dhe se të ardhurat e përfituara nga qiraja i janë likuiduar në një kësht të vetëm për çdo periudhë gjashtëmujore.
92. Referuar vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues konstaton se Komisioni nuk i ka konsideruar këto të ardhura si të ligjshme, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, me arsyetimin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të shumës prej 7.000 eurosh²⁹. Trupi gjykues vlerëson se ky burim mbeti i paprovuar edhe gjatë gjykimit në Kolegj.
93. Nga analizimi në tërësinë e tyre i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratën *vetting*, në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2014, në procesverbalin e ILDKPKI-së, datë 10.02.2016, dhe krahasimi i tyre me deklaratimet e dhëna nga subjekti gjatë hetimit administrativ lidhur me ndihmën e dhënë nga prindërit e bashkëshortes, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka qenë kontradiktor dhe i pasaktë në deklaratimet e tij lidhur me vlerën reale të shumave të përfituara, kohën e dhënies dhe burimin e krijimit të tyre dhe, për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit është i pabesueshëm lidhur me këto deklarime.
94. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting*, në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2014, nuk ka deklaruar shumat e dhëna si kontribut nga nëna, vëllai dhe prindërit e bashkëshortes, si dhe ka deklarime kontradiktore lidhur me burimin e krijimit dhe kohën e marrjes së ndihmës financiare nga prindërit e bashkëshortes, trupi gjykues e gjen të drejtë pretendimin e ankuesit se pamundësohet kontrolli i burimit tjetër të deklaruar “kursime familjare”, nga të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes.

²⁸ Kontratë kredie bankare, datë 18.05.2004, mes V. dhe L. Gj. dhe American Bank of Albania në shumën 50.000 USD, me qëllim përdorimin për përfundimin e punimeve të brendshme të objektit bar-restorant-hotel; amendament i kontratës së kredisë bankare; statement bankar i llogarisë nr. {***} në euro, në emër të V. dhe L. Gj. etj.

²⁹ Analizuar në paragrafët 33-36 të vendimit objekt shqyrtimi.

95. Në përfundim të analizës së mësipërme, trupi gjykues çmon të drejtë pretendimin e ankuesit se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklaramit kontradiktor, të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, çka i ka vënë institucionet e rivlerësimit në pamundësi për të verifikuar se cili ndër deklaramet e tij pasqyron situatën e vërtetë faktike lidhur me burimin e krijimit të pasurisë, duke cenuar kështu besueshmërinë e tij në kriterin e kontrollit të pasurisë.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e kontrollit të figurës

96. Komisioni, në përfundim të procesit të vlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm, referuar nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016.

97. Komisioneri Publik nuk ka kundërshtuar në ankim këtë vlerësim të Komisionit lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, por kundërshton vlerësimin e Komisionit lidhur me gjetjet e konstatuara për tri nga katër procedimet penale të trajtuara³⁰ mbi bazën e *indicieve* të përfuara nga informacioni i klasifikuar “sekret shtetëror” i administruar gjatë kontrollit të kriterit të figurës dhe që Komisioni i ka shqyrtuar në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit. Sipas ankuesit, shkeljet e konstatuara në këto procedime penale, të vlerësuara në mënyrë tërësore dhe në ndërthurje me informacionet e përcjella nga agjencitë ligjzbatuese, marrin peshë dhe rëndësi të veçantë në vlerësimin e çështjes.

98. Komisioneri Publik pretendon se, në dritën e jurisprudencës së Kolegjit³¹, analiza e këtyre shkeljeve krijon *indicie* dhe perceptime të rëndësishme se integriteti i subjektit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 75, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, duhet të konsiderohet i cenuar.

99. Në kundërshtim me shkakun e ankimit, subjekti i rivlerësimit parashtroi se Komisioneri Publik nuk ka zhvilluar një argumentim të pavarur, por është kufizuar në riprodhimin, pa modifikime, të arsyetimeve dhe përfundimeve të nxjerra nga Kolegji në jurisprudencën e tij, çka, sipas subjektit, cenon parimin e kontradiktoritetit dhe autonominë e palëve në proces. Sipas tij, referimi në një argument të përdorur nga Kolegji në një çështje tjetër, të lidhur me një subjekt tjetër rivlerësimi dhe me rrethana faktike të ndryshme, është i gabuar dhe i papranueshëm për qëllimet e këtij gjykimi.

100. Po ashtu, subjekti pretendoi se nuk është njohur asnjëherë me informacionet e agjencive ligjzbatuese që, sipas Komisionerit Publik, përmbajnë elemente në drejtim të integritetit të tij. Në mungesë të njohjes me këtë informacion, ai argumenton se ushtrimi efektiv i së drejtës së mbrojtjes ndaj pretendimeve të Komisionerit Publik, zhvillohet në kushte pabarazie dhe se argumentimi mbi këto pretendime nuk mund të shtjellohet më tej.

101. Sipas subjektit, kontrolli i figurës duhet të mbështetet në fakte konkrete dhe prova të besueshme, duke respektuar garancitë e procesit të rregullt ligjor, përfshirë parimet e barazisë

³⁰ *Procedimet penale nr. {***}/2019, nr. {***}/2018 dhe nr. {***}/2021 janë marrë në shqyrtim nga Komisioni në kuadër të vlerësimit të kriterit të figurës pasi u verifikuan informacionet konfidenciale pranë agjencive ligjzbatuese, por janë analizuar nga Komisioni në kuadër të aftësive profesionale të subjektit.*

³¹ *Sipas vendimit (JR) nr. 16/2021 të Kolegjit.*

së armëve, paanshmërisë dhe gjykimit të drejtë. Në këtë kuadër, vlerësimi duhet të jetë objektiv dhe transparent, duke garantuar të drejtat e mbrojtjes së magjistratit, përfshirë të drejtën për t'u dëgjuar dhe për të paraqitur prova në favor të tij. Kontrolli i figurës nuk mund të shndërrohet në një mjet presioni apo përndjekjeje të pajustificuar, pasi kjo do të dëmtonte jo vetëm magjistratin, por edhe besueshmërinë e sistemit të drejtësisë në tërësi.

102. Më konkretisht, ankuesi pretendoi në ankimin e paraqitur si vijon.
103. Në lidhje me procedimin penal nr. {***}/2019 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë (në vijim “procedimi penal nr. {***}/2019”), për të cilin ankuesi pretendoi se veprimet hetimore të ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit kanë qenë joefektive, të paplota dhe jo të gjithanshme, si dhe se subjekti nuk ka treguar kujdesin e duhur për kryerjen, brenda afateve të arsyeshme, të veprimeve hetimore të nevojshme dhe të lidhura me objektin e akuzës ndaj personave të arrestuar, në kundërshtim me nënindiktorët e parashikuar në nenin 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të Komisionit, konstatoi si vijon.
104. Referuar arsytimit të Komisionit në vendim (paragrafi 95), lidhur me procedimin penal nr. {***}/2019, kërkesa e subjektit të rivlerësimit për shuarjen e masës së sigurimit “arrest në burg” është konsideruar si rezultat i një interpretimi ligjor dhe vlerësimi profesional të bërë prej tij, për të cilin gjykata ka pasur një interpretim të ndryshëm. Komisioni ka vlerësuar se kjo kërkesë nuk ka sjellë pasoja negative në zgjidhjen përfundimtare të çështjes.
105. Komisioneri Publik, në ankim, ka argumentuar se nga analiza e situatës faktike, rezulton se, nga data e vendimit nr. {***}, datë 15.06.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me të cilin është bërë vleftësimi i “arrestit në flagrancë” dhe caktimi i masës së sigurimit “arrest në burg” ndaj shtetasve të dyshuar në kuadër të procedimit penal nr. {***}/2019, deri në datën 25.02.2020, kur gjyqtari paraprak, me vendimin nr. {***}, ka vendosur kalimin e çështjes për gjykim me akuzat përkatëse, kanë kaluar më shumë se tetë muaj.
106. Sipas Komisionerit Publik, gjatë kësaj periudhe, veprimet hetimore të ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit kanë qenë joefektive, të paplota dhe jo të gjithanshme, duke treguar mungesë diligjence për kryerjen, brenda afateve të arsyeshme, të veprimeve hetimore të nevojshme dhe të lidhura drejtpërdrejt me akuzën ndaj personave të arrestuar.
107. Komisioneri Publik pretendon se kjo mungesë diligjence ka sjellë pasoja në formulimin e akuzës, duke çuar edhe në kërkesën për ndryshimin e cilësimit juridik të veprave penale. Në mbështetje të këtij pretendimi, ai i referohet arsytimit të vendimit nr. {***}/2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, sipas të cilit, mbi të njëjtin fakt penal dhe mbi të njëjtat prova, gjatë kësaj periudhe nuk ka rezultuar asnjë e dhënë thelbësore e ardhur nga një veprimtari hetimore e plotë, që të justifikonte një cilësim juridik të ndryshëm të veprës penale nga ana e prokurorit të çështjes.
108. Sipas Komisionerit Publik, ky rikualifikim juridik i veprës penale ka passjellë edhe kërkesën e subjektit të rivlerësimit për ndryshimin e masave të sigurimit, për shkak se afatet e paraburgimit, në kushtet e cilësimit të ri juridik, shtriheshin deri në gjashtë muaj. Po ashtu, ai

vëren se vetë subjekti i rivlerësimit ka pranuar tejkalimin e afateve, duke iu referuar arsyeve objektive, të cilat, sipas Komisionerit Publik, nuk janë argumentuar prej tij.

109. Lidhur me shkakun e ankimit që i përket procedimit penal nr. {***}, datë 11.06.2019, subjekti i rivlerësimit parashtrori, në mënyrë të përmbledhur, se: (i) veprimet hetimore të kryera prej tij në këtë procedim penal kanë qenë të shpejta, objektive dhe të gjithanshme, ndërsa qëndrimi i tij në raport me ndjekjen dhe ndëshkimin e veprës penale ka qenë në përputhje me dispozitat e ligjit material dhe procedural penal; (ii) ndonëse kërkesa e tij për shuarjen e masës së sigurisë “arrest në burg” nuk u pranua nga gjyqtari i hetimeve paraprake, ai vlerësoi të mos ushtronte ankim ndaj këtij vendimi, për shkak se hetimet ndodheshin në fazën përmbyllëse dhe do të paraqitej kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq; (iii) kërkesa e tij nuk solli asnjë pasojë negative në vijimin dhe zgjidhjen e çështjes, ndërsa vendimi nr. {***}, datë 20.12.2019, i Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, për mospranimin e kërkesës për shuarjen e masës së sigurisë, është i paarsyetuar dhe i pamjaftueshëm në argumentimin e tij; dhe (iv) kërkesa e paraqitur prej tij dëshmon dilijencë dhe kujdes të shtuar në drejtim të garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të personave të proceduar nën masën e sigurisë, të parashikuara në Kushtetutë dhe në legjislacionin procedural penal. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka mbajtur një qasje në kundërshtim me jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit, sipas së cilës qëndrimi i ndryshëm i gjykatës ndaj kërkesës së prokurorit nuk mund të sjellë pasoja penalizuese për këtë të fundit³². Ky qëndrim, sipas subjektit, është përforcuar edhe nga vendimi nr. 28/2020 i Kolegjit, që i përket subjektit të rivlerësimit F. V..
110. Në vijim të sa më sipër, nga analiza e akteve të administruara nga Komisioni³³ në lidhje me këtë procedim penal, trupi gjykues konstaton si më poshtë.
111. Nga aktet e fashikullit penal të administruar nga Komisioni, rezultoi e provuar se, më datë 11.06.2019, subjekti i rivlerësimit, pasi është njoftuar për ngjarjen e ndodhur në fshatin {***}, Njësia Administrative {***}, Bashkia Selenicë, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprat penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, e kryer në bashkëpunim, me viktimë A. Gj. dhe e mbetur në tentativë ndaj shtetasit F. O., si dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe municionit”, të parashikuara nga nenet 79/dh, 25 dhe 278/1 të Kodit Penal.
112. Më datë 12.06.2019, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar regjistrimin e emrave të personave të cilëve u atribuohet kryerja e veprave penale, konkretisht shtetasve M. B. (P.) dhe J. B. për veprat penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, e kryer në bashkëpunim, dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe municionit”, si dhe shtetasve A. B. dhe N. B. për veprën penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, e kryer në bashkëpunim.
113. Po në këtë datë, subjekti i rivlerësimit i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me kërkesë për vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit personal “arrest në burg” ndaj A. B., N. B. dhe J. B.. Me vendimin nr. {***}, datë 15.06.2019, Gjykata

³² Subjekti i rivlerësimit referon vendimin nr. 33/2021 të Kolegjit që i përket subjektit të rivlerësimit N. T..

³³ Përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me shkresën nr. {**} prot., datë 18.10.2022.

e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur vleftësimin si të ligjshëm të arrestimeve dhe caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” për këta shtetas.

114. Më datë 17.06.2019, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” edhe për shtetasin M. B., i cili nuk ishte arrestuar në flagrancë ditën e ngjarjes. Kjo kërkesë është pranuar nga gjykata me vendimin nr. {***}, datë 19.06.2019.
115. Në vijim të hetimeve, subjekti i rivlerësimit ka vendosur zgjatjen e afatit hetimor në dy raste: (i) më datë 12.09.2019, për një periudhë tremujore deri më 11.12.2019, me arsyetimin e nevojës për kryerjen e veprimeve hetimore shtesë, përfshirë pyetjen e personave që kishin dijeni për ngjarjen, administrimin e të dhënave shkencore dhe akteve të ekspertimit, si dhe kryerjen e veprimeve të tjera procedurale; dhe (ii) më datë 11.12.2019, për një periudhë njëmujore deri më 12.01.2020, me arsyetimin se të pandehurit nuk kishin zgjedhur mbrojtës dhe ishte i nevojshëm caktimi kryesisht i një mbrojtësi, komunikimi i akuzës, pyetja e tyre në cilësinë e të pandehurve, si dhe paraqitja në gjykatë e kërkesës për deklarimin e ikjes së të pandehurit M. B..
116. Më datë 13.12.2019, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale të regjistruar në kuadër të procedimit penal nr. {***}/2019, nga vepra penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, e kryer në bashkëpunim, me viktimë A. Gj. dhe e mbetur në tentativë ndaj F. O., në veprën penale “Vrasja nga pakujdesia”, në dëm të shtetasit A. Gj., të parashikuar nga neni 85 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit M. B. (P.).
117. Më datë 18.12.2019, subjekti i rivlerësimit ka vendosur njoftimin e përfundimit të hetimeve dhe komunikimin e akuzës ndaj të pandehurve përkatës, konkretisht ndaj J. B. dhe N. B. për veprën penale “Kanosja”, e kryer në bashkëpunim, në dëm të shtetasit F. O., të parashikuar nga nenet 84 dhe 25 të Kodit Penal, ndaj A. B. për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit”, të parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal, si dhe për veprën penale “Kanosja”, e kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 84 dhe 25 të Kodit Penal.
118. Po në datën 18.12.2019, subjekti i rivlerësimit i është drejtuar gjykatës me kërkesë për shuarjen e masës së sigurimit “arrest në burg” dhe caktimin e masës së sigurimit “arrest në shtëpi” për shtetasit J.B., A.B. dhe N.B., me arsyetimin se, nga data 15.06.2019, kur ishte vendosur masa e sigurimit “arrest në burg”, kishin kaluar më shumë se gjashtë muaj.
119. Me vendimin nr. {***}, datë 20.12.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka rrëzuar këtë kërkesë si të pabazuar në ligj dhe në prova, duke arsyetuar, ndër të tjera, se: (i) prokuroria pretendonte se kishte ndryshuar cilësimi juridik i faktit penal dhe se më datë 13.12.2019, ishin formuluar akuzat përkatëse, të komunikuar më 18.12.2019, ndërkohë që vonesa justifikohet me një "pamundësi objektive"; (ii) gjatë gjithë kësaj periudhe, bëhet fjalë për të njëjtin fakt penal dhe vetë prokuroria kishte deklaruar se nuk kishte kërkuar zgjatjen e afateve të hetimit, ndërsa i akuzuari kryesor, M. B., vijonte të ishte në kërkim; dhe (iii) kërkesa e prokurorit ishte e pabazuar në ligj dhe në prova, pasi natyra e ngjarjes kërkonte sqarimin e plotë të rrethanave dhe lirimi i të akuzuarve, qoftë edhe nën masën “arrest në shtëpi”, mund të sillte rrezik për ngjarje të tjera penale, përfshirë veprime të mundshme vetëgjyqësie.

120. Referuar sa më sipër, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka zgjatur afatet hetimore në total me katër muaj. Pas vendimit për zgjatjen e afatit të hetimit të datës 12.09.2019, rezulton se ai ka kryer disa veprime hetimore për këqyrjen dhe marrjen e dokumentacionit që dispononte Spitali Rajonal Vlorë lidhur me trajtimin e shtetasit A. B., i cili rezultonte i plagosur me armë zjarri në ngjarje³⁴; për fillimin e veprimeve të përgjimit telefonik të numrit celular {***}, në përdorim të shtetasit M. B.³⁵, si dhe për pyetjen ose ripyetjen e personave të përfshirë në ngjarje ose shtetasve të tjerë që kishin dijeni lidhur me të³⁶.
121. Trupi gjykues vlerëson se këto veprime hetimore janë kryer me vonesë ose kanë përbërë përsëritje të veprimeve të mëparshme, për shkaqe që nuk janë argumentuar në mënyrë bindëse nga subjekti i rivlerësimit, as në aktet e procedimit penal dhe as gjatë hetimit administrativ në Komision. Ndonëse subjekti ka pranuar tejkalimin e afateve hetimore, ai nuk ka shpjeguar kushtet e pamundësisë objektive që e kanë penguar për përfundimin e hetimeve brenda afateve të arsyeshme.
122. Për rrjedhojë, trupi gjykues konstaton se ka pasur një zgjatje të pajustificuar të hetimeve, si pasojë e kryerjes së veprimeve hetimore në distanca të konsiderueshme kohore nga njëra-tjetra, pa u shoqëruar me një veprimtari hetimore efektive dhe të përshtatshme për provueshmërinë e veprës penale.
123. Përkundër pretendimeve të Komisionerit Publik dhe pavarësisht arsytimit të vendimit nr. {***}, datë 20.12.2019, subjekti i rivlerësimit parashtroi se veprimtaria e tij hetimore i ishte nënshtruar kontrollit të gjyqtarit të seancës paraprake, i cili, me vendimin nr. {***}, datë 25.02.2020, ka konkluduar se në rastin konkret, nuk konstatoheshin akte procedurale absolutisht të pavlefshme.
124. Po ashtu, sipas këtij vendimi, akuzat e ngritura ndaj të pandehurit M. (B.) P. për veprat penale të parashikuara nga nenet 85 dhe 278/1 të Kodit Penal, si dhe akuzat e ngritura ndaj secilit prej të pandehurve të tjerë, rezultonin, nga pikëpamja e hetimeve të kryera dhe e cilësimit juridik të veprave penale, të plota, të sakta dhe në përputhje me ligjin.
125. Në lidhje me këtë pretendim, trupi gjykues vëren dhe vlerëson se Komisioneri Publik, problematikat e konstatuara në këtë procedim penal, i ka lidhur me efikasitetin e veprimeve hetimore dhe procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit deri në momentin e ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale dhe paraqitjes së kërkesës për shuarjen e masës së sigurimit. Këto problematika evidentohen edhe në arsyetimin e vendimit nr. {***}, datë 20.12.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit nuk kishte administruar

³⁴ Ngjarja ka ndodhur më datë 11.06.2019, ndërsa procesverbali i këqyrjes dhe marrjes së provës mban datën 17.12.2019.

³⁵ Në fashikullin e procedimit penal gjendet shkresa e datës 31.10.2019 “Kërkesë për vënien në përgjim të telekomunikacioneve”, nga Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë, e cila ka kërkuar që në lidhje me lokalizimin si dhe për të bërë të mundur ekzekutimin e urdhrit të prokurorit për ekzekutimin e vendimit penal në ngarkim të shtetasit M. B. sugjerohet lejimi i përgjimit të bisedave telefonike të numrit celular {***}.

³⁶ Referuar akteve në fashikullin penal rezulton se shtetasi F. O. është ripyetur më datë, 05.11.2019 dhe më datë 13.12.2019. Po ashtu janë ripyetur shtetasit A. O., M. R. dhe L. H..

asnjë të dhënë thelbësore të dalë nga veprimtaria hetimore, e cila të justifikonte ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale.

126. Referuar arsytimit të kërkesës për shuarjen e masës së sigurimit “arrest në burg”, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka mbështetur nevojën për shuarjen e kësaj mase në dy rrethana: së pari, në faktin se më datë 13.12.2019, kishte ndryshuar cilësimi juridik i akuzave dhe, së dyti, në faktin se, prej datës 18.12.2019, shtetasit N. B., A. B. dhe J. B. nuk mund të vijonin të qëndronin në paraburgim, pasi kohëzgjatja maksimale e paraburgimit për veprat penale për të cilat ata akuzoheshin, nuk mund të tejkalonte gjashtë muaj. Megjithatë, subjekti i rivlerësimit nuk ka argumentuar arsyet që kishin sjellë zgjatjen e hetimeve përtej këtyre afateve.
127. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se tejkalimi i afatit gjashtëmuajor të paraburgimit dhe vonesa në dërgimin e çështjes për gjykim, kanë ardhur si pasojë e kryerjes me vonesë dhe jo duke ndjekur logjikshëm hetimin, të disa veprimeve hetimore, të cilat artificialisht kanë çuar në zgjatjen e afatit të hetimeve e, për pasojë, edhe në konsumimin e afateve të paraburgimit për veprat penale të cilësuar rishtas prej subjektit. Po kështu, subjekti i rivlerësimit nuk ka arsyetuar pamundësinë për të përfunduar në kohë hetimet ndaj tre shtetasve, emrat e të cilëve ishin regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprave penale në kuadër të këtij procedimi penal.
128. Në përfundim, trupi gjykues çmon se shkeljet e konstatuara në këtë procedim penal, evidentojnë mangësi që bien ndesh me nënindikatorët e parashikuar në nenin 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.
129. Në lidhje me pretendimin e Komisionerit Publik dhe të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, se mangësitë e evidentuara në kuadër të këtij procedimi penal, të vlerësuara së bashku me informacionet e përcjella nga agjencitë ligjzbatuese, marrin një peshë të veçantë dhe duhet të mbahen në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes, trupi gjykues vëren si vijon.
130. Nga vendimi objekt shqyrtimi, rezulton se, në kuadër të vlerësimit të figurës, Komisioni ka ndërmarrë disa hapa hetimorë, duke referuar, ndër të tjera, verifikimin e informacioneve konfidenciale pranë organeve ligjzbatuese, si dhe administrimin e dosjeve penale për çdo informacion që kishte lidhje ose në të cilin përmendej emri i subjektit të rivlerësimit, të trajtuara sipas paragrafëve 89 e vijues të vendimit objekt shqyrtimi.
131. Komisioni, duke marrë shkas nga informacionet e përcjella nga organet ligjzbatuese, ka përfshirë në objektin e hetimit administrativ disa procedime penale të hetuara nga subjekti i rivlerësimit. Lidhur me këto procedime, subjekti i rivlerësimit është njohur me gjetjet përkatëse, ka paraqitur prapësimet e tij dhe ka depozituar prova në mbështetje të tyre.
132. Gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit pretendoi se kontrolli i figurës së një magjistrati duhet të bazohet në fakte konkrete dhe prova të besueshme, në respektim të parimeve të një procesi të drejtë, të barabartë dhe të paanshëm. Sipas tij, mosnjohja me informacionin e agjencive ligjzbatuese, të cilit i është referuar Komisioneri Publik në ankim, cenon të drejtën e tij për një mbrojtje efektive, pasi, në mungesë të aksesit në këtë informacion, ai vendoset në kushte pabarazie në ushtrimin e së drejtës së mbrojtjes ndaj pretendimeve të ngritura kundër tij.

133. Në vlerësim të sa më sipër, si dhe duke marrë në konsideratë dijeninë e subjektit të rivlerësimit për dyshimet e ngritura lidhur me veprimtarinë e tij procedurale dhe zgjerimin e hetimit administrativ mbi bazën e informacionit të përcjellë nga agjencitë ligjzbatuese, trupi gjykues vlerëson se mosnjohja e subjektit të rivlerësimit me informacionin e klasifikuar, nuk cenon parimin e kontradiktoritetit.
134. Neni 45 i ligjit nr. 84/2016 parashikon se organet e rivlerësimit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Për këtë qëllim, neni 50 i këtij ligji u njeh atyre mundësi të gjera aksesit në informacion, pa kufizimet që zbatohen në procedura të tjera. Njohja me dokumentacionin e klasifikuar, i cili nuk mund të përdoret në aktet publike, u shërben organeve të rivlerësimit për thellimin e hetimit dhe krijimin e bindjes së tyre të brendshme lidhur me rrethanat faktike të çështjes objekt shqyrtimi.
135. Në këtë drejtim, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka vlerësuar se: “[...] gjykatat ushtronin siç duhet kompetencat e kontrollit në dispozicion të tyre në këtë proces, si në lidhje me nevojën për të ruajtur konfidencialitetin e dokumenteve të klasifikuara, ashtu edhe në lidhje me arsyetimin e vendimeve të tyre, duke dhënë arsye për qëndrimin e mbajtur në raport me rrethanat specifike të çështjes [...]. Duke pasur parasysh gjykimin në tërësi, natyrën e mosmarrëveshjes dhe marzhin e vlerësimit që gëzojnë autoritetet e brendshme, kufizimet e vendosura mbi ushtrimin e të drejtave të kërkuesit u kompensuan në mënyrë të tillë që ekuilibri i drejtë ndërmjet palëve të mos cenohet në atë masë sa të prekej vetë thelbi i së drejtës së tij për një gjykim të drejtë [...]”³⁷.
136. Në këto kushte, mbi bazën e të dhënave të administruara dhe nivelit të aksesit që ligji u njeh organeve të rivlerësimit mbi informacionin e klasifikuar, Kolegji analizoi dhe vlerësoi këto të dhëna në përputhje me parimet e ligjshmërisë dhe objektivitetit, duke çmuar se të drejtat e subjektit të rivlerësimit që prekin thelbin e një procesi të rregullt ligjor, nuk janë cenuar në këtë proces³⁸.
137. Në vijim të këtij arsyetimi, trupi gjykues e gjen të pabazuar edhe pretendimin e subjektit të rivlerësimit se, në rastin konkret, duhet të mbahet në konsideratë jurisprudenca e Kolegjit, sipas së cilës gjykimi apo vlerësimi mbi zgjidhjen e një çështjeje, për sa kohë lidhet me vlerësimin e provave dhe mbështetet në bindjen e brendshme të magjistratit, del jashtë kompetencës së organeve të rivlerësimit³⁹.
138. Referuar ankimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues konstaton se Komisioneri Publik nuk e ka bazuar pretendimin e tij në mënyrën e zgjidhjes së çështjes nga subjekti i rivlerësimit, por në analizën e veprimtarisë së tij hetimore dhe procedurale në kuadër të procedimit penal nr. 964/2019. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se ndodhet në kushtet e parashikuara nga neni 73, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, vlerësohet i pabazuar.

³⁷ *Shih vendimin e GjEDNj-së, çështja Regner kundër Republikës Çeke, paragrafët 154, 161.*

³⁸ *Trajtuar më sipër në këtë vendim.*

³⁹ *Subjekti i rivlerësimit referon vendimin nr. 33/2021 dhe nr. 28/2020 të Kolegjit.*

139. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit, të parashtruar gjatë gjykimit në Kolegj, se veprimet hetimore të kryera prej tij nuk kanë sjellë asnjë efekt negativ në vijimin dhe zgjidhjen e çështjes, trupi gjykues vlerëson se edhe ky pretendim është i pabazuar.
140. Nga analiza e akteve, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka ndryshuar cilësimin juridik të akuzave mbi bazën e një veprimtarie hetimore, e cila, sipas vlerësimit të trupit gjykues, ka qenë joefektive, jo e plotë dhe jo e gjithanshme në raport me veprat penale për të cilat procedimi penal ishte regjistruar fillimisht. Moskryerja me efikasitet të veprimtarisë hetimore, ka shkaktuar konsumimin pa diligjencë të afateve të paraburgimit pasi, në rast se subjekti do të kishte kryer veprimtarinë hetimore në kohën e duhur dhe brenda afatit të hetimit, të pandehurit do të vijonin të gjendeshin në masat e sigurisë të vendosura ndaj tyre deri në kohën që çështja të dërgohej për gjykim dhe të nisnin afatet e paraburgimit që i takojnë fazës së gjykimit të çështjes. Nëse veprimtaria hetimore do të kryhej në përputhje me ligjin, do të ishte shmangur shuarja e masave të sigurisë dhe do të ishin garantuar nevojat e sigurimit, të cilat janë vlerësuar se ekzistonin ende, edhe sipas vendimit të gjykatës që rrëzoi kërkesën e subjektit për shuarjen e tyre. Si pasojë, kjo situatë është pasuar edhe nga kërkesa për shuarjen e masës së sigurimit ndaj tre personave të arrestuar.
141. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se pretendimi i subjektit të rivlerësimit, sipas të cilit veprimet e tij procedurale nuk kanë sjellë pasojë në ecurinë e çështjes, nuk mbështetet në rrethanat faktike dhe procedurale të konstatuara gjatë shqyrtimit të saj.
142. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka ndërmarrë veprime hetimore logjike dhe efektive për mbledhjen e të gjitha provave të nevojshme, si dhe ka proceduar me ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale nga një vepër me shkallë të lartë rëndësie shoqërore në vepra penale më të lehta, ndonëse nuk kishte sqaruar në mënyrë të plotë dhe të gjithanshme situatën faktike të ngjarjes, në të cilën humbi jetën një shtetas dhe u plagosën me armë zjarri disa të tjerë. Nga aktet e fashikullit penal, rezulton se nga ngjarja e ndodhur ka pasur dëmtime të shëndetit për disa shtetas, rrethana për të cilat nuk rezultojnë të jenë ngritur akuza për vepra penale në fushën e dëmtimit të shëndetit për asnjë prej të pandehurve, duke lënë pa evidentuar dhe vënë para përgjegjësisë penale autorët e këtyre veprave. Kjo situatë bie ndesh me përcaktimet e nenit 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.
143. Problematikat e konstatuara më sipër, u vlerësuan nga trupi gjykues në ndërlidhje edhe me informacionin e klasifikuar të përcjellë nga agjencitë ligjzbatuese, nga i cili përftohen perceptime të rëndësishme lidhur me integritetin e subjektit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 75, pika 3 e ligjit nr. 96/2016.
144. Lidhur me procedimin penal nr. {***}/2018 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë⁴⁰, në lidhje me të cilin ankuesi ka pretenduar se janë evidentuar mangësi në veprimtarinë hetimore të subjektit të rivlerësimit për identifikimin e subjekteve përgjegjëse të ngjarjes së

⁴⁰ Në lidhje me këtë çështje, ka pasur një informacion të marrë nga mediat on line me titull “Vdiq se i ra vetrata e xhamit në kokë. Prokurori prej dy vitesh zvarrit hetimin, kërcënon familjarët”.

ndodhur më datë 17.03.2018, ku shtetasi R.K. ka gjetur vdekjen si pasojë e rënies së një vetrate duralumini nga një pallat në qytetin e Vlorës, trupi gjykues vëren dhe vlerëson si vijon.

145. Komisioni, në vendimin e tij, ka vlerësuar se, në kuadër të shqyrtimit të procedimit penal nr. {***}/2018, nuk evidentohen elemente që cenojnë aftësitë profesionale apo besimin e publikut te sistemi i drejtësisë në lidhje me veprimtarinë e subjektit të rivlerësimit.
146. Komisioneri Publik, nëpërmjet ankimit të tij, ka mbajtur një qëndrim të ndryshëm nga ai i Komisionit në lidhje me këtë procedim. Sipas tij, nga dy vendimet gjyqësore të administruara nga Komisioni në kuadër të këtij procedimi penal, rezultojnë mangësi në veprimtarinë hetimore të subjektit të rivlerësimit për identifikimin e subjekteve përgjegjëse të ngjarjes, si dhe mangësi në cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik të prokurorit, të verifikueshme në arsyetimin e këtyre vendimeve.
147. Sipas Komisionerit Publik, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 07.10.2020, ka arsyetuar gjerësisht mbi nevojën e kryerjes së veprimeve hetimore shtesë nga organi i akuzës, të cilat duhet të merren në konsideratë në drejtim të nënindikatoreve të përcaktuar në nenin 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, lidhur me aftësinë e përgjithshme të prokurorit për të ndërmarrë në mënyrë logjike dhe efektive hetimin.
148. Po kështu, e njëjta gjykatë, me vendimin nr. {***}, datë 26.01.2021, ka konstatuar mangësi hetimore, duke arsyetuar, ndër të tjera, se organi i akuzës nuk kishte marrë në shqyrtim mundësinë e përgjegjësisë penale të projektuesit dhe nuk kishte hetuar mbi pretendimet e të pandehurave se subjekti ndërtues u kishte vënë në dispozicion një projekt me ndryshime. Sipas Komisionerit Publik, këto elemente ndikojnë në vlerësimin e nënindikatorit të parashikuar nga neni 73, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, që lidhet me cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik të prokurorit.
149. Komisioneri Publik ka vlerësuar gjithashtu se gjetjet e konstatuara në lidhje me këtë procedim penal, të çmuara në ndërlidhje edhe me informacionet, ndonëse të pakonfirmuara, të përcjella nga agjencitë ligjzbatuese, duhet të vlerësohen në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit 61, pika 5 e po këtij ligji, pasi prej tyre përftohen perceptime të rëndësishme mbi integritetin e subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit 75, pika 3 e ligjit nr. 96/2016.
150. Në kundërshtim të këtij shkakut ankimi, subjekti i rivlerësimit pretendoi para Kolegjit se ishte njohur me materialin e vënë në dispozicion nga Komisioni në kuadër të procesit të rivlerësimit, por nuk kishte pasur asnjëherë akses në informacionet e përcjella nga agjencitë ligjzbatuese. Sipas tij, mungesa e njohjes me këtë informacion, e vendos atë në kushte pabarazie në raport me pretendimet e Komisionerit Publik dhe cenon të drejtën për një mbrojtje efektive, pasi argumentet mbi këto pretendime nuk mund të shtjellohen përtej kundërshtimeve të natyrës parimore. Subjekti pretendoi se Komisioni ka vepruar drejt kur ka vlerësuar se nuk është i detyruar të konsiderojë si prova të vlefshme informacionet e paplota apo të pambështetura me prova nga agjencitë ligjzbatuese. Në këtë drejtim, ai argumentoi se edhe e drejta e informimit, e parashikuar në legjislacionin përkatës, mund t'u nënshtrohet kufizimeve në respektim të parimit të proporcionalitetit, nëse dhënia e informacionit do të shkaktonte një dëm të qartë dhe

të rëndë për administrimin e procesit të rivlerësimit. Megjithatë, sipas subjektit të rivlerësimit, kufizimi i aksesit në informacionin e përdorur nga Komisioneri Publik në ankimin ndaj vendimit të konfirmimit të tij në detyrë, e vendos atë në pozita të pabarabarta dhe cenon të drejtën e tij për një mbrojtje efektive, duke prekur parimin e barazisë së armëve dhe procesin e rregullt ligjor në tërësi⁴¹.

151. Sa i takon veprimtarisë hetimore në kuadër të këtij procedimi penal, subjekti i rivlerësimit mbajti të njëjtin qëndrim si gjatë hetimit administrativ në Komision, duke pretenduar se mangësitë e supozuara në veprimet hetimore dhe ndikimi i tyre në integritetin e tij nuk mbështeten në prova të qarta dhe arsyetime të plota, por në supozime. Sipas tij, fakti që dy vendime gjyqësore kanë evidentuar nevojën për kryerjen e veprimeve hetimore shtesë dhe kanë konstatuar mangësi në hetime, nuk mund të përdoret automatikisht për një vlerësim negativ të subjektit të rivlerësimit në aspektin profesional dhe, më tej, të integritetit të tij. Në vlerësimin e subjektit, këto vendime përbëjnë të dhëna që mund të orientojnë organin e akuzës drejt përmirësimit të veprimtarisë hetimore dhe, në një farë mënyre, dëshmojnë funksionimin e mekanizmave të kontrollit gjyqësor, por nuk mund të përdoren në mënyrë spekulative për të nxjerrë përfundime mbi përgjegjësinë profesionale apo integritetin e tij.
152. Në mungesë të vendimeve përfundimtare që përcaktojnë përgjegjësi konkrete, subjekti i rivlerësimit pretendoi se përdorimi i këtyre mangësive si shkak për cenimin e integritetit të tij, bie ndesh me parimin e prezumimit të pafajësisë dhe me nevojën për prova konkrete, ndaj pretendimet e Komisionerit Publik nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe nuk respektojnë parimet e një gjykimi të drejtë dhe objektiv.
153. Në vlerësim të sa më sipër, trupi gjykues, pasi u njoh me aktet e fashikullit penal të administruar nga Komisioni dhe pretendimet e palëve në lidhje me këtë procedim penal, vëren dhe vlerëson si vijon.
154. Më datë 29.03.2018, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal nr. {***} për veprën penale “Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë”, parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal.
155. Veprimtaria hetimore e kryer prej tij pas regjistrimit të procedimit penal ka konsistuar fillimisht në kryerjen e ekspertimit teknik të ndërtimit nga ekspertët L.B. dhe Y.M. Afati për përfundimin e këtij ekspertimi është zgjatur katër herë, secila me nga 30 ditë, me arsyetimin se ekspertimi nuk ishte përfunduar dhe se, në zbatim të nenit 185, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale, kërkimet dhe vlerësimet paraqiteshin komplekse. Rezulton se akti i ekspertimit teknik është administruar më datë 04.12.2019, ndërsa ekspertimi mjekoligjor mbi vdekjen e shtetasit R.K., i datës 17.03.2018, është administruar më datë 21.11.2019.
156. Në vijim, më datë 17.01.2020, pra rreth 22 muaj pas fillimit të hetimeve, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale dhe regjistrimin e shtetasit A.H.,

⁴¹ Ky pretendim është një argument që përsëritet nga subjekti i rivlerësimit për secilën prej çështjeve penale të trajtuara nga Komisioni në kuadër të informacionit të marrë nga agjencitë ligjzbatuese. Për pasojë, trupi gjykues çmon të mbajë të njëjtin qëndrim sikurse në vlerësimin e çështjes nr. {***}/2019 në lidhje me këtë pretendim.

punëtori që kishte kryer montimin e vetratës, si person i dyshuar për veprën penale “Vrasja nga pakujdesia”, parashikuar nga neni 85 i Kodit Penal, në dëm të shtetasit R.K. Po në të njëjtën datë, ai ka urdhëruar regjistrimin e shtetasve R.S., E.M. dhe N.J. si persona të dyshuar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

157. Më datë 16.04.2020, subjekti i rivlerësimit ka vendosur zgjatjen e afatit të hetimit me tre muaj, me arsyetimin se parashtrimet e shtetasit A. H. lidheshin me vendin e ngjarjes; se këqyrja ishte kryer më datë 19.02.2020; se ishte e nevojshme marrja e të dhënave tekniko-shkencore për përcaktimin e shkakut të rënies së vetratës dhe ardhjes së pasojës; se ishin kërkuar të dhëna teknike pranë IGJUM-it mbi kushtet klimatike të datës 17.03.2018, pa u kthyer ende përgjigje; si dhe se u ishin drejtuar pyetje shtesë ekspertëve, për të cilat nuk ishin marrë ende përgjigje për shkak të situatës së krijuar nga pandemia.
158. Më datë 22.05.2020, subjekti i rivlerësimit ka vendosur marrjen si të pandehur dhe njoftimin e akuzës ndaj shtetasve R.S., E.V. dhe N.J. për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Më datë 13.07.2020, ai i është drejtuar gjykatës me kërkesë për pushimin e çështjes ndaj shtetasit A. H. për veprën penale “Vrasja nga pakujdesia”, parashikuar nga neni 85 i Kodit Penal. Ndërsa, më datë 16.07.2020, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar dërgimin e çështjes për gjykim ndaj shtetasve R.S., E.V. dhe N.J., të akuzuar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.
159. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 07.10.2020, ka vendosur kthimin e akteve të procedimit penal nr. {***}/2018 për plotësimin e hetimeve, sipas orientimeve të dhëna në pjesën arsyetuese të vendimit. Në arsyetimin e saj, gjykata ka argumentuar, ndër të tjera, se: *[...] përfundimi i hetimeve dhe paraqitja e kërkesës për gjykim kërkojnë përmbushjen nga ana e prokurorit të disa veprimeve konkrete, pa të cilat kërkesa për gjykim është e pavlefshme [...].*
160. Gjykata ka evidentuar se, gjatë seancës paraprake, të pandehurat kishin pretenduar se nuk u ishte vënë në dispozicion projekti i miratuar nga KRRT Vlorë, por një projekt tjetër, i cili parashikonte ndryshime në lidhje me ndarjen e ambienteve në katin e parë të objektit, ku ishte montuar vetrata që kishte rënë. Sipas gjykatës, ky pretendim duhej të hetohej nëpërmjet plotësimit të hetimeve.
161. Po ashtu, gjykata ka çmuar se organi i akuzës duhej të verifikonte dhe të arrinte në një përfundim edhe lidhur me mundësinë e përgjegjësisë penale të inxhinierit projektues për mangësitë e konstatuara në projekt.
162. Në lidhje me kërkesën e prokurorit për pushimin e çështjes penale ndaj shtetasit A. H. për veprën penale “Vrasja nga pakujdesia”, gjykata ka arsyetuar se akuza ndaj tij nuk mund të pushohej në atë fazë procedurale, pasi vetëm pas plotësimit të hetimeve nga organi i ndjekjes penale do të mund të nxirreshin konkluzione të plota lidhur me përgjegjësinë e tij penale si personi që kishte kryer montimin e vetratës [...].

163. Në përfundim të afatit të caktuar nga gjykata për plotësimin e hetimeve, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar dërgimin për gjykim të procedimit penal në ngarkim të të pandehurave R.S., E.V. dhe N.J., si dhe pushimin e çështjes penale në ngarkim të shtetasit A.H.
164. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 26.01.2021, ka vendosur dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. {***}/2018, në ngarkim të të pandehurave R.S., E.V. dhe N.J., si dhe pushimin e çështjes penale ndaj shtetasit A.H.
165. Në arsyetimin e këtij vendimi, gjykata ka konstatuar, ndër të tjera, se: [...] *në lidhje me veprimet apo mosveprimet e projektuesit, prokurori është mjaftuar me pranimin e faktit se në projektin e miratuar nuk ka ekzistuar një projekt i posaçëm për montimin e vetratës, pa marrë në shqyrtim mundësinë e përgjegjësisë penale të projektuesit. Po kështu, organi i akuzës nuk ka hetuar mbi pretendimet e të pandehurave se subjekti ndërtues u kishte vënë në dispozicion një projekt me ndryshime. Gjykata vlerëson se nuk ka autoritetin dhe diskrecionin për të vlerësuar rrethana të tilla dhe për të ngritur akuza apo për t'i imponuar prokurorit ngritjen e akuzave ndaj personave që ai nuk i ka përfshirë në procedimin penal [...].*
166. Nga ky arsyetim rezulton se, edhe pas kthimit të akteve për plotësimin e hetimeve, gjykata ka evidentuar përsëri mangësi në veprimtarinë hetimore të subjektit të rivlerësimit, të lidhura me moshetimin e plotë dhe të gjithanshëm të rrethanave të çështjes.
167. Në vlerësim të sa më sipër, trupi gjykues, lidhur me këtë çështje, arrin në të njëjtin përfundim me atë të parashtruar nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme në bisedimet përfundimtare të datës 30.07.2025. Nga sa është trajtuar gjerësisht në ankim dhe në parashtrimet gjatë gjykimit në Kolegj, rezultoi e provuar se në të dyja vendimet gjyqësore të administruara janë evidentuar mangësi në veprimtarinë hetimore për identifikimin dhe hetimin e plotë të personave përgjegjës për ngjarjen.
168. Në këto kushte, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se, përderisa gjykata ka pranuar përfundimisht kërkesat e tij, ka pranuar edhe logjikën e ndjekur prej tij në hetim, nuk qëndron. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 07.10.2020, ka arsyetuar në mënyrë të detajuar nevojën për kryerjen e veprimeve hetimore shtesë nga organi i akuzës, duke orientuar dhe urdhëruar plotësimin e hetimeve⁴². Po kështu, edhe me vendimin nr. {***}, datë

⁴² Referuar arsyetimit në vendimin nr. {***}, datë 07.10.2020, gjyqtari i seancës paraprake, bazuar në parashikimet e Kodit të Procedurës Penale, të ndryshuar sipas ligjit nr. 35/2017, ka vlerësuar se nuk plotësohen kriteret e parashikuara në nenin 332/dh/1/a të Kodit të Procedurës Penale, pasi nuk ka prova të mjaftueshme në mbështetje të akuzës së ngritur nga prokurori ndaj tre të pandehurave, të cilat pretenduan se atyre nuk iu është vënë në dispozicion projekti i miratuar i KRT-së Bashkia Vlorë, por një projekt tjetër, pretendim i cili duhet të hetohet nga prokurori. Po ashtu, gjyqtari i seancës paraprake ka çmuar ndër të tjera se, me veprimet hetimore, prokurori duhet të synojë marrjen e projektit pranë ASHK Vlorë, verifikimin e rrethanave të depozitimit të këtij projekti, kushtet dhe kriteret e miratimit të tij nga organi kompetent shtetëror dhe, nëse këto veprime janë në përputhje me ligjin, ai duhet të analizojë projektin teknik, i cili ka qenë detyrim i projektuesit, gjithashtu të analizojë se cila ka qenë përgjegjësia e mbikëqyrësit, kolaudatorit të punimeve dhe montuesit të vetratave në katin e parë, si dhe të verifikohet edhe mbi mundësinë e përgjegjësisë së inxhinierit projektues mbi mangësitë e projektit. Në lidhje me pushimin e çështjes penale në ngarkim të të dyshuarit A. H. për veprën penale “Vrasje nga pakujdesia”, gjyqtari i seancës paraprake ka vlerësuar se, në kushtet kur hetimet nuk janë të plota dhe kanë nevojë për plotësime, akuza në ngarkim të të dyshuarit A.H. nuk mund të pushohet dhe se vetëm pas përfundimit të hetimeve, me plotësimin e tyre nga organi i

26.01.2021, e njëjta gjykatë ka konstatuar sërish mangësi në hetim, duke evidentuar se disa prej çështjeve të ngritura më parë nuk ishin adresuar në mënyrë të plotë.

169. Për rrjedhojë, nga analiza e fakteve të rezultuara nga vendimet nr. {***}, datë 07.10.2020 dhe nr. {***}, datë 26.01.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në veprimtarinë hetimore, në funksion të zbardhjes së plotë dhe të gjithanshme të çështjes, duke mos ndërmarrë në kohë dhe në mënyrë efektive veprimet hetimore të orientuara nga gjykata. Këto elemente duhet të merren në konsideratë në kuadër të vlerësimit sipas nënindikatorëve të përcaktuar në nenin 73 të ligjit nr. 96/2016, që lidhen me aftësinë e përgjithshme të prokurorit për të ndërmarrë logjikisht hetimin, në përputhje me kërkesat ligjore dhe për të mbledhur provat e nevojshme për zbardhjen e çështjes.
170. Në kuadër të analizës së mësipërme, trupi gjykues mban në konsideratë edhe faktin se nga data 29.03.2018, kur është regjistruar procedimi penal, deri më datë 13.07.2020, kur subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kërkesën për dërgimin e çështjes për gjykim, kanë kaluar rreth dy vjet e tre muaj. Gjatë kësaj periudhe, subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë ndërmarrë në kohë dhe në mënyrë efektive të gjitha veprimet hetimore të nevojshme për zbardhjen e plotë dhe të gjithanshme të rrethanave të çështjes dhe evidentimin e përgjegjësive përkatëse penale lidhur me ngjarjen e datës 17.03.2018 dhe as nuk ka adresuar hetimin sipas orientimeve të dhëna nga gjykata në funksion të evidentimit të përgjegjësisë penale dhe personave përgjegjës. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se veprimtaria e tij hetimore ka shfaqur mangësi që bien ndesh me nënindikatorët e parashikuar nga neni 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.
171. Këto problematika, të vlerësuara në ndërthurje edhe me informacionin e klasifikuar të administruar nga agjencitë ligjzbatuese, përbëjnë elemente nga të cilat përftohen perceptime të rëndësishme mbi integritetin e subjektit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 75, pika 3 e ligjit nr. 96/2016.
172. *Lidhur me procedimin penal nr. {***}, datë 22.06.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë*, për të cilin ankuesi pretendoi se nga vendimet gjyqësore të administruara gjatë gjykimit në Kolegj, dhe konkretisht nga vendimi i datës 05.07.2023 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, janë evidentuar mangësi në veprimtarinë hetimore, si në drejtim të provueshmërisë së faktit penal, ashtu edhe në drejtim të identifikimit dhe hetimit të të gjithë autorëve të mundshëm të përfshirë në ngjarje, trupi gjykues konstaton si vijon.
173. Sipas ankuesit, këto gjetje duhet të vlerësohen në kuadër të nënindikatorëve të përcaktuar në nenin 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, që lidhen me aftësinë e përgjithshme të prokurorit për të ndërmarrë logjikisht hetimin, në përputhje me kërkesat ligjore, për të mbledhur provat e nevojshme dhe për të siguruar një rezultat hetimor të mbështetur në një analizë të plotë dhe të gjithanshme të rrethanave të çështjes.

ndjekjes penale, do të mund të nxjerrë konkluzione lidhur me përgjegjësinë penale të të dyshuarit si personi që ka kryer veprimet e montimit të veprës.

174. Komisioni ka vlerësuar në vendim se: *duke qenë se çështja për shqyrtimin e kërkesave të subjektit është në proces shqyrtimi nga gjykata, ashtu si me të drejtë subjekti referon qëndrimin e mbajtur në një rast të ngjashëm nga Kolegji, Komisioni ndodhet në kushtet e pengesës ligjore për vlerësimin e subjektit, sipas parashikimit të nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për këtë arsye, Komisioni nuk ka kryer verifikime dhe as i ka kërkuar sqarime/barrë prove subjektit në lidhje me kërkesat e paraqitura gjykatës për shtetasin R. H.. Por, si gjatë hetimit administrativ, ashtu edhe në parashtrime, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumente shkresore për sa i është kërkuar nga Komisioni në lidhje me zëvendësimin e prokurores A. Dh. dhe procedurat e ndjekura në këtë rast. Nga ana e subjektit si drejtues i prokurorisë, janë argumentuar dhe justifikuar ligjërisht shkaqet e zëvendësimit të prokurores A. Dh., si dhe u vërtetua që zëvendësimi i kësaj prokuroreje me subjektin e rivlerësimit është kryer sipas procedurave ligjore nëpërmjet shortit. Referuar këtyre veprimeve të ndërmarra nga subjekti dhe rrethanave në të cilat është vlerësuar zëvendësimi i prokurores A. Dh., Komisioni nuk mund të çmojë që informacionet e marra nga organet ligjzbatuese kanë qenë të vërteta. Për më tepër, këto informacione kanë qenë në kuadër dyshimesh të pavërtetuara me ndonjë të dhënë a provë konkrete.*
175. Komisioneri Publik, në ankimin drejtuar Kolegjit, duke iu referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të ligjit nr. 84/2016, ka mbajtur një qëndrim të ndryshëm nga ai i Komisionit, i cili ka vlerësuar se ndodhet përpara pengesës ligjore për shqyrtimin e kësaj çështjeje sipas parashikimit të pikës 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës. Sipas Komisionerit Publik, kjo çështje duhet të përfshihet në rrethin e rrethanave objekt vlerësimi në procesin e rivlerësimit të subjektit, duke administruar, nëse është e nevojshme, edhe vendimin që do të merret nga gjykata për rastin konkret.
176. Komisioneri Publik ka kërkuar që rrethanat e evidentuara gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, të vlerësohen nga Kolegji në zbatim të nenit 4, pika 2, në funksion të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pasi, sipas tij, prej tyre përftohen perceptime të rëndësishme mbi integritetin e subjektit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 75, pika 3 e ligjit nr. 96/2016.
177. Subjekti i rivlerësimit pretendoi gjatë gjykimit në Kolegji, se kërkesa e Komisionerit Publik për të përfshirë në vlerësim një çështje ende në shqyrtim gjyqësor, pa një vendim përfundimtar, cenon parimin e sigurisë juridike dhe të drejtën për një proces të rregullt ligjor, duke e ekspozuar subjektin ndaj vlerësimeve hipotetike, në kundërshtim me parimin e prezumimit të pafajësisë dhe standardin e provës së mjaftueshme.
178. Sipas subjektit të rivlerësimit, ligji nuk parashikon që perceptime abstrakte, të dyshimta dhe të pambështetura plotësisht në prova, veçanërisht kur mbështeten në informacione të cilat vetë Komisioni i ka vlerësuar si të pavërtetuara, të shërbejnë si bazë për penalizimin e tij në drejtim të integritetit. Në vlerësimin e tij, një qasje e tillë bie ndesh me parimin e proporcionalitetit dhe me prezumimin e pastërtisë së figurës deri në provimin e së kundërtës.
179. Subjekti argumentoi gjithashtu se pretendimi i Komisionerit Publik, sipas të cilit procesi i rivlerësimit në kuadër të kontrollit të figurës duhet të përfshijë dhe të mbështetet në informacione të pakonfirmuara, të cilat nuk i janë vënë në dispozicion subjektit të rivlerësimit

dhe, për më tepër, lidhen me një çështje ende në shqyrtim në kohën e paraqitjes së ankimit, nuk përputhet me standardet kushtetuese dhe ligjore. Sipas tij, kjo qasje bie në kundërshtim me praktikën e Kolegjit dhe të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me të drejtën për një proces të rregullt ligjor dhe me parimin e proporcionalitetit në vlerësimin e figurës së një magjistrati.

180. Përfundimisht, subjekti i rivlerësimit pretendoi se konkluzionet e Komisionerit Publik, të mbështetura në informacione të pakonfirmuara, nuk kanë bazë ligjore dhe nuk respektojnë parimet e një procesi të drejtë dhe objektiv. Ai përsëriti se, për sa kohë nuk ka pasur akses në informacionin e administruar nga agjencitë ligjzbatuese, mbrojtja ndaj pretendimeve të Komisionerit Publik zhvillohet në kushte pabarazie dhe argumentet mbi këto pretendime nuk mund të shtjellohen përtej kundërshtimeve të natyrës parimore.
181. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit pretendoi se, në referim të nenit 34 të ligjit nr. 84/2016, kontrolli i figurës përfshin verifikimin e deklarimeve të subjektit dhe të dhënave të tjera me qëllim identifikimin e subjekteve që kanë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës. Sipas tij, ky kontroll duhet të kryhet mbi bazën e fakteve konkrete dhe provave të besueshme, duke respektuar parimet e një gjykimi të drejtë, të barabartë dhe të paanshëm.
182. Sa u takon veprimeve hetimore dhe procedurale të kryera prej tij, subjekti i rivlerësimit mbajti të njëjtin qëndrim si gjatë hetimit administrativ në Komision, duke theksuar se e kishte ushtruar detyrën me përgjegjësi dhe se kishte menaxhuar situatën procedurale sipas vlerësimit dhe bindjes së tij profesionale mbi mënyrën e ndjekjes penale.
183. Lidhur me procedimin penal nr. {***}, datë 22.06.2021, në ngarkim të shtetasit R. H., bazuar në kërkesën e Komisionerit Publik të parashtruar në ankim, të mbështetur më tej nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme dhe me dakordësinë e subjektit të rivlerësimit, Kolegji i Posaçëm i Apelit, në seancën e datës 23.07.2025, me vendim të ndërmjetëm, vendosi çeljen e hetimit gjyqësor dhe pranimin e kërkesës së palëve për administrimin e vendimeve gjyqësore të dhëna në kuadër të procedimit penal nr. {***}/2021.
184. Për këtë qëllim, nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 23.07.2025, me lëndë “Kërkesë për dokumentacion”, Kolegji i kërkoi Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë të vinte në dispozicion çdo vendim gjyqësor të dhënë në lidhje me procedimin penal nr. {***}/2021 të Prokurorisë pranë kësaj gjykate, në ngarkim të shtetasve R. H. dhe S. I.⁴³
185. Nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, si dhe nga ato të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegji, rezulton se procedimi penal në fjalë lidhet me ngjarjen e ndodhur më datë 20.06.2021, rreth orës 04:00, në afërsi të lokalit “{***}”⁴⁴, në

⁴³ Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 24.7.2025, “Kthim përgjigje tuajës me nr. {***} akti, datë 23.07.2025”, ka përcjellë kopje të njësuara të vendimeve gjyqësore të dhëna nga kjo gjykatë në fazën e hetimeve paraprake, seancës paraprake dhe gjykimit të çështjes në themel.

⁴⁴ https://%2A%2A%2A.com/lajm/20-plumba-drejt-pronarit-te-orange-ne-sarande-3-autoret-u-nxorren-jashte-lokalit-dhe-filluan-ta-qellojne-me-arme-***-doli-jashte-kur-degjoi-krismat

lagjen nr. {***} të qytetit të Sarandës, ku si pasojë e përdorimit të armës së zjarrit mbetën të plagosur dy shtetas.

186. Në lidhje me këtë ngjarje, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë regjistroi procedimin penal nr. {***}/2021 në ngarkim të të pandehurit R. H. për veprat penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, mbetur në tentativë dhe e kryer në bashkëpunim, si dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe municioneve”, të parashikuara nga nenet 79, shkronja “dh”, 22, 25 dhe 278/1 të Kodit Penal. Po kështu, procedimi penal u regjistrua edhe në ngarkim të të pandehurit S. I. për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe municioneve”, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal.
187. Në vijim të kryerjes së veprimeve procedurale përkatëse, organi i akuzës u komunikoi të pandehurve akuzat respektive.
188. Hetimet për procedimin penal nr. {***}/2021 janë drejtuar fillimisht nga prokurori E. H. dhe, më pas, për shkak të transferimit të tij në një detyrë tjetër, nga prokurorja A. Dh.. Në vijim, më datë 04.07.2022⁴⁵, me urdhër të subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e Drejtuesit të Prokurorisë, u vendos zëvendësimi i prokurores A. Dh. dhe hedhja e shortit për caktimin e prokurorit që do të vijonte hetimet e çështjes.
189. Nga shorti, rezultoi se procedimi iu caktua vetë subjektit të rivlerësimit. Ky i fundit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, pa kryer asnjë veprim hetimor shtesë dhe duke u mbështetur në analizën e akteve të administruara në dosjen penale, më datë 19.09.2022, i paraqiti gjykatës dy kërkesa: (i) kërkesën për dërgimin në gjyq të procedimit penal nr. {***}/2021 për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe municioneve”, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal, në ngarkim të të pandehurve R.H. dhe S.I.; si dhe (ii) kërkesën për pushimin e pjesshëm të akuzës ndaj të pandehurit R.H., për veprën penale “Vrasja me dashje”, mbetur në tentativë dhe e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 76, 22 dhe 25 të Kodit Penal.
190. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, pasi mori në shqyrtim në seancë paraprake çështjen penale nr. {***}, në lidhje me kërkesat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, me vendimin e datës 05.07.2023, vlerësoi se hetimet paraprake nuk ishin të plota

⁴⁵ Në datë 14.6.2022, rezultoi se shtetasi R. H. ka paraqitur pranë Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë, subjektit të rivlerësimit, kërkesë për përjashtimin e prokurores së çështjes A. Dh., duke pretenduar për anësi në vlerësimin e çështjes dhe ngritjes së akuzës. Prokurorja e çështjes A. Dh., me vendimin e datës 16.6.2022, e ka vlerësuar kërkesën të pabazuar, duke mos gjetur shkaqe ligjore për heqjen dorë nga çështja. Në datë 20.6.2022, shtetasi R. H. ka paraqitur sërish para Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë, subjektit të rivlerësimit, kërkesë për përjashtimin e prokurores së çështjes, duke parashtruar të njëjtat pretendime si në kërkesën e datës 14.6.2022. Kjo kërkesë është sigluar nga drejtuesi i prokurorisë/subjekti i rivlerësimit, drejtuar prokurores së çështjes me përmbajtjen: “znj. Dh./ Më informoni mbi ecurinë e proc...” Në vijim, prokurorja e çështjes, më datë 27.6.2022, i ka paraqitur drejtuesit të prokurorisë, subjektit të rivlerësimit, “Relacion mbi kërkesën për zëvendësim”, në të cilin vlerëson sërish se kërkesa e të pandehurit është e pabazuar, por në kushtet kur çështja paraqitet veçanërisht komplekse, e lë në vlerësimin e drejtuesit, nëse çmohet i nevojshëm zëvendësimi nga kjo çështje penale.

dhe se, nga analiza në tërësi e akteve të fashikullit të hetimit, rezultonte se organi i akuzës nuk kishte kryer të gjitha veprimet hetimore të nevojshme për grumbullimin e provave në funksion të provueshmërisë së faktit penal dhe të sqarimit të plotë të rrethanave të çështjes.

191. Në këtë kuadër, gjykata konstatoi, ndër të tjera, se:

(i) Pamjet filmike, mbi të cilat organi i akuzës kishte mbështetur pretendimet e tij lidhur me ekzistencën ose jo të fakteve penale, ishin këqyrur dhe sekuestruar vetëm pjesërisht në kuadër të veprimeve hetimore të ngutshme. Për këtë arsye, gjykata urdhëroi kryerjen e një ekspertimi teknik kompjuterik të të gjitha pamjeve filmike të administruara, nga një grup specialistësh të fushës së teknologjisë së informacionit, me qëllim verifikimin e autenticitetit të tyre, evidentimin e ndërhyrjeve të mundshme, vlerësimin e cilësisë teknike të pamjeve dhe identifikimin e mundshëm të personave të dyshuar në të gjitha regjistrimet filmike të marra si provë dhe jo vetëm në ato të hotelit “{***}”.

(ii) Nuk ishte hetuar nëse predhat dhe gëzhojat e gjetura në ambientet e lokalit “{***}” dhe në mjedinë në pronësi të të pandehurit S.I., në tërësinë e tyre, ishin qitur ose jo nga e njëjta armë, konkretisht nga arma që dyshohej se ishte përdorur nga i pandehuri R.H., ditën e ngjarjes. Për këtë arsye, gjykata urdhëroi kryerjen e ekspertimit përkatës nga ekspertë të specializuar.

(iii) Ishte e nevojshme kryerja e një ekspertimi kriminalistik për hartimin e një skice shoqëruar me shpjegimet përkatëse, me qëllim përcaktimin e vendndodhjes së të pandehurve, të mjeteve të përfshira dhe të gëzhojave të sekuestruara, si dhe ndërtimin e trajektorës së lëvizjes së të pandehurit R.H. në raport me të pandehurin S.I. dhe personat e tjerë të përfshirë në ngjarje.

(iv) Duhej të kryhej një ekspertim teknik nga ekspertë inxhinierë dhe kriminalistë për të përcaktuar këndet dhe drejtimet e qitjes që kishin shkaktuar dëmtimet në muret rrethuese të lokaleve “{***}” dhe “{***}”, si dhe për të verifikuar nëse predhat e mbetura në këto objekte mund t’i atribuoheshin ndonjë arme konkrete.

(v) Nisur nga deklaratimet kontradiktore të shtetasve S.I. dhe V.C., ishte e nevojshme kryerja e ballafaqimeve ndërmjet personave të pyetur më parë, si dhe marrja në pyetje e shtetasit E.L., në cilësinë e personit që kishte dijeni për veprën penale.

(vi) Në varësi të rezultateve të verifikimit të pamjeve filmike, duhej të identifikoheshin pronësia e mjeteve të përfshira në ngjarje dhe të pyeteshin pronarët e tyre për rrethana me interes për hetimin.

(vii) Duhej t’i bashkëlidhej fashikullit të procedimit penal edhe vendimi për ndarjen e procedimit penal nr. {***}/2021.

192. Në këto kushte, duke vlerësuar se organi i akuzës nuk kishte kryer të gjitha veprimet hetimore të nevojshme për zbardhjen e plotë të së vërtetës dhe sqarimin e rrethanave të çështjes, gjykata çmoi se çështja duhej t’i kthehej Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, me qëllim plotësimin dhe thellimin e hetimeve sipas orientimeve të përcaktuara në vendimin e saj.

193. Sipas gjykatës, vetëm pas kryerjes së këtyre veprimeve hetimore mund të arrihej në një përfundim të bazuar mbi ekzistencën ose jo të provave të mjaftueshme dhe të akteve të vlefshme e të përdorshme, në lidhje me faktin penal dhe përgjegjësinë e të pandehurve, të tilla që të përlligjnin kërkesën e prokurorit për dërgimin e çështjes në gjyq.

194. Sa i takon kërkesës për pushimin e pjesshëm të akuzës në ngarkim të të pandehurit R.H., gjykata vlerësoi se, për sa kohë ekzistonte nevoja për plotësimin e hetimeve, kërkesa e prokurorisë për pushimin e akuzës ndaj këtij të pandehuri për veprën penale të parashikuar nga neni 76, në lidhje me nenet 22 dhe 25 të Kodit Penal, ishte e papranueshme.
195. Sipas gjykatës, tentativa e vrasjes dhe armëmbajtja pa leje përbënin fakte të ndërlidhura, të cilat nuk mund të hetoheshin veçmas, për aq kohë sa provat e grumbulluara në funksion të provueshmërisë së njërit fakt ndërlidheshin ngushtësisht edhe me tjetrin. Gjykata çmoi gjithashtu se organi i akuzës duhej fillimisht të ezauronte të gjitha detyrat e lëna prej saj dhe se kërkesa për pushimin e akuzës nuk mund të pranohej, për sa kohë që në rastin konkret kishte vend për vijimin e hetimeve, jo vetëm në funksion të provueshmërisë së faktit penal, por edhe në drejtim të identifikimit të të gjithë autorëve të mundshëm të përfshirë në ngjarje, përfshirë edhe personat që nuk ishin identifikuar deri në atë moment nga prokuroria, me qëllim individualizimin e përgjegjësisë penale përkatëse.
196. Për sa më sipër, duke vlerësuar se hetimet paraprake nuk ishin të plota, gjykata vendosi kthimin e çështjes penale që lidhej me procedimin penal nr. {***}/2021, në ngarkim të të pandehurve S.I. dhe R.H., për plotësimin e hetimeve sipas drejtimeve të përcaktuara në pjesën arsyetuese të vendimit. Gjykata disponoi gjithashtu që veprimet procedurale për plotësimin e hetimeve paraprake të përfundonin brenda një afati prej katër muajsh.
197. Nga aktet e administruara, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit ta ketë kundërshtuar këtë vendim.
198. Në vijim të procedimit, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, me vendimin e datës 23.10.2023, pas shqyrtimit të kërkesës së Prokurorisë për pushimin e pjesshëm të akuzës në ngarkim të të pandehurit R.H., për veprën penale “Vrasja me dashje”, e mbetur në tentativë, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 76, 22 dhe 25 të Kodit Penal, si dhe kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq, vendosi pranimin e kërkesës së Prokurorisë dhe pushimin e kësaj akuze ndaj të pandehurit R.H.
199. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të procedimit penal nr. {***}/2021, subjekti i rivlerësimit kërkoi: (i) deklarin fajtor të të pandehurit R.H., për kryerjen e veprës penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278, pika 1 e Kodit Penal, dhe dënimin e tij me 6 vjet burgim, duke kërkuar që në caktimin e masës përfundimtare të dënimit të merrej në konsideratë aplikimi i nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale; si dhe (ii) deklarin fajtor të të pandehurit S.I. për të njëjtën vepër penale dhe dënimin e tij me 6 vjet burgim, me aplikimin gjithashtu të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale. Për këtë të fundit, subjekti kërkoi edhe zbatimin e nenit 59 të Kodit Penal, duke pretenduar se, për shkak të gjendjes shëndetësore së të pandehurit, pjesa e mbetur e dënimit të pezullohej dhe ai të vihej në provë për një periudhë sa dyfishi i masës përfundimtare të dënimit, me kusht që gjatë kësaj kohe të mos kryente vepër tjetër penale.
200. Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, me vendimin nr. {***}, datë 25.11.2024, të formës së prerë, ndër të tjera, vendosi: (i) deklarin fajtor të të pandehurit R.H., për kryerjen e veprës penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë

dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278, pika 1 e Kodit Penal, dhe dënimin e tij me 6 vjet burgim; në zbatim të nenit 406, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale, dënimi iu ul me një të tretën dhe, përfundimisht, ai u dënua me 4 vjet burgim; si dhe (ii) deklarin e pafajshëm të të pandehurit S.I., i akuzuar për të njëjtën veprë penale.

201. Nga analiza e akteve të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor në Komision, konkretisht e kërkesës së subjektit të rivlerësimit për dërgimin e çështjes në gjyq dhe e kërkesës për pushimin e pjesshëm të akuzës, rezultoi se, në ndryshim nga prokurorja e mëparshme e çështjes, e cila kishte ngritur ndaj shtetasit R.H. akuzat për veprat penale “Vrasja me dashje”, e mbetur në tentativë⁴⁶ dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, subjekti i rivlerësimit, pa kryer veprime hetimore shtesë, të afta për të ndryshuar provueshmërinë e fakteve të çështjes, paraqiti në gjykatë kërkesë për dërgimin në gjyq të procedimit penal nr. {***}/2021 vetëm për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, parashikuar nga neni 278, pika 1 e Kodit Penal, në ngarkim të shtetasve R.H. dhe S.I.
202. Njëkohësisht, subjekti i rivlerësimit kërkoi pushimin e pjesshëm të akuzës ndaj të pandehurit R.H., për veprën penale “Vrasja me dashje”, e mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 76, 22 dhe 25 të Kodit Penal.
203. Këtë kërkesë, subjekti i rivlerësimit e ka bazuar në argumentet: *Akti mbi njoftimin e akuzës dhe marrjes si të pandehur ndaj shtetasit R. H. rezultoi i paqartë dhe madje i paplotë për shkaqet si më poshtë: Së pari, nuk është identifikuar kush është viktima e veprës penale ndaj të cilit R. H. është akuzuar se ka tentuar të vrasë. Së dyti, nuk është identifikuar ose nuk është argumentuar se si është kryer vepra penale e vrasjes mbetur në tentativë, në formën e bashkëpunimit, është e qartë se për të pasur atë veprë duhet minimalisht pjesëmarrja e dy personave midis të cilëve të ekzistojë një marrëveshje qoftë edhe e çastit. Nga tërësia e veprimeve hetimore, nuk rezultoi në asnjë moment që shtetasi R. H. të ketë kryer ndonjë veprim konkret në bashkëpunim me ndonjë person tjetër për të arritur pasojën e kundërligjshme, e cila për më tepër nuk është identifikuar se cila është (përveç faktit të posedimit të armës dhe dy qitjeve me të). Së treti, nga aktet dhe veprimet hetimore në funksion të çështjes, nuk është administruar asnjë provë e vetme e cila do të mundësonte gjykimin e të pandehurit R. H. me akuzën e vrasjes në tentativë dhe në bashkëpunim. Provat e administruara në dosje tregojnë se ai shtetas ka poseduar një armë zjarri dhe madje edhe ka qëlluar (mbështetur në këqyrjen e dy gëzhgojave dhe mbetjeve kimike në duart e tij), mirëpo nuk është arritur të provohet se në ç’drejtim ka qëlluar ai dhe cili ka qenë objektivi/shënjestra. Nga pamjet filmike të administruara, rezultoi qartë se në momentet kur kanë filluar të shtënat [...] shtetasi R. H. është larguar me qëllim shmangien apo fshehjen nga rrezja e të shtënave. [...] është bërë e mundur që të përcaktohet vendndodhja e tij, e cila në raport me gëzhgojat e gjetura në vendin*

⁴⁶ Referuar vendimit të subjektit të rivlerësimit për zëvendësimin e prokurorit, të datës 20.06.2022, rezultoi se më datë 20.05.2022, prokurorja e çështjes ka disponuar me vendim për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, nga “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese” kundër dy ose më shumë personave, mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 79/dh, 22, 25 të Kodit Penal, në “Vrasje me dashje”, e mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 76, 22, 25 të Kodit Penal.

ku ai duket në pamje, passjell dhe konkluzionin logjik se ka qenë pikërisht ai që ka qëlluar me armën të cilën posedonte me vete. Deri në këtë moment, provohet tërësisht se ai ka konsumuar veprën penale “Mbajtje pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyesë dhe municioneve”, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal. [...] nuk rezulton asnjë provë, pamje filmike, të administruara në dosje që ai të ketë qëlluar drejt ndonjë personi me qëllim për ta vrarë. Nuk është administruar asnjë deklaram se ai shtetas ka qëlluar drejt ndonjë personi. Referuar dhe përmbajtur dhe nenit 4 të Kodit të Procedurës Penale, “presumimi i pafajësisë”, ku çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit, prokurori vlerëson se është e pamundur që t’i kërkohet gjykatës dërgimi i çështjes në gjyq në ngarkim të të pandehurit R. H. edhe për veprën penale “Vrasje me dashje”, mbetur në tentativë, e kryer në bashkëpunim, e cila për arsyet dhe argumentet si më sipër, është qartësisht e paprovuar. Përfundimisht, organi i akuzës vlerëson se dy të pandehurit R. H. dhe S. I. kanë konsumuar secili më vete veprën penale “Mbajtje pa leje e armëve [...]” dhe me këtë akuzë ata duhet të dërgohen për gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

204. Referuar arsyetimit dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit në aktin e mësipërm, trupi gjykues vlerëson se ai e ka përqendruar analizën e tij në vlerësimin e provave dhe të veprimeve hetimore të kryera deri në atë moment, për të arritur në përfundimin se mungonin prova të mjaftueshme për provimin e akuzës për veprën penale “Vrasja me dashje”, e mbetur në tentativë. Megjithatë, në ushtrimin e funksionit kushtetues të ndjekjes penale, prokurori nuk kufizohet vetëm në vlerësimin e provave ekzistuese, por ka gjithashtu detyrimin të ndërmarrë të gjitha veprimet hetimore të nevojshme për mbledhjen dhe administrimin e provave që shërbejnë si për mbështetjen e akuzës, ashtu edhe për verifikimin nëse ekzistojnë kushtet ligjore për pushimin e saj ose për dërgimin e çështjes në gjykatë.
205. Në rastin objekt shqyrtimi, ndonëse subjekti i rivlerësimit ka argumentuar në disa raste se për të mbështetur akuzën nevojiteshin prova të tjera, ai vetë ka pranuar, në përgjigjen e dhënë me e-mail-in e datës 25.11.2022, se pas marrjes në shqyrtim të procedimit penal nr. {***/2021, nuk ka kryer asnjë veprim hetimor shtesë në funksion të sqarimit të plotë të rrethanave të çështjes, përderisa rezulton i provuar fakti penal i plagosjes së dy shtetasve, brenda të njëjtit mekanizëm ngjarjeje. Në këto kushte, vlerësimi i tij për mungesën e provave nuk është paraprirë nga një veprimtari hetimor e orientuar drejt plotësimit të mangësive të evidentuara dhe verifikimit të plotë të faktit penal.
206. Subjekti i rivlerësimit pretendoi në konkluzionet përfundimtare se Kolegji kishte tejkaluar kufijtë e ankimit të Komisionerit Publik dhe, rrjedhimisht, objektin e shqyrtimit gjyqësor, duke argumentuar se kërkimi i drejtpërdrejtë i Komisionerit kishte qenë që procedimi penal nr. {***/2021 të përfshihej në rrethin e çështjeve objekt vlerësimi dhe të administrohej, eventualisht, vendimi që do të merrej nga gjykata në lidhje me këtë procedim.
207. Po ashtu, subjekti i rivlerësimit pretendoi se çdo vendimmarrje ose veprim procedural i kryer përpara datës 19.09.2022, datë në të cilën ai paraqiti dy kërkesat përkatëse në gjykatë, nuk mund t’i atribuohet atij për qëllime të procesit të rivlerësimit, pasi këto veprime dhe vendimmarrje ishin kryer nga prokurorë dhe gjyqtarë të tjerë që kishin trajtuar më parë çështjen penale objekt shqyrtimi.

208. Në lidhje me sa më sipër, trupi gjykues konstaton se Komisioneri Publik, në ankimin e tij, ka kërkuar që në kuadër të shqyrtimit gjyqësor, të administrohej eventualisht vendimi që do të merrej nga gjykata në lidhje me procedimin penal nr. {***}/2021, pa përcaktuar numrin apo datën e këtij vendimi, për shkak se, në kohën e paraqitjes së ankimit, çështja ndodhej ende në shqyrtim në seancë paraprake. Kjo rrethanë provohet edhe nga shkresa nr. {***} prot., datë 02.12.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision.
209. Referuar këtij fakti, Komisioni ka çmuar se ndodhej në kushtet e pengesës ligjore për vlerësimin e subjektit sipas parashikimit të nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Nga ana tjetër, gjatë gjykimit në Kolegj, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme i qëndroi kërkimin për përfshirjen në rrethin e vendimeve objekt vlerësimi të vendimmarrjes gjyqësore që do të merrej në lidhje me këtë procedim penal.
210. Në këto kushte, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës dhe nenin F të Aneksit të saj, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 84/2016, si dhe në zbatim të vendimit të ndërmjetëm të datës 23.07.2025, kërkoj nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, çdo vendim gjyqësor të dhënë në lidhje me procedimin penal nr. {***}/2021 të prokurorisë pranë kësaj gjykate në ngarkim të shtetasve R. H. dhe S. I.. Kjo kërkesë u mbështet edhe në detyrimin kushtetues dhe ligjor të institucioneve shtetërore për të përcjellë informacionin e kërkuar dhe për të garantuar aksesin e institucioneve të rivlerësimit në të dhënat që disponojnë, sipas parashikimeve të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 50 të ligjit nr. 84/2016.
211. Në përgjigje të kësaj kërkesë, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 24.07.2025, përcolli kopje të njësuara të vendimeve gjyqësore të dhëna në lidhje me procedimin penal nr. {***}/2021. Këto akte iu vunë në dispozicion palëve⁴⁷, të cilat konfirmuan marrjen e tyre. Në vijim, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme kërkoj administrimin e tyre në cilësinë e provës, duke rezervuar të drejtën për t'u shprehur mbi vlerën e tyre provuese në konkluzionet përfundimtare.
212. Nga ana tjetër, subjekti i rivlerësimit pretendoi se, për efekt të këtij procesi, interes paraqisnin vetëm vendimet e datës 23.10.2023 dhe 25.11.2024, pasi, sipas tij, ky kishte qenë edhe objekti i kërimit të Komisionerit Publik në ankim. Sipas subjektit, duke qenë se ankimi ishte paraqitur përpara përfundimit të procesit penal, kërkitimi i Komisionerit Publik kishte pasur si objekt

⁴⁷ Aktet: (i) vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë nr. {***}, datë 23.06.2021, 17 fletë; (ii) vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë nr. {***}, datë 21.06.2021, 24 fletë; (iii) vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë nr. {***}, datë 16.08.2022, 6 fletë; (iv) vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë nr. {***} regj. them, datë vendimi 05.07.2023, 20 fletë; (v) vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, nr. {***} regj.them, datë vendimi 23.10.2024, 17 fletë; (vi) vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë nr. {***}, datë 25.11.2024, 31 fletë; (vii) vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë nr. {***}, datë 25.12.2024, 5 fletë; (viii) kopje të procesverbaleve të seancave gjyqësore për gjykimin e çështjes penale me nr. {***} regjistri, datë regjistrimi 20.09.2022, për të cilën gjykata është shprehur me vendim përfundimtar me nr. {***}, datë 25.11.2024, 51 fletë.

vetëm administrimin e vendimmarrjes së ardhshme të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë në lidhje me këtë procedim penal.

213. Trupi gjykues, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenet 45, pika 1 dhe 49 të ligjit nr. 84/2016, vendosi të administrojë në cilësinë e provës të gjitha aktet e përcjella me shkresën nr. {***} prot., datë 24.07.2025, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.
214. Nga konkluzionet përfundimtare, rezulton se Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme i ka lidhur pretendimet e tij në lidhje me procedimin penal nr. {***}/2021 kryesisht me vendimet gjyqësore të dhëna pas datës 19.09.2022, periudhë gjatë së cilës subjekti i rivlerësimit ka ushtruar funksionin e prokurorit të çështjes. Konkretisht, ai është fokusuar në vendimin e datës 05.07.2023 të gjyqtarit të seancës paraprahe, në vendimin e datës 23.10.2023, si dhe në vendimin nr. {***}, datë 25.11.2024, për shqyrtimin e çështjes në themel. Në këtë kuadër, pretendimet për mangësi të veprimtarisë hetimore lidhen drejtpërdrejt me gjetjet e konstatuara në vendimin e datës 05.07.2023, në një fazë procedurale në të cilën subjekti i rivlerësimit ushtronte cilësinë e prokurorit të çështjes.
215. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit, sipas të cilit kërkesa e Kolegjit drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë ka tejkaluar kufijtë e ankimit të Komisionerit Publik, është i pambështetur. Kjo për arsye se Kolegji ka kërkuar dhe administruar akte gjyqësore që lidhen me të njëjtin procedim penal, në të cilin subjekti i rivlerësimit ka ushtruar funksionin e prokurorit, ndërsa hetimi dhe shqyrtimi gjyqësor në Kolegj janë fokusuar ekskluzivisht në veprimet dhe mosveprimet e tij në këtë cilësi, pa i atribuuar atij veprimtari procedurale të kryera nga prokurorë të tjerë në fazat e mëparshme të procedimit.
216. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues vëren se hetimi i kryer nga organi i akuzës, në tërësi, ka qenë i dobët dhe nuk ka reflektuar kujdesin e duhur, si dhe reagimin në kohë reale, për zbardhjen e plotë të një ngjarjeje kriminale me impakt në qytetin e Sarandës, në vendngjarjen e së cilës është sekuestruar një sasi e konsiderueshme gëzhgojash dhe ku rezulton të jenë përdorur disa armë zjarri dhe ka pasur dëmtime në shëndet. Në këtë procedim penal, nuk është bërë i mundur identifikimi i asnjë prej personave të përfshirë në ngjarje. Në rastin konkret, evidentohet mungesa e një përgjigjeje efektive nga organi i akuzës për identifikimin, kapjen dhe ndëshkimin e personave përgjegjës për kryerjen e veprave penale, çka është thelbësore për ruajtjen e besimit të publikut, respektimin e shtetit të së drejtës dhe parandalimin e akteve të paligjshme. Ky procedim penal, përfundimisht, është mbyllur me dënimin vetëm të shtetasit R. H., për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municioneve”, parashikuar nga neni 278, pika 1 e Kodit Penal.
217. Në lidhje me rrethanat në të cilat është vendosur zëvendësimi i prokurores A. Dh., bazuar në aktet e administruara dhe në shpjegimet e subjektit gjatë hetimit administrativ në Komision, trupi gjykues vëren se, sipas urdhrit të nxjerrë nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë, baza ligjore e përdorur për zëvendësimin e prokurores ka qenë neni 27, pika 1

e Kodit të Procedurës Penale⁴⁸. Në arsyetimin e këtij vendimi, subjekti ka argumentuar se, në përputhje me parimin e konsoliduar në jurisprudencë, sipas të cilit magjistrati (gjqytari ose prokurori) jo vetëm duhet të jetë dhe të tregohet i paanshëm e objektiv, por paanësia dhe integriteti i tij duhet të perceptohen si të tilla edhe nga subjektet e procedimit penal dhe publiku në përgjithësi, në rastin konkret ekzistonin shkaqe që justifikonin pranimin e kërkesës së shtetasit R.H. dhe zëvendësimin e prokurores A.Dh. nga drejtimi i hetimeve të procedimit penal nr. {***}/2021.

218. Megjithatë, në referim të sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se shkaqet e pasqyruara në vendimin e zëvendësimit nuk klasifikohen si arsye serioze që lidhen me ushtrimin e detyrës, sipas kuptimit të ligjit, dhe as përfshihen në rastet e parashikuara nga neni 17 i Kodit të Procedurës Penale. Trupi gjykues vëren se kërkuesi R.H. ka pretenduar njëanshmërinë e prokurores dhe cenimin e procesit të rregullt ligjor, pretendime të cilat, nëse do të ishin të bazuara, do të mund të përfshiheshin në parashikimin e nenit 17, shkronja “ë” e Kodit të Procedurës Penale. Për këtë rast, drejtuesi i prokurorisë nuk mund të vendosë zëvendësimin pa pëlqimin e prokurorit.
219. Në rastin objekt shqyrtimi, nuk rezulton që prokurorja e çështjes të ketë dhënë një pëlqim të tillë, pasi ajo nuk e ka pranuar asnjëherë kërkesën për zëvendësimin e saj, duke i konsideruar të pabazuara arsyet e paraqitura nga kërkuesi. Edhe pse lidhur me kërkesën e dytë ajo e ka lënë vlerësimin në çmim të drejtuesit të prokurorisë⁴⁹, kjo rrethanë nuk mund të barazohet me dhënien e pëlqimit të kërkuar nga ligji. Për rrjedhojë, drejtuesi i prokurorisë ka ushtruar diskrecionin e tij duke marrë vendimin objekt shqyrtimi përtej rasteve të parashikuara nga ligji.
220. Po ashtu, arsyetimi i subjektit në vendimin objekt shqyrtimi paraqitet i përgjithshëm dhe nuk evidenton shkaqe serioze apo ekzistencën e fakteve konkrete që mund të përbënin pengesë të rëndësishme për ushtrimin e detyrës nga ana e prokurores A. Dh., të afta për të justifikuar masën e zëvendësimit të ndërmarrë prej tij⁵⁰.
221. Veprimet e subjektit të rivlerësimit për zëvendësimin e prokurores së çështjes, znj. A. Dh., për të cilat nuk rezulton të kenë ekzistuar shkaqet e parashikuara nga neni 27 i Kodit të Procedurës Penale, si dhe paraqitja në gjykatë e dy kërkesave procedurale të analizuara më sipër, pa u kryer paraprakisht asnjë veprim hetimor dhe në kundërshtim të hapur me qëndrimet e mbajtura nga prokurorja e mëparshme e çështjes, përbëjnë tregues të dështimit të subjektit të rivlerësimit për

⁴⁸ Drejtuesi i prokurorisë vendos zëvendësimin e prokurorit kur ekzistojnë arsye serioze që lidhen me detyrën sipas ligjit, si dhe në rastet e parashikuara në nenet 16 dhe 17, paragrafi i parë, shkronjat “a”, “b”, “ç”, “d” dhe “dh”. Në rastet e tjera prokurori zëvendësohet vetëm me pëlqimin e tij.

⁴⁹ Prokurorja A. Dh. është shprehur në relacionin e datës 27.06.2022, drejtuar drejtuesit të prokurorisë se: “[...] bëj me dije se nuk kam kundërshtime për çdo vendimmarrje që ju do konsideroni të drejtë”.

⁵⁰ CDL-AD(2012)008, Opinion i Komisionit të Venecias mbi Aktin CLXIII të 2011 mbi Shërbimin e Prokurorisë dhe Aktin CLXIV të 2011 mbi Statusin e Prokurorit të Përgjithshëm, Prokurorëve dhe Punonjësve të tjerë të Prokurorisë dhe Karrierës së Prokurorisë së Hungarisë, § paragrafi 32: “[...] Megjithatë, heqja e çështjeve nga një prokuror duke mos u bazuar në ndonjë kriter, për t’ia ngarkuar çështjen një prokurori tjetër që është më i gatshëm të ndjekë një udhëzim të paligjshëm, mund të përbëjë abuzim. Sigurisht që kjo nuk do të ndodhë në praktikën normale, por ligji duhet të sigurojë garanci edhe kundër mundësive të thjeshta të abuzimit. Duhet të ketë kritere strikte për heqjen e çështjeve nga prokurorët më të ulët”.

të orientuar dhe zhvilluar hetimin në përputhje me kërkesat ligjore, me qëllim mbledhjen e provave të nevojshme për zbardhjen e plotë të çështjes. Një situatë e tillë bie ndesh me standardet e ushtrimit të funksionit të prokurorit, të përcaktuara në nenin 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

222. Këto problematika të konstatuara nga trupi gjykues, u vlerësuan gjithashtu në ndërthurje me informacionin e klasifikuar të administruar nga agjencitë ligjzbatuese, nga i cili përftohen elemente me rëndësi për vlerësimin e integritetit të subjektit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 75, pika 3 e ligjit nr. 96/2016.

D. Lidhur me vlerësimin e shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e aftësive profesionale

223. Në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, bazuar në raportin për analizimin e aftësisë profesionale të tij të kryer nga KLP-ja, si dhe në analizimin e fakteve të denoncuara nga publiku gjatë procesit të rivlerësimit, duke konkluduar se: *Për subjektin është vlerësuar se: (i) ka treguar aftësi të mira profesionale sipas nenit 73 të ligjit nr. 96/2016; (ii) ka treguar aftësi të mira organizative sipas nenit 74 të ligjit nr. 96/2016; (iii) ka treguar etikë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale sipas nenit 75 të ligjit nr. 96/2016; si dhe (iv) ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional sipas nenit 76 të ligjit nr. 96/2016. Për rrjedhojë, sipas germës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016. Komisioneri Publik mban qëndrim të ndryshëm nga Komisioni në lidhje me konkluzionin e mësipërm, si dhe sa u takon gjetjeve të rezultuara nga hetimi administrativ lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, duke parashtruar se:*

224. *Në lidhje procedimin penal nr. {***}/2017 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, të adresuar në denoncimin e shtetasit V. R., trupi gjykues vëren si vijon.*

225. Komisioni, në qëndrimin e mbajtur lidhur me procedimin penal nr. {***}/2017, ka vlerësuar se mosrespektimi i afatit tremujor, të përcaktuar me vendimin nr. {***}, datë 30.5.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, përbën rastin e vetëm të kësaj natyre të evidentuar në veprimtarinë profesionale të subjektit të rivlerësimit. Sipas Komisionit, moskryerja e veprimeve hetimore për periudha të gjata kohore, nuk u provua të përbënte një sjellje të përsëritur apo një metodë pune të subjektit, duke u mbajtur në konsideratë edhe volumi i lartë i punës së tij.

226. Në këtë drejtim, Komisioni iu referua opinionit të Komisionit të Venecias dhe jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese⁵¹, sipas të cilëve kufiri ndarës për një vlerësim negativ të aftësive

⁵¹ Në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017, datë 18 janar 2017, në paragrafin 54 të tij citohet: “Në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht “të pasakta” nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston

profesionale kapërcehet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur konstatohet një seri e qartë dhe e vazhdueshme vendimmarrjesh ose veprimesh të gabuara që tregojnë mungesë të aftësive profesionale. Për rrjedhojë, Komisioni çmoi se mangësitë e konstatuara në këtë rast, nuk ishin të tilla që të cenonin aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

227. Në kundërshtim me këtë qëndrim të Komisionit, Komisioneri Publik, duke iu referuar jurisprudencës së Kolegjit⁵² dhe duke e vlerësuar çështjen në tërësinë e saj, ka evidentuar se, në rastet kur gabimet e subjekteve të rivlerësimit përsëriten në mënyrë të vazhdueshme dhe manifestohen në praktika të ndryshme profesionale, ato nuk mund të konsiderohen si mangësi të izoluara, por përbëjnë raste që përjashtojnë konfirmimin në detyrë dhe, si të tilla, duhet të vlerësohen negativisht.
228. Komisioneri Publik ka pretenduar gjithashtu se, në referim të orientimeve të dhëna nga Kolegji në jurisprudencën e tij⁵³, këto gjetje duhet të vlerësohen në kuadër të vlerësimit tërësor të subjektit të rivlerësimit, në funksion të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në lidhje me parashikimet e nenit 61, pika 5 e po këtij ligji.
229. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegji, mbajti të njëjtin qëndrim si në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ në Komision, duke pretenduar se vlerësimi profesional i magistratëve gjatë procesit të rivlerësimit realizohet bazuar në parashikimet e ligjit nr. 84/2016 dhe të legjislationit që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, për periudhën e rivlerësimit nga data 08.10.2013 deri më 08.10.2016, ndërsa, në mënyrë përjashtimore, përfshin edhe periudhën nga 1 janari 2006 deri më 08.10.2016. Sipas subjektit, ky kufizim është vendosur për të garantuar respektimin e parimit të sigurisë juridike, si dhe të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, të sanksionuar nga neni 7 i Kushtetutës.
230. Sipas tij, pas kësaj periudhe, në zbatim të neneve 3, pika 2, dhe 41 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të nenit 171 të ligjit nr. 96/2016, kompetenca ekskluzive për inspektimin e shkeljeve disiplinore dhe për vlerësimin etik e profesional të magistratëve i përket Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Në këtë kuadër, subjekti pretendoi se edhe në rastin konkret, gjejnë zbatim konsideratat e shprehura nga Kolegji në vendimin nr. 33/2021, sipas të cilave vlerësimi i aftësive profesionale nuk shtrihet mbi çështjet që janë ende në shqyrtim. Po ashtu, ai theksoi se pretendimet e Komisionerit Publik bien në kundërshtim edhe me jurisprudencën e Kolegjit të pasqyruar në vendimin nr. 28/2020, sipas të cilit kompetenca kushtetuese dhe ligjore e organeve të rivlerësimit, sipas nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 43 e 44 të ligjit nr. 84/2016, nuk përfshin gjykimin apo vlerësimin e logjikës dhe bazueshmërisë së vendimmarrjes së magistratit, pasi ky vlerësim u përket organeve më të larta gjyqësore.

një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale” (shih edhe opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias).

⁵² Referuar vendimit (JR) nr. 16/2021 të Kolegjit.

⁵³ Sipas vendimit nr. 2/2020 të Kolegjit.

231. Lidhur me veprimtarinë hetimore në këtë procedim penal, subjekti pretendoi se kishte dhënë shpjegime të detajuara në lidhje me denoncimin dhe se regjistrimi i procedimit penal ishte bërë pasi kallëzuesi ishte pyetur personalisht, sipas procesverbalit të datës 27.09.2017, çka, sipas tij, dëshmonte se ai e kishte vlerësuar seriozisht faktin penal të kallëzuar. Subjekti shpjegoi se kallëzuesi ndodhej në lidhje të posaçme gjinie me të kallëzuarin dhe se pretendimet e ngritura prej tij lidheshin kryesisht me pronën e tezes së tyre, ndaj situata nuk paraqiste ndonjë veçanti që të kërkonte vëmendje të shtuar, aq më tepër kur Kushtetuta dhe ligji nuk e kanë parashikuar prokurorin si organ kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të pronësisë.
232. Subjekti shtoi se kallëzuesi kishte paraqitur edhe një tjetër kallëzim penal në Prokurorinë e Vlorës, me të njëjtën natyrë veprash penale dhe me të njëjtat pretendime, i cili ishte pushuar nga prokurori i çështjes. Sipas tij, çështje të kësaj natyre kërkojnë angazhime dhe konsum të konsiderueshëm kohe, energjie dhe burimesh njerëzore, megjithatë procedimi ishte hetuar me hollësi dhe, në përfundim, ishin paraqitur kërkimet përkatëse, në përputhje me pritshmëritë e kallëzuesit.
233. Në vijim, subjekti pretendoi se, pavarësisht se Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë dhe më pas Gjykata e Apelit Vlorë kishin mbajtur qëndrime të ndryshme lidhur me rrethanat e faktit dhe objektin e hetimit, çështja ishte pushuar mbi bazën e një arsytimi të detajuar të rrethanave faktike në raport me ligjin dhe se prokurori i çështjes, drejtuesi i seksionit dhe drejtuesi i prokurorisë kishin ndarë të njëjtin vlerësim për mënyrën e zgjidhjes së saj. Ai argumentoi gjithashtu se dispozitat e reja procedurale imponojnë një qasje të detyrueshme në ndjekjen penale kur qëndrimi i prokurorit ndryshon nga ai i gjykatës dhe se, në zbatim të vendimeve të sipërcituara, të cilat kanë pasur shkëputje kohore ndërmjet tyre, kishte disponuar me kërkesat përkatëse. Për këto akte, sipas subjektit, nuk mund të jepen vlerësime të mëtejshme ligjore nga organet e rivlerësimit, për sa kohë që çështja vijon të jetë në shqyrtim pranë gjyqtarit të themelit.
234. Nga analizimi i akteve të administruara gjatë hetimit në Komision, trupi gjykues vëren se:
- Komisioni ka administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë⁵⁴ dosjen e procedimit penal nr. {***}/2017, që lidhet me kallëzimin penal të paraqitur nga shtetasi V. R.⁵⁵. Nga shqyrtimi i akteve të fashikullit, rezulton se: (i) më datë 27.09.2017, subjekti i rivlerësimit ka vendosur regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal; (ii) më datë 07.11.2017, ai ka urdhëruar caktimin e ekspertit për kryerjen e ekspertimit tekniko-grafik të formularit nr. 6, “Listë e familjeve që marrin tokë në pronësi”, nga i cili ka rezultuar se dokumenti përmbante shtesa dhe ndërhyrje të kryera nga persona të ndryshëm nga plotësuesi i formularit; (iii) më datë 04.10.2018, ka disponuar sekuestrimin e dokumentacionit pranë DAMT-së së Këshillit të Qarkut Vlorë; dhe (iv) më datë 07.03.2019, ka njoftuar kallëzuesin për përfundimin e hetimeve.

⁵⁴ Sipas shkresës nr. {***} prot., datë 15.04.2022, në dosjen e Komisionit.

⁵⁵ Denoncuesi, në parashkrimet e tij, referon se, në muajin shtator 2017, ka bërë kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve, tjetërsim pronash dhe shpërdorim detyre, duke pretenduar se subjekti i rivlerësimit zvarrit çështjen penale prej dy vitesh, pushon çështjen pa marrë asnjë person nën hetim.

Në vijim, më datë 21.03.2019, subjekti ka vendosur dërgimin në gjykatë të kërkesës për pushimin e procedimit penal nr. {***}/2017.

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 30.05.2019, ka vendosur: (i) kthimin e akteve prokurorit për plotësimin e hetimeve sipas drejtimeve të përcaktuara në pjesën arsyetuese të vendimit; dhe (ii) kryerjen e këtyre veprimeve brenda afatit tremujor. Në arsyetimin e saj, gjykata ka vlerësuar se nuk ndodheshin kushtet për pushimin e procedimit penal, pasi hetimet nuk ishin shteruese. Në këtë kuadër, ajo ka çmuar të domosdoshëm hetimin nëse dokumenti i dyshuar si i falsifikuar ishte përdorur ndonjëherë nga shtetasi B.P. dhe nëse ky i fundit kishte pasur dijeni për falsitetin e tij, pyetjen e kallëzuesit V.R., si dhe verifikimin e mënyrës së përcjelljes së dokumentit në DAMT, pranë Këshillit të Qarkut Vlorë.

- Kundër këtij vendimi, subjekti i rivlerësimit ka ushtruar ankim, i cili është mospranuar nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. {***}, datë 04.07.2019. Në arsyetimin e saj, gjykata ka vlerësuar se vendimi nr. {***}, datë 30.05.2019, ishte rrjedhojë e zbatimit korrekt të ligjit procedural penal dhe duhej lënë në fuqi, pasi hetimet paraprake nuk ishin të plota, gjithëpërfshirëse dhe shteruese. Sipas saj, prokurori nuk duhej të dispononte për pushimin e procedimit pa kryer disa veprime hetimore thelbësore, konkretisht: verifikimin nëse dokumenti ishte përdorur nga kallëzuesi ose persona të tjerë, kryerjen e ekspertimit për të përcaktuar nëse ndërhyrjet në dokument ishin bërë nga shtetasi B.P., si dhe hetimin e mënyrës së përcjelljes së dokumentit në DAMT.

- Nga aktet, rezulton se kallëzuesi V. R. ka paraqitur më datë 06.09.2019 “Memorie mbi parashtrimin e kërkesave plotësuese për kallëzimin penal”, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, përmes së cilës ka kërkuar kryerjen e veprimeve të mëtejshme hetimore, informacion mbi ecurinë e procedimit dhe njohjen me aktet e dosjes. Nga aktet e administruara, nuk rezulton të jetë kthyer përgjigje në përputhje me nenin 110 të Kodit të Procedurës Penale. Më datë 02.11.2020, subjekti ka urdhëruar regjistrimin e emrit të personit të cilit i atribuohet vepra penale, shtetasit B. P., si dhe më pas ka disponuar marrjen e tij si të pandehur dhe njoftimin e akuzës për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Në vijim, më datë 21.01.2021, mbrojtësi i të pandehurit ka kërkuar kryerjen e ekspertimit tekniko-grafik të B. P., me arsyetimin se ky veprim hetimor nuk ishte realizuar gjatë hetimeve paraprake. Edhe në këtë rast, nga aktet nuk rezulton të ketë një vendimmarrje të subjektit lidhur me këtë kërkesë, ndonëse kryerja e këtij veprimi ishte urdhëruar edhe nga gjykata me vendimin nr. {***}, datë 30.05.2019.

- Më datë 25.01.2021, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. {***}/2017 ndaj të pandehurit B. P., për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, me arsyetimin se kishte përdorur dokument të falsifikuar. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 07.04.2021, duke çmuar se hetimet ishin të plota dhe se nuk nevojiteshin veprime të tjera hetimore, ka vendosur dërgimin e çështjes për gjykim.

- Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës në lidhje me këto konstatime: (i) nga data 27.09.2017 deri më datë 21.03.2019, periudhë prej rreth një viti e gjashtë muajsh, gjatë së cilës

procedimi është regjistruar pa autor të identifikuar, evidentohen intervale prej rreth 9 dhe 5 muajsh pa kryer veprime hetimore; (ii) pas vendimit nr. {***}, datë 30.05.2019, nuk është kryer ekspertimi për të përcaktuar nëse ndërhyrjet në dokument ishin bërë nga shtetasi B. P., megjithëse ky veprim ishte urdhëruar nga gjykata dhe kërkuar edhe nga i pandehuri; dhe (iii) megjithëse vendimi nr. {***} i është komunikuar subjektit më datë 15.08.2019, deri më datë 09.06.2020 ai nuk ka kryer asnjë veprim hetimor, për një periudhë afro 10-mujore.

- Në përgjigje të barrës së provës, subjekti ka sqaruar se procedimi penal ndodhet ende në shqyrtim gjyqësor dhe nuk ka marrë formë të prerë. Lidhur me intervalet 9-mujore dhe 5-mujore pa veprime hetimore, ai ka pretenduar se ato kanë ardhur si pasojë e ngarkesës së lartë në punë. Për sa i përket moskryerjes së ekspertimit të kërkuar nga gjykata, subjekti ka pretenduar se vendimi nr. {***}, datë 30.05.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është i gabuar. Ndërsa lidhur me konstatimin e Komisionit për moskryerjen e veprimeve hetimore për afro 10 muaj pas komunikimit të këtij vendimi, subjekti nuk ka dhënë shpjegime.

235. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e administruara në dosje, pretendimet e palëve dhe kërkimet përfundimtare të drejtuesit të prokurorisë, si dhe ato të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë gjykimit në Kolegj, vlerëson si vijon.

236. Përfundimet e arritura nga Komisioni në lidhje me këtë procedim penal, nuk janë të drejta në raport me rrethanat konkrete të çështjes, pasi mangësitë e evidentuara nga vetë Komisioni, të referuara më sipër, ndonëse rezultojnë të provuara, nuk janë të tilla që t'i përgjigjen përfundimit të arritur prej tij lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

237. Nga ana tjetër, pretendimi i ankuesit se subjekti i rivlerësimit, edhe gjatë gjykimit në Kolegj, nuk arriti të përmbyste barrën e provës lidhur me gjetjet e Komisionit, rezulton i drejtë dhe i bazuar, për sa kohë u provua se: (i) nga data 27.09.2017, kur është regjistruar procedimi penal pa autor të identifikuar, deri më datë 21.03.2019, kur është paraqitur në gjykatë kërkesa për pushimin e procedimit penal, procedimi ka zgjatur rreth një vit e gjashtë muaj dhe gjatë kësaj periudhe evidentohen intervale prej 9 dhe 5 muajsh pa kryer veprime hetimore; (ii) pas vendimit nr. {***}, datë 30.05.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, nga ana e prokurorit nuk është kryer akt ekspertimi për të përcaktuar nëse ndërhyrjet në dokument janë bërë nga shtetasi B. P., ndonëse ky veprim ishte urdhëruar nga gjykata dhe kërkuar edhe nga i pandehuri; dhe (iii) megjithëse vendimi i formës së prerë nr. {***}, datë 30.05.2019, i është komunikuar subjektit më datë 15.08.2019, deri më datë 09.06.2020 ai nuk ka kryer asnjë veprim hetimor, për një periudhë rreth 10-mujore.

238. Trupi gjykues konstaton se përfundimi i arritur nga Komisioni, sipas të cilit mosrespektimi i afatit tremujor të përcaktuar me vendimin nr. {***}, datë 30.05.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, përbën rastin e vetëm të kësaj natyre të evidentuar në veprimtarinë profesionale të subjektit të rivlerësimit, nuk gjen mbështetje në rrethanat e konstatuara nga vetë Komisioni. Kjo pasi, në të njëjtin procedim penal, Komisioni ka evidentuar gjithashtu periudha të gjata pasiviteti në kryerjen e veprimeve hetimore, konkretisht intervale prej rreth 9 dhe 5 muajsh, gjatë të cilave subjekti i rivlerësimit nuk ka ndërmarrë asnjë veprim hetimor.

239. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dështuar të orientojë dhe zhvillojë hetimin në mënyrë efektive, duke mos ndërmarrë në kohë veprimet e nevojshme për mbledhjen e plotë dhe të gjithanshme të provave. Një sjellje e tillë bie ndesh me standardet e ushtrimit të funksionit të prokurorit, të përcaktuara në nenin 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.
240. Ndonëse subjekti i rivlerësimit është përpjekur të relativizojë natyrën e këtyre mangësive, duke parashtruar shkaqe që lidhen me ngarkesën në punë, me faktin se çështja, për shkak të marrëdhënies së posaçme ndërmjet të kallëzuarit dhe kallëzuesit, nuk paraqiste veçori që kërkonin një vëmendje të shtuar, si dhe duke pretenduar se mënyra se si ai ka proceduar në këtë procedim penal ka qenë në përputhje me pritshmëritë e kallëzuesit, trupi gjykues vlerëson se, megjithëse disa prej vështirësive të referuara prej subjektit mund të qëndrojnë, ato nuk janë të mjaftueshme për të relativizuar problematikat e konstatuara.
241. Prania e mangësive të evidentuara në disa prej procedimeve penale të shqyrtuara në vendimin objekt kontrolli, të konstatuara edhe nga vetë Komisioni dhe të ngritura nga Komisioneri Publik në ankimin e tij, tregon se nuk kemi të bëjmë me mangësi të izoluara apo episodike, por me problematika që përsëriten në praktika të ndryshme profesionale të subjektit të rivlerësimit. Si të tilla, ato u bënë pjesë e vlerësimit tërësor në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, me pasojë aplikimin e nenit 61, pika 5 e po të njëjtit ligj.
242. Sa u takon pretendimeve të subjektit të rivlerësimit se kjo çështje është trajtuar në tejkalim të periudhës së rivlerësimit të përcaktuar nga ligji nr. 84/2016, si dhe në tejkalim të kompetencës kushtetuese dhe ligjore të organeve të rivlerësimit, për shkak të ndalimit të vlerësimit të aftësive profesionale në çështje që janë ende në shqyrtim, sipas pikës 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, trupi gjykues vlerëson se këto pretendime nuk janë të bazuara.
243. Në referim të pikës 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, vlerësimi i aftësive profesionale përfshin aftësinë për të gjykuar, aftësitë organizative, etikën dhe angazhimin ndaj vlerave gjyqësore, cilësitë personale dhe angazhimin profesional, bazuar në standardet e përcaktuara në ligj. Ndërkohë, lidhur me shtrirjen kohore të këtij vlerësimi, ligjvënësi ka përcaktuar në mënyrë të qartë, në pikën 4 të nenit 41 të ligjit nr. 84/2016, se vlerësimi i aftësive profesionale mund të shtrihet nga data 1 janar 2006 e në vazhdim, në varësi të informacionit që disponohet mbi etikën dhe aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit.
244. Nga interpretimi i këtyre dispozitave kushtetuese dhe ligjore, rezulton se periudha 3-vjeçare e parashikuar në pikën 3 të nenit 41 të ligjit nr. 84/2016 lidhet me vlerësimin e dosjeve të shortuara për këtë qëllim ose të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit. Megjithatë, kjo periudhë nuk kufizon kompetencën e organeve të rivlerësimit për të marrë në shqyrtim dhe vlerësuar të dhëna apo indicie që lidhen me etikën dhe aftësitë profesionale të subjektit, të krijuara që nga data 1 janar 2006 e në vijim.
245. Në të njëjtën logjikë duhet të interpretohet edhe parashikimi i nenit 53, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, që rregullon denoncimet nga publiku. Këto dispozita nuk kufizojnë burimet e vlerësimit vetëm brenda afatit 3-vjeçar të parashikuar në nenin 41, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Përkundrazi, nëse gjatë procesit të rivlerësimit evidentohej indicie ose të dhëna mbi fakte që

mund të ndikojnë në vlerësimin e njërit prej tri kriterëve kushtetuese të rivlerësimit, institucionet e rivlerësimit kanë detyrimin ligjor t'i marrin ato në shqyrtim dhe t'i vlerësojnë në kuadër të kompetencave të tyre.

246. Po ashtu, trupi gjykues vlerëson të sjellë në vëmendje se, sipas qëndrimit tashmë të konsoliduar të Kolegjit⁵⁶, zbatimi i nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, i cili parashikon se: “[...] vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim”, u referohet atyre çështjeve që, në kohën e zhvillimit të procesit të rivlerësimit, vijojnë të jenë në shqyrtim nga vetë magjistrati që i nënshtrohet këtij procesi.
247. Në rastin konkret, trupi gjykues çmon se denoncimi i paraqitur nga shtetasi V. R., i cili lidhej me pretendime për zvarritje të procedimit penal dhe moskryerje të veprimeve hetimore në intervale të gjata kohore, nuk mund të konsiderohet si një “çështje në shqyrtim” në kuptim të kësaj dispozite kushtetuese. Kjo pasi objekt i vlerësimit të organeve të rivlerësimit nuk ka qenë themeli i akuzës apo zgjidhja përfundimtare e procedimit penal nr. {***}/2017, por mënyra e ushtrimit të funksionit nga subjekti i rivlerësimit gjatë fazës së hetimit paraprak, konkretisht kohëzgjatja e hetimeve dhe pasiviteti procedural i konstatuar gjatë zhvillimit të tyre.
248. Për më tepër, në kohën kur Komisioni ka kryer vlerësimin e subjektit të rivlerësimit Kledian Llaho, këto aspekte procedurale kishin qenë tashmë objekt shqyrtimi gjyqësor dhe ishin trajtuar me vendimin nr. {***}, datë 30.05.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të lënë në fuqi me vendimin nr. {***}, datë 04.07.2019, të Gjykatës së Apelit Vlorë. Më tej, procedimi penal kishte vijuar me vendimin nr. {***}, datë 07.04.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për dërgimin e çështjes për gjykim.
249. Në këto kushte, institucionet e rivlerësimit ishin të legjitimuara të analizonin dhe vlerësonin këto rrethana në kuadër të kriterit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, trupi gjykues e vlerëson të pabazuar në ligj dhe në prova pretendimin e subjektit të rivlerësimit lidhur me tejkalimin e kompetencës së organeve të rivlerësimit.
250. Sa i takon pretendimit tjetër të subjektit të rivlerësimit, sipas të cilit shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik bien në kundërshtim me jurisprudencën e Kolegjit, konkretisht me vendimin nr. 33/2021, ku është arsyetuar se qëndrimi i ndryshëm i gjykatës në raport me kërkimin e prokurorit nuk mund të sjellë, në vetvete, pasoja ndëshkuese në vlerësimin e aftësive profesionale të magjistratit, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim nuk është i bazuar.
251. Në rastin konkret, shkaqet e ngritura nga Komisioneri Publik nuk lidhen me mënyrën e zgjidhjes së çështjes nga subjekti i rivlerësimit, as me bazueshmërinë juridike të kërkimeve të tij procedurale, por me kohëzgjatjen e hetimit dhe mungesën e kryerjes së veprimeve hetimore për intervale të gjata kohore. Këto mangësi janë evidentuar në vendimin nr. {***}, datë 30.05.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të lënë në fuqi me vendimin përkatës të Gjykatës së Apelit Vlorë, ku është arsyetuar se procedimi penal nuk duhej të ishte pushuar pa u kryer disa veprime hetimore të domosdoshme.

⁵⁶ *Shih vendimet e Kolegjit nr. 7/2019 (JR), datë 05.04.2019; nr. 16/2020 (JR), datë 13.07.2020.*

252. Për rrjedhojë, thelbi i pretendimit të Komisionerit Publik nuk ka të bëjë me faktin që gjykata ka mbajtur një qëndrim të ndryshëm nga ai i prokurorit, por me konstatimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka ndërmarrë, në kohën dhe mënyrën e duhur, veprimet hetimore që kërkohen nga standardet e ushtrimit të funksionit të prokurorit, sipas parashikimit të nenit 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar. Në këto kushte, edhe ky pretendim i subjektit të rivlerësimit çmohet i pabazuar.
253. *Lidhur me procedimin penal nr. {***}/2015 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë*, të iniciuar mbi bazën e denoncimit të shtetasit E. Y.⁵⁷ dhe personave të tjerë, për të cilin ankuesi pretendoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të përmbyste barrën e provës lidhur me gjetjet e Komisionit, të cilat kishin të bënin me mosrespektimin e afatit për regjistrimin e procedimit penal, zgjatjen e pajustificuar të hetimeve dhe mungesën e ngritjes së akuzës ndaj njërit prej personave të dyshuar si autorë të veprës penale, trupi gjykues vëren si vijon.
254. Komisioni, në paragrafin 81 të vendimit, në vlerësimin përfundimtar të kësaj çështjeje, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka përmbushur detyrat e tij si prokuror dhe se regjistrimi i procedimit penal përtej afatit 30-ditor, si dhe ngritja e akuzës dhe vlerësimi fillestar për marrjen si të pandehur vetëm të njërit prej personave të përfshirë, nuk kanë qenë të diktuar nga qëllimi për të zvarritur hetimet apo për të favorizuar ndonjë të pandehur. Sipas Komisionit, këto veprime kanë ardhur si pasojë e fakteve dhe rrethanave të evidentuara gjatë kryerjes së një numri të konsiderueshëm veprimesh hetimore, si dhe e vlerësimit të tyre nga subjekti i rivlerësimit në përputhje me bindjen e tij të brendshme.
255. Komisioni ka vlerësuar gjithashtu se mungesa e vullnetit për të zvarritur hetimet ose për të favorizuar palët në proces gjen mbështetje edhe në kërkesën e subjektit të rivlerësimit, të datës 15.06.2021, për heqje dorë nga përfaqësimi në gjykim i çështjes, e cila është rrëzuar me vendimin e arsyetuar të datës 16.06.2021 të drejtuesit të prokurorisë. Ky i fundit jo vetëm që nuk ka konstatuar shkelje në veprimtarinë e subjektit të rivlerësimit, por ka evidentuar se ai kishte vepruar në përputhje me ligjin procedural dhe atë material.
256. Më tej, Komisioni ka çmuar se subjekti i rivlerësimit ka qenë konsistent në qëndrimin e tij, duke mos qenë dakord me vlerësimin e gjykatës mbi faktin penal, qëndrim të cilin e ka mbajtur edhe në ankimin kundër vendimit gjyqësor. Po ashtu, Komisioni ka vlerësuar se, ndonëse Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka disponuar ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale dhe formulimin e akuzës edhe ndaj shtetasit M. M., detyrime të cilat subjekti i rivlerësimit i ka zbatuar pas kthimit të çështjes për hetim, gjykata nuk ka evidentuar mangësi në hetime dhe as nuk ka lënë detyra për kryerjen e veprimeve të tjera hetimore. Sipas Komisionit, gjykata ka kryer një vlerësim të ndryshëm të fakteve dhe rrethanave të rezultuara nga veprimet hetimore të zhvilluara nga subjekti i rivlerësimit.
257. Për sa më sipër, Komisioni ka arritur në përfundimin se veprimet e subjektit të rivlerësimit kanë qenë të paqëllimshme dhe nuk janë diktuar nga synimi për të zvarritur procedimin apo për të favorizuar ndonjë prej palëve.

⁵⁷ *Shih denoncim nr. {***} prot., datë 16.10.2019, në dosjen e Komisionit.*

258. Komisioneri Publik kundërshtoi qëndrimin e Komisionit, duke pretenduar se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të përmbyste barrën e provës lidhur me gjetjet e evidentuara dhe se qëndrojnë si të bazuara pretendimet e denoncuesit në lidhje me mungesën e ngritjes së akuzës edhe ndaj shtetasit M. M., si dhe me afatin e tejzgjatur të procedimit penal.
259. Sipas Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit, të paktën, ka shfaqur mangësi në efikasitetin hetimor, si në drejtim të ndërmarrjes së veprimeve hetimore në përputhje me kërkesat ligjore për mbledhjen e provave të nevojshme, ashtu edhe në drejtim të aftësisë për të përballuar ngarkesën e punës dhe për të administruar procedimin brenda afateve të arsyeshme.
260. Komisioneri Publik dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, përfshirë edhe në bisedimet përfundimtare, vlerësuan se edhe në këtë rast ekzistojnë rrethana që duhet të analizohen në kuadër të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të vlerësimit të nënindikatorëve të përcaktuar në nenin 73, pika 2, dhe nenin 74, pika 1 e ligjit nr. 96/2016.
261. Lidhur me këtë shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit, në mënyrë të përmbledhur, pretendoi se, sipas shkresës nr. {***} prot., datë 07.12.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, edhe ky procedim penal, deri në momentin e shqyrtimit të çështjes që lidhej me juridiksionin e rivlerësimit të tij, ndodhej në fazën e gjykimit në themel. Për rrjedhojë, në mungesë të një vendimi përfundimtar, edhe në këtë rast gjente zbatim qëndrimi i Kolegjit i shprehur në vendimin nr. 33/2021, konkretisht në paragrafin 84 të tij.
262. Sa i takon konstatimit të Komisionerit Publik lidhur me tejkalimin e afatit 30-ditor për regjistrimin e procedimit penal, subjekti mbajti të njëjtin qëndrim si gjatë hetimit administrativ në Komision, duke pretenduar se, sipas jurisprudencës së Kolegjit në një rast të ngjashëm, subjekti i rivlerësimit nuk është penalizuar me masë disiplinore, pavarësisht se ishte konstatuar regjistrimi i procedimit penal përtej këtij afati.
263. Në lidhje me pretendimet e Komisionerit Publik për mungesën e ngritjes së akuzës ndaj shtetasit M. M. dhe afatin e tejzgjatur të procedimit, subjekti pretendoi se, nga analiza e vendimit nr. {***}, datë 27.03.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, nuk rezulton që gjykata të ketë konstatuar mangësi në hetime. Sipas tij, gjyqtarja e seancës paraprake ka kryer një vlerësim të ndryshëm të faktit penal dhe të provave të administruara gjatë hetimit paraprak, ndërsa Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur mospranimin e ankimit, për shkak se ligji nuk lejon ankimin ndaj vendimit të gjykatës për kthimin e akteve prokurorit.
264. Subjekti evidentoi gjithashtu se kishte qenë pikërisht ai që, pas pushimit të çështjes me vendim gjyqësor të formës së prerë, me kërkesën e datës 06.11.2018, i ishte drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për revokimin e vendimit të pushimit dhe rinisjen e hetimeve, kërkesë e cila ishte pranuar nga gjykata.
265. Në përfundim, subjekti pretendoi se edhe në rastin e këtij procedimi penal, gjen zbatim qëndrimi i mbajtur nga Kolegji në vendimin nr. 28/2020, sipas të cilit kompetenca kushtetuese dhe ligjore e organeve të rivlerësimit nuk përfshin një gjykim apo vlerësim mbi logjikën dhe

bazueshmërinë e vendimmarrjes së një magjistrati, pasi ky vlerësim përbën atribut të organeve më të larta gjyqësore.

266. Nga analizimi i akteve të administruara gjatë hetimit në Komision, trupi gjykues vëren se:

- Në Komision është paraqitur denoncimi i shtetasve E. Y. dhe të tjerëve, të cilët kanë pretenduar se subjekti i rivlerësimit nuk ka ndërmarrë masa procedurale edhe ndaj shtetasit M. M. në procedimin penal nr. {***/2015, duke dërguar çështjen për gjykim vetëm ndaj shtetasit V. M., në bazë të nenit 134, paragrafi i parë i Kodit Penal, ndonëse, sipas tyre, ekzistonin kushtet për aplikimin e paragrafit të tretë të kësaj dispozite.
- Me qëllim verifikimin e këtyre pretendimeve, Komisioni ka administruar dosjen e procedimit penal nr. {***/2015 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë. Nga shqyrtimi i akteve, rezulton se Sindikata e Pavarur e Transportit të Shqipërisë (në vijim “SPTSH”) ka paraqitur kallëzimin penal nr. {***}, datë 26.05.2015, ndaj shtetasve M. M. dhe L. Q., për veprat penale të “Falsifikimit të dokumenteve” dhe “Vjedhjes duke shpërdoruar detyrën”. Pas kryerjes së disa veprimeve hetimore, më datë 09.09.2015, subjekti i rivlerësimit ka regjistruar procedimin penal nr. {***/2015, për veprën penale “Vjedhja duke shpërdoruar detyrën”, parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal.
- Nga aktet rezulton se, më datë 23.11.2015 dhe 14.01.2016, janë paraqitur edhe dy kallëzime të tjera penale, përkatësisht nga Sindikata e Pavarur e Punonjësve të Naftës në Shqipëri (në vijim “SPPNSH”) dhe Sindikata e Pavarur QPN/Federata e Naftëtarëve, ndaj shtetasve M. M. dhe V. M., për veprat penale të “Vjedhjes duke shpërdoruar detyrën” dhe “Falsifikimit të dokumenteve”. Këto kallëzime janë bashkuar me aktet e procedimit penal nr. {***/2015.
- Pas kryerjes së veprimeve të mëtejshme hetimore, më datë 26.12.2017, subjekti i rivlerësimit ka njoftuar kallëzuesit për përfundimin e hetimeve dhe, me shkresën nr. {***} prot., datë 29.12.2017, i është drejtuar gjykatës me kërkesë për pushimin e procedimit penal nr. {***/2015. Në thelb, ai ka arsyetuar se: (i) pretendimet për falsifikim dokumentesh nuk mund të provoheshin; (ii) nuk provohej përvetësimi i vlerave financiare nga drejtuesit e sindikatës; dhe (iii) mosmarrëveshjet mbi administrimin e të ardhurave financiare të sindikatave nuk përbënin çështje që duhej të zgjidheshin nga prokuroria.
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 05.02.2018, ka vendosur kthimin e akteve prokurorit dhe formulimin e akuzës ndaj shtetasve M. M. dhe V. M. për veprën penale të “Vjedhjes”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal. Gjykata ka arsyetuar se ekzistonin prova të mjaftueshme për ngritjen e akuzës, duke iu referuar, ndër të tjera, vendimit penal të formës së prerë për falsifikimin e dokumenteve, tërheqjes së shumave nga personat në fjalë dhe konkluzioneve të ekspertimit kontabël.
- Ky vendim është ankimuar nga subjekti i rivlerësimit dhe Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 06.06.2018, ka vendosur prishjen e vendimit të gjyqtarit të seancës paraprake dhe pushimin e procedimit penal nr. {***/2015.
- Më datë 19.10.2018, drejtuesi i prokurorisë i ka kaluar subjektit kallëzimin penal nr. {***/2018, të paraqitur nga shtetasit V. F., E. Y., M. G. dhe R. T., ndaj shtetasve M. M., V.

M. dhe A. N.. Më datë 06.11.2018, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar revokimin e vendimit të pushimit dhe rinisjen e hetimeve, duke iu referuar vendimit nr. {***}, datë 26.07.2018, të Gjykatës së Apelit Vlorë⁵⁸, me të cilin këta shtetas ishin deklaruar fajtorë për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve”. Kjo kërkesë është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin nr. {***} akti, datë 15.11.2018.

- Në vijim, subjekti ka regjistruar procedimin penal nr. {***}/2018 ndaj shtetasit V. M. për veprën penale të “Vjedhjes”, ka bashkuar procedimet penale nr. {***}/2018 dhe nr. {***}/2015, ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”, kërkesë e cila është pranuar nga gjykata, si dhe ka disponuar marrjen si të pandehur të shtetasit V. M.. Më datë 18.02.2019, ai ka kërkuar dërgimin për gjykim të procedimit penal vetëm ndaj këtij shtetasi.
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 27.03.2019, ka vendosur kthimin e akteve prokurorit, ndryshimin e cilësimit juridik të akuzës ndaj V. M. dhe formulimin e akuzës edhe ndaj shtetasit M. M. për veprën penale të “Vjedhjes” me pasoja të rënda, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 134/2 dhe 25 të Kodit Penal. Gjykata ka arsyetuar se rezultonte e provuar ekzistenca e bashkëpunimit ndërmjet këtyre shtetasve për përvetësimin e të ardhurave. Ankimi i subjektit dhe i të pandehurit V. M. është mospranuar nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. {***}, datë 11.06.2019, për shkak se ligji nuk parashikonte ankim ndaj këtij lloji vendimi.
- Vendimi nr. {***}, datë 27.03.2019, i është komunikuar Prokurorisë më datë 25.09.2019 dhe, më datë 30.09.2019, subjekti ka urdhëruar regjistrimin e emrit të shtetasit M. M. si autor i dyshuar i veprës penale. Më datë 14.10.2019, ai ka disponuar marrjen si të pandehur të shtetasve V. M. dhe M. M. për veprën penale të “Vjedhjes”, kryer në bashkëpunim, me pasoja të rënda, parashikuar nga nenet 134/2 dhe 134/3 të Kodit Penal.
- Më datë 21.11.2019, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në gjykatë kërkesën për dërgimin në gjyq të procedimit penal nr. {***}/2015 ndaj shtetasve V. M. dhe M. M..
- Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës lidhur me konstatimet se: (i) nga data 26.05.2015 deri më datë 09.09.2015, procedimi penal është regjistruar përtej afatit 30-ditor të përcaktuar nga Udhëzimi nr. 241, datë 21.11.2005, i Prokurorit të Përgjithshëm, i ndryshuar; dhe (ii) sipas vendimit të formës së prerë nr. {***}, datë 27.03.2019, kërkesa e subjektit për dërgimin në gjyq vetëm ndaj shtetasit V. M. ka evidentuar mangësi në formulimin e akuzës.
- Në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur, ndër të tjera, vendimin nr. {***}, datë 01.07.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me të cilin është vendosur dërgimi për gjykim i çështjes ndaj të pandehurve V. M. dhe M. M., si dhe shkresën e kësaj gjykate, sipas së cilës procedimi penal vijonte të ishte në shqyrtim gjyqësor.

⁵⁸ I cili ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier nr. {***}, datë 01.07.2016, për deklarimin fajtor të shtetasve V. F., M. M., V. M. dhe A. N., deklaruar fajtorë për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve” të kryer në bashkëpunim sipas nenit 186/2 të Kodit Penal.

267. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues vëren se Komisioneri Publik ka pretenduar se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të përmbyste barrën e provës lidhur me gjetjet e evidentuara nga Komisioni dhe se qëndrojnë si të bazuara pretendimet e denoncuesve në lidhje me mungesën e formulimit të akuzës edhe ndaj shtetasit M. M., si dhe me afatin e tejzgjatur të procedimit penal.
268. Sipas Komisionerit Publik, këto rrethana tregojnë edhe në këtë rast mangësi në efikasitetin hetimor të subjektit të rivlerësimit, si në drejtim të ndërmarrjes së veprimeve hetimore në përputhje me kërkesat ligjore për mbledhjen e provave të nevojshme, ashtu edhe në drejtim të aftësisë për të përballuar ngarkesën e punës dhe për të administruar procedimin brenda afateve të arsyeshme.
269. Për këto arsye, Komisioneri Publik ka kërkuar që këto rrethana të bëhen pjesë e vlerësimit tërësor të subjektit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të vlerësimit të nënindikatorëve të përcaktuar nga neni 73, pika 2, dhe neni 74, pika 1 e ligjit nr. 96/2016.
270. Në analizë të kësaj dosjeje, në këndvështrim të kriterit të aftësive profesionale dhe pa u ndalur në vlerësimin e bazueshmërisë së zgjidhjes së çështjes në themel, çka përbën atribut të organeve gjyqësore kompetente, trupi gjykues vlerëson si vijon.
271. Referuar kronologjisë dhe ecurisë së procedimit penal, shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe dokumentacionit të administruar nga Komisioni, trupi gjykues konstaton se, pas paraqitjes së kallëzimit penal nr. {***}, datë 26.05.2015, ndaj shtetasve M. M. dhe L. Q., për veprat penale të “Falsifikimit të dokumenteve” dhe “Vjedhjes” duke shpërdoruar detyrën, janë paraqitur edhe kallëzime të tjera me të njëjtin objekt, në ngarkim të shtetasve M. M. dhe V. M., të cilat janë bashkuar me aktet e procedimit penal nr. {***}/2015. Megjithatë, procedimi penal është regjistruar pa autor të identifikuar dhe ka vijuar në këtë gjendje deri në disponimin për pushimin e çështjes nga subjekti i rivlerësimit më datë 29.12.2017.
272. Trupi gjykues vëren se, në kohën e disponimit për pushimin e procedimit penal, ekzistonin të dhëna objektive me relevancë për drejtimin e mëtejshëm të hetimit. Në këtë kuadër, rezulton se me vendimin nr. {***}, datë 01.07.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, shtetasit M. M., V. M. dhe persona të tjerë ishin deklaruar fajtorë për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve”. Kjo rrethanë është evidentuar edhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë në vendimin nr. {***}, datë 05.02.2018, me të cilin është vendosur kthimi i akteve prokurorit dhe formulimi i akuzës ndaj shtetasve M. M. dhe V. M. për veprën penale të “Vjedhjes”.
273. Megjithëse ky vendim është ankimuar nga subjekti i rivlerësimit dhe është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Vlorë, e cila me vendimin nr. {***}, datë 06.06.2018, ka disponuar pushimin e procedimit penal nr. {***}/2015, këto rrethana procedurale përbëjnë elemente që trupi gjykues i merr në konsideratë në vlerësimin e mënyrës së ushtrimit të funksionit nga subjekti i rivlerësimit, në aspektin e kujdesit dhe efikasitetit profesional të treguar gjatë ndjekjes së procedimit penal.
274. Në vijim, më datë 19.10.2018, subjektit të rivlerësimit i është kaluar për shqyrtim kallëzimi penal nr. {***}/2018, i paraqitur nga shtetasit V. F. dhe të tjerë, ndaj shtetasve M. M., V. M.

etj. Në këtë kallëzim është kërkuar rifillimi i ndjekjes penale ndaj të kallëzuarve, duke u pretenduar se, krahas veprës penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, ata kishin konsumuar edhe veprën penale të “Vjedhjes”, kryer në bashkëpunim. Ky pretendim mbështetej në vendimin nr. {***}, datë 26.07.2018, të Gjykatës së Apelit Vlorë, me të cilin shtetasit M. M., V. M. dhe persona të tjerë ishin deklaruar fajtorë për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve”.

275. Në këto rrethana, subjekti i rivlerësimit i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me kërkesë për revokimin e vendimit të pushimit të procedimit penal nr. {***}/2015, kërkesë e cila është pranuar nga gjykata. Për rrjedhojë, procedimi penal është rikthyer për hetim, në funksion të vlerësimit të rrethanave të reja të evidentuara gjatë ecures së çështjes.
276. Pa u ndalur në bazueshmërinë e zgjidhjes së çështjes në themel, trupi gjykues konstaton se zhvillimet e mësipërme procedurale dëshmojnë se rrethanat e çështjes kanë pësuar një evolim të tillë, saqë kanë sjellë revokimin e vendimit të pushimit dhe rifillimin e hetimeve, duke dëshmuar mbi mangësitë e subjektit në vlerësimin e thelluar të fakteve që kishin rezultuar nga hetimi dhe që duhej të kishin ndikim mbi vendimmarrjen e tij lidhur me dënimin e shtetasve të kallëzuar për kryerjen e veprës penale të falsifikimit të dokumenteve. Në vijim të këtij procesi, organi i akuzës ka disponuar formulimin e akuzës për veprën penale të “Vjedhjes”, kryer në bashkëpunim, me pasoja të rënda, parashikuar nga nenet 134/2 dhe 134/3 të Kodit Penal, ndaj shtetasve M. M. dhe V. M., të cilët ndërkohë rezultonin të dënuar me vendim të formës së prerë për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal.
277. Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik mbi mungesën e formulimit të akuzës edhe ndaj shtetasit M. M., referuar akteve të fashikullit penal, trupi gjykues vëren se, pas revokimit të vendimit për pushimin e procedimit penal nr. {***}/2015, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal nr. {***}/2018 vetëm në ngarkim të shtetasit V. M., duke disponuar njëkohësisht bashkimin e tij me procedimin penal nr. {***}/2015. Në vijim, më datë 18.02.2019, ai ka kërkuar dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. {***}/2015 vetëm ndaj këtij shtetasi.
278. Pa u ndalur në vlerësimin e bazueshmërisë së vendimeve të subjektit në themel të çështjes, trupi gjykues vëren se kjo mënyrë procedimi është pasuar nga vendimi nr. {***}, datë 27.03.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i dhënë në shqyrtimin e kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq, me të cilin gjyqtari i seancës paraprahe ka disponuar kthimin e akteve prokurorit, duke çmuar se organi i akuzës duhej të ndryshonte cilësimin juridik të veprës penale në ngarkim të shtetasit V. M., duke e akuzuar atë për veprën penale të “Vjedhjes”, me pasoja të rënda, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 134/2 dhe 25 të Kodit Penal, si dhe të formulonte akuzë edhe ndaj shtetasit M. M..
279. Në këto rrethana faktike dhe procedurale, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në drejtimin dhe efikasitetin e ushtrimit të ndjekjes penale, në kuptim të ndërmarrjes në kohë dhe në mënyrë të përshtatshme të veprimeve procedurale të nevojshme, ndërsa mënyra e procedimit e ndjekur prej tij duket se ka ndikuar në ecurinë dhe kohëzgjatjen e këtij procedimi penal.

280. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. {***}, datë 27.03.2019, nuk është shprehur për mangësi hetimore dhe se ka kryer thjesht një vlerësim të ndryshëm të rrethanave të faktit dhe provave të administruara, pretendim i mbështetur edhe nga përfundimi i Komisionit në paragrafin 80.2 të vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues vlerëson se ky argument është pjesërisht i drejtë.
281. Në të vërtetë, nga përmbajtja e vendimit të sipërcituar, nuk rezulton që gjykata të ketë konstatuar mangësi në kryerjen e veprimeve hetimore apo t'i ketë lënë subjektit të rivlerësimit detyrë për kryerjen e veprimeve hetimore shtesë. Megjithatë, fakti që gjykata ka disponuar jo vetëm formulimin e akuzës edhe ndaj shtetasit M. M., por edhe ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale në ngarkim të të pandehurit V. M., përbën një rrethanë objektive që trupi gjykues e merr në konsideratë në vlerësimin e mënyrës së ushtrimit të funksionit nga subjekti i rivlerësimit.
282. Pa u ndalur në korrektësinë e zgjidhjes së çështjes në themel apo në bazueshmërinë e vlerësimit juridik të bërë nga prokurori, trupi gjykues çmon se kjo mënyrë procedimi evidenton mangësi në drejtim të efikasitetit dhe kujdesit profesional të treguar nga subjekti në formulimin dhe ngritjen e akuzës, duke sjellë nevojën për ndërhyrje korrigjuese nga gjykata në fazën paraprake.
283. Për rrjedhojë, trupi gjykues e gjen të bazuar pretendimin e Komisionerit Publik se këto rrethana pasqyrojnë mangësi në efikasitetin e ushtrimit të ndjekjes penale dhe, si të tilla, duhet të merren në konsideratë në funksion të vlerësimit të nënindikatoreve të përcaktuar në nenin 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar.
284. Trupi gjykues vlerëson se rezulton i bazuar edhe konstatimi lidhur me tejzgjatjen e hetimeve nga subjekti i rivlerësimit, rrethanë e cila evidenton se procedimi penal nuk është administruar me efikasitetin dhe dilijencën e kërkuar në ushtrimin e funksionit të prokurorit. Në këtë kontekst, trupi gjykues çmon të evidentojë si vijon.
285. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal nr. {***/2015 me një vonesë prej më shumë se dy muajsh nga data e regjistrimit të kallëzimit penal, duke mos respektuar afatet e përcaktuara në udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm mbi regjistrimin e procedimeve penale.
286. Në këtë drejtim, referuar dispozitave të Kodit të Procedurës Penale në fuqi në vitin 2015, vërehet se ato nuk parashikonin një afat të caktuar kohor për verifikimin e kallëzimit përpara disponimit të prokurorit mbi zgjidhjen ligjore të çështjes. Megjithatë, kjo çështje rregullohej nga udhëzimi nr. {***}, datë 21.11.2005, i Prokurorit të Përgjithshëm, “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe emrit të personit që i atribuohet vepra penale”, i ndryshuar.
287. Në rastin konkret, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit e ka tejkaluar këtë afat pa shkaqe të përligjura. Shpjegimet e dhëna prej tij nuk rezultojnë të mjaftueshme për të justifikuar mosrespektimin e afateve të përcaktuara në aktin nënligjor përkatës. Për rrjedhojë, kjo rrethanë vlerësohet si një mangësi procedurale, e cila, ndonëse e marrë veçmas nuk paraqet peshë të tillë sa të përcaktojë në vetvete vlerësimin përfundimtar, merr rëndësi në kuadër të analizës së përgjithshme të efikasitetit dhe administrimit të procedimit penal nga subjekti i rivlerësimit.

288. Po ashtu, trupi gjykues vëren se nga disponimi i parë i subjektit të rivlerësimit për regjistrimin e procedimit penal, më datë 09.09.2015, deri në paraqitjen e kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq, më datë 19.11.2019, kanë kaluar më shumë se katër vjet. Kjo kohëzgjatje vlerësohet si e konsiderueshme për zhvillimin e hetimeve paraprake dhe tejkalon standardin kohor të parashikuar nga neni 323, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale.
289. Trupi gjykues mban në konsideratë se kohëzgjatja e procedimit nuk mund t'u atribuohet tërësisht veprimeve apo mosveprimeve të subjektit të rivlerësimit, pasi ajo është ndikuar edhe nga rrethana objektive që jo gjithmonë kanë qenë nën kontrollin e tij, përfshirë kompleksitetin e çështjes dhe zhvillimet procedurale që kanë shoqëruar ecurinë e saj.
290. Megjithatë, edhe duke marrë në konsideratë këta faktorë, administrimi i procedimit penal për një periudhë kaq të gjatë evidenton mangësi në drejtim të efikasitetit dhe të aftësive organizative të subjektit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, trupi gjykues çmon se këto rrethana janë relevante për vlerësimin e nënindikatorëve të aftësive organizative, sipas nenit 74, pika 1 e ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar⁵⁹.
291. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se Komisioneri Publik ka mbajtur një qasje në kundërshtim me jurisprudencën e Kolegjit, konkretisht me vendimin nr. 33/2021, sipas të cilit qëndrimi i ndryshëm i gjykatës në raport me kërkesën e prokurorit nuk mund të sjellë, në vetvete, pasoja ndëshkuese në vlerësimin e aftësive profesionale të magjistratit, çmohet nga trupi gjykues si i pabazuar.
292. Në rastin konkret, Komisioneri Publik dhe më pas Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme nuk kanë kërkuar vlerësimin e bazueshmërisë juridike të kërtimeve procedurale të subjektit të rivlerësimit apo penalizimin e tij për faktin se gjykata ka mbajtur një qëndrim të ndryshëm nga ai i prokurorit. Pretendimet e tyre kanë pasur si objekt analizimin e mënyrës së ushtrimit të funksionit nga subjekti i rivlerësimit në kuadër të nenit 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, konkretisht në drejtim të efikasitetit hetimor, ndërmarrjes në kohë të veprimeve procedurale të nevojshme, zhvillimit të hetimeve në mënyrë të plotë dhe të gjithanshme, si dhe administrimit të procedimit brenda afateve të arsyeshme.
293. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se rasti konkret nuk lidhet me aspektin e aftësive profesionale të parashikuar nga neni 73, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, të cilit i referohet vendimi nr. 33/2021 i Kolegjit, por me vlerësimin e efikasitetit dhe të aftësive organizative të subjektit të rivlerësimit sipas nenit 73, pika 2 e po këtij ligji.
294. Për sa më sipër, trupi gjykues e gjen të bazuar këtë shkak ankimi dhe vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në efikasitetin e ushtrimit të ndjekjes penale, në drejtim të ndërmarrjes në kohë të veprimeve procedurale të nevojshme për zhvillimin e hetimeve të plota

⁵⁹ Ligji nr. 96/2016, në nenin 74, të titulluar “Aftësitë organizative”, në pikën 1 parashikon: “1. Me anë të kriterit të aftësisë organizative, vlerësohet aftësia e magjistratit për të përballuar ngarkesën e punës dhe për të kryer procedurat hetimore ose gjyqësore, si dhe aftësia për të administruar dosjet gjyqësore, duke shmangur rrethanat, të cilat nuk varen nga magjistrati dhe që kanë efekt negativ në rezultatet e vlerësimit”.

dhe të gjithanshme dhe mbledhjen e provave të nevojshme, duke ndikuar në tejzgjatjen e procedimit penal.

295. Po ashtu, trupi gjykues konstaton se nga disponimi i parë i subjektit për regjistrimin e procedimit penal, më datë 09.09.2015, deri në paraqitjen e kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq, më datë 19.11.2019, kanë kaluar më shumë se katër vjet, kohëzgjatje e cila, edhe pse nuk mund t'u atribuohet tërësisht veprimeve apo mosveprimeve të subjektit të rivlerësimit, vlerësohet si tregues i mangësive në drejtim të efikasitetit dhe të aftësive organizative në administrimin e procedimit penal.
296. Për rrjedhojë, trupi gjykues çmon se këto rrethana bien ndesh me standardet e ushtrimit të funksionit të prokurorit, të parashikuara në nenin 73, pika 2, dhe nenin 74, pika 1 e ligjit nr. 96/2016.
297. Lidhur me shkakun e ankimit që ka të bëjë me etikën dhe profesionalizmin e subjektit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka pretenduar se Kolegji duhet të vlerësojë kujdesin e treguar prej tij në identifikimin dhe administrimin e një situatë të mundshme konflikti interesi gjatë trajtimit të dy procedimeve penale në vitet 2016 dhe 2017.
298. Sipas Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit duhej të kishte evidentuar në kohë ekzistencën e konfliktit të interesit, i cili, në rastin konkret, paraqitet i ndërthurur, si në drejtim të interesit pasuror, në kuptim të dispozitave të ligjit nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, ashtu edhe në drejtim të shkaqeve të papajtueshmërisë procedurale të parashikuara nga neni 17 i Kodit të Procedurës Penale.
299. Nga analizimi i akteve të administruara gjatë hetimit administrativ dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues konstaton si vijon.
300. Sipas qëndrimit të mbajtur nga Komisioni në paragrafin 85 të vendimit objekt shqyrtimi, nuk është evidentuar ndonjë situatë konflikti interesi nga ana e subjektit të rivlerësimit në trajtimin e dy kallëzimeve penale të viteve 2018 dhe 2021, që lidhen me shtetasin F. K..
301. Sa i takon faktit se ky shtetas kishte paraqitur kërkesa për përjashtimin e subjektit të rivlerësimit në vitet 2016 dhe 2017, Komisioni ka vlerësuar se kjo rrethanë, në vetvete, nuk përbënte shkak ligjor që, në kuptim të neneve 17 dhe 26 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti të kërkonte dorëheqjen nga trajtimi i kallëzimeve penale të mëvonshme të viteve 2018 dhe 2021. Në këtë drejtim, Komisioni ka çmuar se kërkesat e mëparshme për përjashtim nuk mbështeteshin në rrethana të tilla që të impononin detyrimin procedural të heqjes dorë nga shqyrtimi i këtyre procedimeve.
302. Për më tepër, Komisioni ka vlerësuar se, përveçse nuk janë evidentuar elemente favorizimi në raport me shtetasin F. K., nuk janë konstatuar as shkelje procedurale apo veprime dhe mosveprime të subjektit të rivlerësimit që të cenonin aftësitë e tij profesionale apo besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.
303. Gjatë gjykimit në Kolegj, në bisedimet përfundimtare, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, edhe duke marrë në konsideratë pretendimet e subjektit të rivlerësimit se nuk ka ekzistuar një interes

pasuror në raport me shtetasin F. K., ka kërkuar që Kolegji të vlerësojë nëse subjekti ka treguar dilijencën e duhur për evidentimin e një situatë të mundshme konflikti interesi. Sipas tij, pavarësisht mungesës së një interesi pasuror të drejtpërdrejtë, fakti që ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit F. K. kishte ekzistuar një mosmarrëveshje, e konstatuar të paktën në dy raste nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, impononte një shkallë më të lartë kujdesi nga ana e subjektit në vlerësimin e ekzistencës së një konflikti të mundshëm interesi. Për këtë arsye, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme ka kërkuar që këto rrethana të vlerësohen nga Kolegji në funksion të nënindiktorit të përcaktuar në nenin 75, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, lidhur me kujdesin e duhur ndaj konfliktit të interesit.

304. Në kundërshtim të këtij shkakut ankimi, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se marrëdhënia e posedimit pa kundërshtim të apartamentit në pronësi të shtetasit P. B. ka qenë një marrëdhënie personale, faktike dhe verbale, pa implikime juridike me shoqërinë ndërtuese. Sipas tij, gjatë periudhës janar 2016 – shkurt 2017, kur ka pasur në posedim këtë apartament, nuk ka ushtruar funksionin e prokurorit në asnjë çështje të regjistruar në emër të shoqërisë ndërtuese apo administratorit të saj. Në këto kushte, subjekti ka pretenduar se nuk ekziston asnjë element përbërës i konfliktit të interesit, sipas standardeve të përcaktuara në ligj dhe në jurisprudencën e Kolegjit.
305. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka prapësuar se qëndrimi i Komisionerit Publik nuk është objektiv, nuk përputhet me standardet e konsoliduara në jurisprudencën e Kolegjit për raste të ngjashme apo më të rënda në aspektin krahasues dhe, për më tepër, nuk mbështetet në fakte, prova dhe ligj.
306. Trupi gjykues konstaton se, në kuadër të hetimit administrativ, Komisioni ka administruar të dhëna dhe ka kryer verifikime në lidhje me shtetasin F. K., administrator i shoqërisë “{***}” ShPK, në funksion të vlerësimit të ekzistencës së një situatë të mundshme konflikti interesi të subjektit të rivlerësimit në raport me këtë shtetas.
307. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 19.04.2022, ka informuar Komisionin se subjekti i rivlerësimit ka pasur në hetim procedimet penale nr. {***}/2016 dhe nr. {***}/2017. Nga aktet e administruara, rezulton se, në të dyja këto procedime, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, është zëvendësuar me urdhër të drejtuesit të prokurorisë, pas kërkesave të paraqitura nga shtetasi F. K., i kallëzuar penalisht në këto procedime.
308. Në kërkesat e tij për përjashtim, shtetasi F. K. ka pretenduar, ndër të tjera, se: [...] Rezulton se në objektin e banimit 8-katësh, i cili ndodhet përbri dy objekteve të ndërtuara nga subjekti ndërtues “{***}” ShPK, ka marrë një banesë me qira, përpara rreth tre muajsh, shtetasi Kledian Llaho, i cili rezulton të jetë edhe prokurori i çështjes që po heton kallëzimin penal të bërë nga shtetasi T.K., për të cilin është regjistruar procedimi penal nr. {***}/2016. Ky shtetas, vetëm pak ditë pasi ka filluar të banojë në banesën e marrë me qira, është paraqitur në ambientet e subjektit ndërtues dhe më është prezantuar si prokuror. Pasi ka marrë dijeni se unë isha administratori i subjektit ndërtues, më ka kërkuar të hiqja antenën e kompanisë [...],

*e cila ishte vendosur në tarracën e njërit prej objekteve të ndërtuara nga subjekti ndërtues “{***}” ShPK”.*

309. Trupi gjykues vëren se, në gjendjen në të cilën ndodhen aktet e administruara në fashikullin e Komisionit, nuk rezulton të jetë administruar ndonjë shpjegim i subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto pretendime konkrete të shtetasit F. K..
310. Drejtuesit e Prokurorisë, në zbatim të neneve 17, pika 1, shkronja “ç”, 24 dhe 27, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale, në vendimet për pranimin e kërkesave të shtetasit F. K. për përjashtimin e subjektit të rivlerësimit, kanë arsyetuar se ekzistenca e një mosmarrëveshjeje ndërmjet kërkuesit dhe prokurorit të çështjes përbënte shkak për zëvendësimin e këtij të fundit nga hetimi i procedimeve penale përkatëse.
311. Referuar kësaj situatë faktike dhe kuadrit ligjor të zbatueshëm, trupi gjykues vlerëson se, në kushtet kur ekzistenca e kësaj marrëdhënieje konfliktuale është konstatuar në të paktën dy raste nga drejtuesi i prokurorisë dhe nuk rezulton të jetë kundërshtuar nga subjekti i rivlerësimit në materialin e administruar në dosje, këtij të fundit i lindte detyrimi për të vlerësuar me kujdes ekzistencën e një shkakut të mundshëm papajtueshmërie në kuptim të nenit 17, pika 1, shkronja “ç” e Kodit të Procedurës Penale dhe, sipas rastit, për të kërkuar heqjen dorë nga trajtimi i procedimeve penale ku palë ishte shtetasi F. K..
312. Për rrjedhojë, trupi gjykues e çmon të bazuar pretendimin e Komisionerit Publik në drejtim të mungesës së dilijencës së duhur të subjektit të rivlerësimit për evidentimin dhe administrimin e kësaj situatë të mundshme konflikti interesi, në funksion të nënindiktorit të parashikuar nga neni 75, pika 4 e ligjit nr. 96/2016.
313. Megjithatë, ndonëse këto rrethana evidentojnë mangësi në aspektin e kujdesit etik që subjekti i rivlerësimit duhej të tregonte në ushtrimin e funksionit, trupi gjykues vlerëson se ato nuk paraqesin një rëndësi të tillë thelbësore që, të marra veçmas, të ndikojnë në zgjidhjen përfundimtare të çështjes.
314. Pas vlerësimit të të gjitha shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e kontrollit të pasurisë dhe atë të aftësive profesionale, në mbështetje të akteve të administruara në dosjen gjyqësore, të dokumentacionit të përcjellë nga Komisioni, të provave të marra gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, si dhe të legjislacionit të zbatueshëm, trupi gjykues konstaton se:
- (i) Mosdeklarimi, kontradiktat dhe pasaktësitë e konstatuara në lidhje me burimet “kontribut i nënës” dhe “ndihmesë e prindërve të bashkëshortes”, të deklaruara si burime për krijimin e pasurisë depozitë në Credins Bank, të vlerësuara edhe në raport me mundësinë reale financiare të nënës së subjektit të rivlerësimit dhe të prindërve të bashkëshortes së tij për dhënien e shumave të pretenduara, afektojnë besueshmërinë e subjektit në kriterin e kontrollit të pasurisë, duke e vendosur atë në kushtet e deklarimit kontradiktor, të pasaktë dhe të pamjaftueshëm. Këto rrethana i vendosin institucionet e rivlerësimit në pamundësi për të verifikuar se cili prej deklarimeve të subjektit pasqyron situatën e vërtetë faktike lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie.

(ii) Problematikat e konstatuara në lidhje me procedimet penale nr. {***/2019 dhe nr. {***/2018 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, si dhe procedimin penal nr. {***/2021 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, të cilat bien ndesh me përcaktimet e nenit 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, të vlerësuara në ndërlidhje edhe me informacionin e klasifikuar të agjencive ligjzbatuese, japin perceptime të rëndësishme mbi integritetin e subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit 75, pika 3 e ligjit nr. 96/2016.

(iii) Moskryerja për periudha të gjata dhe të pajustificuara e veprimeve hetimore, mangësitë në drejtim të efikasitetit hetimor dhe tejzgjatja e hetimeve paraprake, të evidentuara në dy procedimet penale të shqyrtuara në kuadër të denoncimeve nga publiku, në vlerësimin e trupit gjykues, ndonëse nuk paraqesin peshë të tillë sa të kualifikohen sipas nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, janë marrë në konsideratë në kuadër të vlerësimit tërësor të çështjes, në kuptim të nenit 4, pika 2 e po këtij ligji.

315. Në vlerësim tërësor të të gjitha rrethanave të konstatuara gjatë procesit të rivlerësimit, trupi gjykues arrin në përfundimin se ato janë të një natyre dhe peshe të tillë që kanë sjellë cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Duke marrë në konsideratë karakterin dhe seriozitetin e tyre, trupi gjykues çmon se këto problematika nuk mund të konsiderohen të riparueshme nëpërmjet programeve të trajnimit të Shkollës së Magjistraturës, ndaj vazhdimi i ushtrimit të funksionit të prokurorit nga subjekti i rivlerësimit do të ishte i papajtuëshëm me qëllimin e procesit të rivlerësimit kalimtar, të përcaktuar nga neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
316. Në përfundim, pas vlerësimit tërësor të të gjitha rrethanave dhe problematikave të konstatuara në kriterin e kontrollit të pasurisë dhe në atë të aftësive profesionale, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 4, pika 2, në lidhje me nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pasi ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.
317. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se vendimi nr. 607, datë 22.12.2022, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nuk qëndron në përfundimet e arritura prej tij dhe, për rrjedhojë, duhet të ndryshohet.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

- Ndryshimin e vendimit nr. 607, datë 22.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Kledian Llaho.
- Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, sot, më datë 01.08.2025.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATOR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi